Bashkia Shkodër
Biblioteka “Marin Barleti”

Gegnia

e përkohshme kulturore-artistike

9 - 2019
Vjeti IV i botimit,
Shkodër

Gegnia
E përkohshme kulturore-artistike

9 -2019
Vjeti IV i botimit,
Shkodër

Redaksia:
Gjovalin Çuni**,** Arben Prendi, Ermira Alija,

Redaktor gjuhësor: Erzen Koperaj

Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër
dhe bibliotekës "Marin Barleti"

ISSN: 2519-73-91

Adresa e redaksisë: Biblioteka "Marin Barleti", Shkodër
E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al
info@bibliotekashkoder.com

Shënim: *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

Njoftim për lexuesit

Tuj u nise prej numrit 10-2019, të revistës,
redaksia ka me u ndrýshue.
Përbamja e saj ka me kenë:
Maxhid Cungu, Arben Prendi, Ermira Alija.

Ndryshimi i redaksisë ka kenë i kushtëzuem
nga dalja në pension e z. Gjovalin Çunit.
Redaksia tuj e falenderue për punën e báme
i uron shëndet e pension të mbarë.

PËRMBAJTJA E LENDËS

▪Editorial ▪
Ernest **KOLIQI** (1903-1975)
Atdhe pa adjektiva 7

▪ Albanologji ▪
Prof. Karl **GURAKUQI**
Nobert **JOKL**. *Populli shqiptar dhe gjuha e tij* *10*

Stela **KARAFILI**
Llukë H. Karafili (Bardhyli), personalitet i kulturës kombëtare .....
Luigj **MARTINI**
Dr. Mirash Ivanaj,kalorësi i mendimit të lirë .....

▪ Arsim ▪
Lindita **KAZAZI** & Njazi **KAZAZI**
"Abetaret shqipe dhe Pavarësia Kombëtare .....

▪ Histori ▪
Nexhmi **BUSHATI**
100-vjetori i Kuvendit të Bushatit (korrik 1919 – korrik 2019) .....
Sereta **KOPERAJ**
Ditët e fundit të Mbretërisë shqiptare, para pushtimit italian (1939), në dokumentet britanike .....

▪ Traditë ▪
Xhahid **BUSHATI**
Arif Gjyli, përshtatësi i parë i Eposit të Kreshnikëve .....

▪ Letërsi-Art-Kulturë ▪
Zef **ZORBA**
Mbi tragjedinë e papërfunduar "Hajrija" të At Gjergj Fishtës .....

Demokrati Át Gjon Shllaku .....

▪ Përkthimi ▪

Domenico **REA**
Koshi i letrave .....
Achille **CAMPANILE**
Pantomimë .....
Eugenio **MONTALE**
Armiqtë e zotëri Fuksit .....
Stefano **BENNI**
Tabela "Bar Sport".....

▪ Intervista ▪

Enia **MATISHI**
"Emira", e shkrimtarit arbëresh Françesk Anton Santori, në skenë nga studentët e Universitetit "Luigj Gurakuqi" .....

▪ Recensione ▪

Shefqet **KELMENDI**
TANAGRA – historia e genit dhe e gjuhës .....

▪Bibliofili▪

Fatmira **LEKIQI**
Pasuri hartografike në bibliotekën "Marin Barleti" .....
Erzen **KOPERAJ**
Shqipja dhe shqiptarët në artikujt e etërve françeskanë .....

Editorial

Ernest **KOLIQI** (1903-1975)

ATDHE PA ADJEKTIVA[1]

Helm merr njeriu në gjendje të sotshme shqiptare ku duket e venitun çdo ndiesi e urtë atdhedashuníje. E nuk flasim për ato shprehje retorike atdhedashunore, aqë lart-tinglluese sa të shprazta, qi kur përsriten tepër shpesh nga disa krekacorë, - ja njerez bihude, ja oportunista hypikrita, - gadi gadi shkaktojnë neveritje e bajmë qi me të dale hirit Shqipnínija e shqiptarizmi. E kemi fjalën këtu për at kujdes shporues qi na prishë zêmrën kur mendojmë fatin e atdheut, d.m.th. t'atij atdheu qi përfshin shpijarët në gjií të vet e t'afërmit të dashun, doket e zakonet qi na âmbëlsuen fminin, qi na mbajtën n'udhë fisnike në moshën burrnore dhe, jashta e mbrenda Shqipníje, janë krypa e gjallesës s'onë . e mos të njehet ky si nji ankim plakaruçi qi nuk din të mësohet me të rámen e kohës moderne dhe strehon mallet e veta në furrikun e kujtimeve t'arta të kalesës. Jo, shkruesi, i këtyne rrjeshtave ka banue (mjerisht) shum pak në vendlindje: âsht rritë e motnue në qytete metropole të mëdhaja europjane. Njef prandaj frymën e kësokohëshme mâ mirë se ata qi mburren si t'ethun ndriçimesh ultramodern tue banue në vise e treva ku qytetnimi arrin mâ vonë dhe shpesh me ngjyra të zbehta. Me këtë nuk due të përbuzi njerzít qi shkojnë motin në rrethe katundare e malore ase ne qytete dytanike. Tue u ankue për shqiptarizëm të cënuem në palc, menden e çoj tu ata qi pèrçmojnë undyrën e jetës s'onë tradicjonale, e cila lulzoi plot bujarí në fshate e krahina të veçueme nga bota.

Mbarë gjaku i ynë i shprishun âsht plandosë në nji amullí shpirt dobësuese. Ndonji lëvizje plot zhurmë të pafrytëshmë nisë e shuhet nën gicilim ambicjesh pa flatër ideale. Problemi thalbësuer i fisit

[1] *"Shêjza" nr.1-10/1974.*

shqyptar, d.m.th. ndertimi i nji atdheu të vertetë, të lír e të përparuem cak ngushullues vëllazníje ku sejcili Bir Shqipje të gjêjë vokësí çerdhje, jo vetem lêhet mbas doret , por deshtas, hidhet në kosh të plaçkave qi s'vyejën gjâ. E pse ? Pse sejcila gjymturë e gjindes arbnore sejcili komunitet, sejcila krahinë, sejcila derë, sejcila vetvete (individ) në trû të veta ushqen përgjithësisht nji íde të përvetëshme (individuale) t'atdheut. Kështu qi mund të thomi qi vlojnë përfitime (koncepte) mija e mija Shqípninash në mendësíe n'andrrime të gjindes shqiptare. Puna shtrêmbënohet deri në hatá qesharake kur ngushtësija e shpirtit dhe kryeneçsija (gjymtim i madh i ynë) shkakton mëní të pashumeme kundra të gjithë atyne të cilët s'pranojnë si të drejtë mendimin e atdheut përftue prej tjervet. Kështu, n'emën t'atdheut, urrejnë bashkëatdhetarët e arrinë edhe me u a mohue, njâni-tjetrit , deri cilësín shqiptare: nuk âsht Shqiptar ai qi nuk pohon se Shqipníja duhet të jét në fytyrim t'asaj qi sendërgjon mendja e çdonjânit prej nesh.

Ngjarjet historíke, fatzeza, nepër të cilat u përshkrue rrokull qindvjetvet , nuk ndihmuen rodin shqiptar t' ndriçonte nga nji ideal i njijishëm kombtar. Ndiesíja vëllaznore erdh tue u ligështue. Por, fatlumsisht, nuk u shkim. Në Shqiptarët e ndám në besime e në krahina e në gjymtyrë të nderrnduerta nuk u shue instikti ethnik. Kjo lidhje e gjakut të përbashkët na ndihmoi me gjetë udhën e shpërblimit. Mbi instiktin ethnik të strukun në skâj të shpirtit t'onë u mbështet vepra madhore e Jeronym De Radës, Naum Veqilharxhit, Vëllaznëve Frashëri, Vaso Pashës, Jan Vretos etj. për të ndertue atdhén. Si guer themeli të veprimtarís së tyne mendendritun e zêmërmadhe qe vëllazními i të gjithë shqiptarëve mbi dallimet e trashigeume nga ngjarjet e trishtueshme historike. Pak kush jashta Shqipníje, e besa edhe mbrenda rrethit shqiptar besonte në nji bashkim të fisit t'onë nën flamur të Skanderbegut. E, prá, besëpakët u shtangën çudije sepse mrekullija e Shqipnís së lirë u vertetue dhe me shkelqim të vetín u a muer syt dyshimtarëvet dhe anmiqvet.

Por ende pa i u hjekë në diell e n'ajr të lirís palvet të flamurit era e mykut shekulluer, nisën ngatrresat e rrebta e kaçkarikat në mes Shqiptarve. Nji epsh i trêntë lufte civile hyni në zêmrat e tyne. N'êmnin e shejtë t'atdheut, u përpoqën me rrênue çdo përparim qi nuk i u mveshej zotsís vepruese vetíake.

N'emnin e ndershëm të Rilindasvet, me mjete të pabukra u orvaten me shêmbë urat qi ata kishin lëshue në mes féve, krahinave e kulturnave të ndryshme. Me etiketa gënjeshtare mbuluen etin për pushtet në mungesë

të plotë të çdo qëllimi të shëndoshë kombtar.

E djelmëníja e sotshme e trullueme nga shkrimet pseudo-historike , s’din shka me mendue e si me u drejtue. Duhet t’a ringjallim mësimin e shëmbullin e Rilindasvet dhe t’a dlirím konceptin e atdheut nga adjektivat dâmçorë. Të vêm para syve të djelmnís e t’onë fytyrimin e nji Shqipníje . votër qi përmbledh rreth dritës e nxëhtësís së vet mâ të madhin e mâ të voglin bír nâne shqiptare.

▪ **Albanologji** ▪

Prof. Karl **GURAKUQI**
Mis i Institutit Mbretnuer të Studimevet Shqiptare
Nobert **JOKL**

POPULLI SHQIPTAR DHE GJUHA E TIJ[1]

Gjuha e Shqiptarvet ka mbetë si nji fëmí i vorfën i familjes gjuhësore indo-germane. Ndërsa në fushën e disa gjuhve motra, nji radhë e pa-lodhëshme gjurmuesish na ka parashtruem me nji vullndet të papërkulun gati të gjitha problemat në pikëpamje të historís dhe të studimit gjuhësuer, tue i zgjidhë në shum drejtime, në fushën e gjuhës shqipe pret ende sot zgjidhjen e vet nji sasí shum e madhe çashtjesh. Këtu shofim nji godinë, po thuejse të kryeme, atje na bjen në sy nji ndërtesë, së cilës i janë vûm themelet, mbi të cilat âsht punue me zell dhe âsht pritë prej njij dite në tjetrën mbuloja e saj, por ka ngelë e pa-plotsueme për shkaqe të ndryshme. Arsyet pse gjurmimi i gjuhës shqipe nuk ka përparuem aq tepër, janë të mbrendëshme dhe të jashtëme; *të mbrendëshmet* e kanë burimin në rrethanat vetë të gjuhës, pse nuk âsht punuem ashtu sa duhet, pse âsht mbushë me elementa të huej, dhe pse dokumentat e saj janë relativisht të rinj, të cilët fillojnë vetëm në shekullin XVI ; *rrethanat e jashtëme*, të cilat deri tash e kanë penguem rrugën e njij gjurmimi të dendun e të hollsishëm të shqipes, mbështeten edhe në gjendjen e mbrapambetun të kulturês së përgjithëshme të vendit, e cila paraqet vështirsít mâ të ndryshmet shoqnore, teknike dhe hygjenike për gjurmimin systematik të djalektevet, për nji mbledhje rranjësore të visarit gjuhësuer dhe për tjera gjurmime të kësaj natyre.

[1] *Nxjerre nga libri "Die Erforschung der indogermanischen Sprahen", Zweites Buch –II Albanisch –Strassburg Verlag von Karl J. Trubner, 1917, faqe 109 deri 151.*

Prandej të na lejohet t'a shtjellojmë mâ haptas ketë pikëpamje tue parashtruem nji pasqyrë mbi *vendin dhe popullin e shqiptarevet* tue cekë shkurtazi *fatin e jashtëm të gjuhës së tij dhe të përmendorevet të saja*

Populli shqiptar i paraqet gjurmuesit të gjuhës së tij problema tërheqse për studim. Gjuha e këtij populli flitet në bregun linduer t'Adriatikut, përafrisht ndërmjet shkallës 39 dhe 42 të gjansís, dhe jo vetëm në viset mâ të skajshmet të kësaj zone, përhapet kah veri-lindja deri në krahinat e fushës së Kosovës dhe të Macedonis prendimore (Kumanovë, Kaçanik, Tetovë, Shkup, Manastir), përpiqet në jug dhe në jug-lindje, nga Saranda deri në mallet e Gramosit, me kombsin dhe gjuhën e greqishtes së ré, kufizohet mâ në fund, tue kaluem nepër Kostur deri në brigjet e liqejvet të Presbës e t'Ohrit dhe pranë Dibrës, me djalektet bullgare të Macedonís.

Ai qi dishron të thellohet mâ mire dhe të njofë mâ me themel këta kufij gjuhësorë të shqipes, qi na këtu parashtruem në vijat e përgjithëshme, përsa na lejoi shtilli i këtij studimi, mundet me nxjerrë njoftime mâ të plota në veprat e J. G. von Hahni-t (*"Albanische Studien"*, Ëien, 1853), të E. Barbarich (*"Albania"*, Romë, 1905), të Veigand-it (*"Die Aromunen"*, 1, Leipzig, 1895), në kartat ethnografike të Kierpert-it (të ribotueme në vj.1902), në veprën e C. Sax-it (*:Mitteilungen der Geographischen Geselschaft in Ëien", 1878),* ndoshta edhe, por me masë e me urti, në paraqitjen kartografike të Cvijic-it (*"Petermanns Mitteilungen" 1913),* qi âsht me qëllime të këqija. Prej këtyne do shihet se sa e ndërlikueme âsht gjendja e gjuhvet dhe e popujvet në disa vise kufitare (si në Fushën e Kosovës, në Macedonin veri-perëndomore, Novipazarin, në brigjet e Detit Jon) dhe qysh përqinda e qinda vjetësh pa pushim turmat shqiptare mujtën pak nga pak me u dhanë këtyne viseve gjurmën e jetesës së ve. Kjo ndjenjë luftarake e këtyne bijve të thjeshtë të Shqipnis, zbashku me lodrat e politikës byzantine qi ndryshonte here pas here, e shtrini kombsin dhe gjuhën shqipe deri thellë në Greqi, dhe i hapi vetes rrugë ndër krahina qi paten frymën e kujtimeve klasike, si n'Atikë, Megara, Helikon, Beoti, Argolis dhe Meseni, madje edhe ndër ishujt si në Salamis dhe Eginë. Por edhe jashtë gadishullit të Hemus-it u themeluen shum koloni shqiptare, sidomos n'Itali e në Sicili, mâ e vjetra e të cilavet mrrijnë deri në gjymsën e shekullit XV.

Në këto krahina të Shqipnis së vërtetë, e cila për gjurmuesin e gjuhës së saj nuk âsht e njajtë me Shqipnin e krijueme nga diplomatija

e shtrembtë e vjetit 1913, banon nji popull i pa përparim. Shkallët e zhvillimit të njij pjestimi shoqnuer, qi përshkruen të gjith popujt, edhe ata mâ të përparuemit e Europës qendrore dhe prendimore, u ruejtën këtu, sidomos në pjesën veriore dhe qendrore, të pa-përkituna nga rrethanat e ndryshme të kohës. Këso dore ethnologija dhe historija e së drejtës mund t'i gjêjnë këtu dokumentat e njij veprimtarije së gjallë. Këtu mbretnon nji kushtetutë fisesh me rrjedhimet e veta të domosdoshme, d.m.th. lidhja e ngushtë individuale, ndërtimi i madh i *patria potestas*, gjakmarrja dhe çmimi i gjakut, detyrimi i luftës dhe Besa, asnji ligjë shtetnore, kurrnji gjykatë e vendosun nga auktoriteti epruer i vendit, nuk kujdeste për mprojtjen e jetës, të lirís edhe të pasunís: fisi âsht mprojtësi mâ i nalti i rregullimit të së drejtës. Ky vepron simbas kanunit të lanun djalë pas djali nga të parët, krejt ashtu sikurse veprohej pranë Germanvet të kojës së Karolingëvet dhe të Mesjetës, sikurse Anglosanksonët në kohën e mbretënvet të tyne. N'asnji kand të këtij vendi nuk gjinden rruga hekuri, nuk shifen ura (edhe pse aty – këtu mund të takohen ndonji)[2]. Lumejt kapërcehen me govada të bame nga trungje lisash dhe me anë shakujsh dhije, dhe kur ujnat e lumejvet e përmbysin tokën e nuk mund të kalohet prej nji bregu në tjetrin, atëherë marrëdhanjet ndërmjet katundevet priten për shum javë me rradhë.

Asht prandej krejt e natyrshme, qi edhe gjuha, kjo vegël shum fisnike për bashkimin shoqnuer dhe të popullit, ka psuem ndryshime të mdhaja. Sasia e madhe e ndryshimevet djalektore lidhet ngusht me ndryshimet e ndryshme shoqnore, të cilat kanë penguem qi të krijohet nji bashkim i plotë shtetnuer dhe njikohësisht nji lidhje e fortë marrëdhanjesh, kështu qi njêni fis me tjetrin janë shikuem si të huej, madje si anmiq ndërmjet vedit. Por, duhet pranuem, se edhe e natyrshme e tokës e ka pasë gishtin e vet në ndryshimet e shumta të djalektevet.

Nuk lypset të harrohet se Shqipnija âsht nji vend kundërshtisjesh të mdhaja morfologjike dhe klimatike: prej visevet bregore me klimën e tyne oceanike dhe bimsís e tyne mesdhetare, qi në disa krahina âsht shum e plleshme, deri në bjeshkët me borë t'Alpevet veriore, deri në malin Tomorr, qi âsht i shenjtë për Shqiptarët, e deri në fushat mâ të mdhaja të lumejvet të Shqipnis së Mesme, takohen njêna me tjetren klimat dhe florat mâ të ndryshmet. Përveç kësaj, mallet e nalta të këtij vendi nuk janë të përshkueme, sikurse Alpet, nga lugina lumejsh qi lejojnë komunikacjone, me anën e të cilave sillet fryma e qytetnimit,

[2] *Autori këtu flet për gjendjen e Shqipnis përpara vjetit 1917.*

por përkundrazi, nga shkaku i mungesës së rrugavet, nuk janë të përshtatuna për vende banimi dhe nuk lejojnë qi plugu dhe parmenda të sjellin bekimin e punimit të tyne. Jo vetëm këto, por as mallet mesatare nuk japin mundësin e nji popullsimi mâ të dendun.

Këso dore shofim se edhe grupimet e shkapërdërdhuna shoqnore dhe ndryshimet e shumta djalektore shkojnë krahas me natyrën e sipërfaqes së tokës. Me gjithë këtê, vêmë re se të gjitha djalektet e ndryshme të luginavet malore, të krahinavet bregore dhe të visevet të lumejvet sajojnë dy bashkësi të mdhaja djalektesh, d. m. th. *gegnishten* në veri dhe në Shqipnín e Mesme, dhe *tosknishten* në jug. Si kufi i këtyne dy djalekteve, simbas gjykimit të popullit, caktohet lumi i Shkumbinit. Por djalekti gegë mrrijnë aty-këtu kah jugu edhe përtej këtij kufini.

Sido qi të gjykohen ndryshimet ndërmjet gegnishtes dhe tosknishtes (mbi ketë gjâ do të flas gjatë këtij studimi), prap se prap nuk mund të pranohet mendimi qi âsht ndigjuem aq shpesh, se ndryshimet djalektore të gegnishtes dhe të tosknishtes janë si ato të svedishtes e të germanishtes. Mâ i arsyeshëm dhe mâ me vend âsht pohimi i J. G. von Hahn-it, i cili e krahason gjendjen e dy grupeve djalektore shqiptare me ndryshimet qi janë ndërmjet germanishtes së naltë dhe asaj s'ultës.

Shqipja nuk âsht nji gjuhë e përzieme

Me gjith se toka shqiptare ka karakteristika të veçanta, dhe ndonse vendi shqiptar âsht i egër dhe i fortë, kështu qi âsht i mbyllun për të huejin, prap se prap këto kushte nuk kanë mujtë me penguem, qi pushtues të huej qyshë prej kohvet të vjetra të mos përshkoheshin herë pas here e pa pushim nepër tê.

Këtu ndoqën njêna tjetrën periudhat e pushtimit nga ana e Romakvet, Gotvet, Slavëvet (Serbë e Bullgarë), Byzantinvet, e Turqvet. Vetëm nji periudhë të shurtën kreshnike, por të lumnueshme, të njij vetëqeverimi shtetnuer e gëzoi populli Shqiptar në shekullin XI nën udhëheqjen e Fatosit Kombtar Skandërbeut. Por ky studim i pushtuesvet të huej nuk qe aq fort rranjësuer.

Ajo gjâ qi mujt me u vrejtë gjatë sundimit turk të zhdukun tash pak kohë, d. m. th. Ndikimi i pakët qi ky sundim pati në formimin e mbrendëshëm të jetës së popullit, në kanunin e fisevet dhe në pjestimin e shoqnis me të gjitha rrjedhimet e thella, vlen së paku-deri në nji farë shkalle - edhe për pushimet e mâparshme. Por do t'ishte gjâ krejt e gabueme, po të dojshim me e mohuem ase edhe vetëm me e përçmuem

ndikesën e pushtuesvet të huej, sidomos t'elementit romak. Këso dore gjuha shqipe, sidomos fjalori i saj, ka ruejtë teprica prej të gjitha këtyne ndikesave: rrethanat e ndryshme luftarake – qytetare kanë futë herë pas here fjalë të hueja, të marruna uh'a nga gjuhët e pushtuesvet.

Por a mund të thomi, qi për shkak të këtij mozaiku të jashtëzakonshëm të fjalorit, se shqipja âsht

nji gjuhë e përzieme, e sidomos se ajo duhet të quhet nji gjuhë e përzieme gjysëm-romake? Kjo âsht nji çashtje për t'u rrahë, të cilën auktori i këtyne rreshtave beson se mund t'a mohojë. Duhet të dihet se ndikesa huej lypset të kërkohet në krejt ndërtimin gramatìkuer, në lakimet e fjalvet dhe në ndërtimin e fjalivet, dhe vetëm kjo ndikesë mund t'a vërtetojë përdorimin e fjalës *"Gjuhë e përzieme"*. Përziemje gjuhësore në kuptim të gjanë kemi gjithkund në botë, dhe dishmi për ketë farë përziemjeje gjuhësore në kuptimin teknik nuk Na janë paraqitë në nji mënyrë qi të na e mbushin mendjen. Por si do qi të jetë puna e çfarëdo qendrimi9 të mirret në këtë çashtje, elementet e hueja kanë randësi për gjuhën shqippe vetëm për kohën në të cileën këto kanë hymë në tê. Nji punë e tillë âsht shum e randësishme sidomos për shqipen tue qênë ser përmendoret e vërteta të saja gjuhësore vetëm shum vonë kanë nisë të na japin dritë në historín e saj.

Gjon Buzuku

Përgjithësisht deri në këto kohët e vona, gjuhëtarët kanë pasë zakon t'i caktojnë përmendoret mâ të vjetra të shqipes në shekullin XVII, dhe kanë qitë krëjt në harresë përkthimin e *Bibljes* së Dom Gjon Buzukut, qi ruhet në Seminarin priftnuer grek-unit në Palerm dhe qi âsht i vjetit 1555.[3] Shkrimet e auktorvet italo-shqiptarë, si Guzzetta e Parrini, thuhet se e kanë përmendun shkurtazi qenjen e këtij dorëshkrimi (ndonse shkruesi i këtij studimi nuk ka qênë në gjendje të vërtetojë me sy shenimet përkatse <u>të këtyne shkri</u>mtarve). Lajme mâ të gjata mbi ket dokument të vjetër

[3] *Këtu Norbert Jokl-i bjen në gabim, pse libri i Buzukut nuk âsht nji përkthim i Bibljes, por përkthimet e pjesvet mâ me randësi të liturgjis katholike: oficja e Zojës, shtatë Psalmet pendestare, disa pjesë të Ritualit etj. Prap Jokl-i gabon kur thotë se libri i Buzukut ruhet në Seminarin e Palermit. Puna qendron kështu: Emzot Kazazi në vjetin 1740 e gjeti ket libër në Bibljothekën e Vatikanit, ku gjindet edhe sot, ky përshkroi me dorë faqen e fundit të librit dhe i a dërgoi At Gjergj Guzettës, themeluesit të Seminarit të Palermit, kjo faqe rá në dorë mâ vonë t' At Pal Parrinit, i cili qe mâ i pari Drejtuer i Seminarit të naltpërmendun. Prej këtij libri Át Justin Rrota bani tri kopje fotografike, prej të cilavet njena gjindet në Bibljothekën Kombtare të Tiranës (Shenim i përkthyesit).*

shqip i kemi nga nji shkrim qi episkopi grek-unit i Palermit, Emzot Pal Skiroi i pat dërguem drejtorit të së përkohëshmes amerikane shqipe "Flamuri"("Dielli") (Boston –Mass, 18 Mars 1910, Nr. 5), botimi i njij pjese krejt të vogël të mbrendis së librit të Buzukut (faqe 58, shtylla 2, rreshtat 6-33, Kap. 17, vjershat 17-24) në revistën "Tomorri" (Elbasan, 1910, Nr. 12-30 Qershuer) na jep edhe mundësín të japim nji gjykim të përkohëshëm mbi gjuhën gege të kësaj përmendoreje. Nuk âsht nevoja të përmendet aq fort, se kjo vepër na paraqet dishmi të kjarta, të cilat i hapin rrugën ditunís gjuhësore për nji gjendje mâ të vjetër të gjuhës, tue studjuem vetít e disa djalekteve qi fliten sot. Natyrisht do të fitojmë mâ tepër dritë mbi vleftën, zanafillën, e kohën e përpilimit dhe mbi caktimin e vendit të botimit të kësaj përmendoreje vetëm atëherë kur do të kemi nji botim të plotë të saj, qi t'u përgjegjë të gjitha kërkesavet filologjike. Vetë Emzot Pal Skiro-i pat lajmuem qysh në vjetin 1913 se do të bânte nji botim (shif revistën "Fjala e t'in Zoti", vjeti I, Nr. 47[4].

Përmendore tjera shqipe

Kurse njohunít t'ona mbi shqipen e gjymsës së shekullit XVI tash për tash janë të pakta, jemi në nji gjendje mâ të mirë për sa i përket fundit të këtij shekulli, pse prej kësaj kohe kemi nji libër të vogël, të gjetun në Bibljothekën e Vatikanit. Mark La Piana (qi âsht pseudonymi i Gaetan Petrotës në Piana dei Greci[5] zbuloi në Cod. Barber. Latin. 3454 nji përkthim shqip të katekizmit. Ket përkthim e kemi në tri përpunime dhe âsht i bâmë prej Lukë Matrangës nga Piana e Arbreshvet dhe ka datën 20 Mars 1592. Teksti shqip dhe konteksti italisht i këtij katekizmi qe botuem me nji parathanë të bukur e me shenime prej vetë zbuluesit në revistën "*Roma e l'Oriente*", vj. II, Nr. 18-23, ashtu edhe si botim i posaçëm "*Il catechismo Albanese di Luca Matranga*", Grottaferrata, 1912[6] Gjuha e këtij libri përgjithësisht na paraqet djalektin e sotëm

[4] *Ky botim lajmohet me këto fjalë: "Edhe pak ka të botohet veç te një fletë e shtuame e "Fjalës t'in Zoti", libri i Dom Gjon Buzukut (1555), që kujtojën te të shkruamet e 'tire P.G. Guzeta, P./P. M. Parrini e Imzot G. Krispi (Shënim i përkthyesit).*

[5] *Mark La Piana nuk âsht pseudonimi i át Gaetan Petrotës, por âsht emni i vërtetë i njij shkrimtari të vlefshëm, edhe ky nga Piana e Arbreshvet të Sicilis. (Shenim i përkthyesit).*

[6] *Në vjetin 1931 At Justin Rrota botoi disa copa të zgjedhuna e të komentueme për Shkollat e Mesme nën titullin : "Shkrimtari mâ i vjetri i italo-shqiptarvet" D.Lukë Matranga. (Shenim i përkthyesit).*

t'Arbreshvet të Siqilis.

Përveç përmendorevet në dorëshkrim, të bâme të njoftuna në kohët e fundit, pati fatin të mos njifej deri vonë nga bota dijtunore, nga biblografët dhe nga gjurmuesit e gjuhës, as nji botim i vjetit 1625 *: "Speculum Confessionis, in Epiroticam linguam a Petro Budi episcopo Sapatense et Sardanense translatum*", Romae, 1621. Ky libër âsht një pasqyrë rrëfimi, e përkthyeme në gjuhën shqipe nga Pjetër Budi, i cili âsht prej njij katundi afër Krujës [7] dhe qi ka shum maritime për gjuhën e vet amtare. Libri âsht shum i rrallë[8]. Nji kopje të tij e zbuloi shkrimtari Faik Konica, drejtori i së përkohshmes "*Albania*" në Bibljothekën Mazarin të Parisit.

Dokumentat gjuhësorë qi na kanë mbetë nga koha përpara shekullit XVI, memzi mund t'a meritojnë emnin "*përmendore gjuhësore*". Me gjith këtê, na jep nji dishmí të çmueshme për shqipen e fundit të shekullit XV nji listë të vogël fjalësh, e cila gjindet në librin "*Die Pilgerfahrt des Ritters Arnold von Harff von Coeln*…" dhe qi ky e pat përpiluem në vjetët 1496 deri 1499 (botuem nga E. V.Groote, Coeln, 1860) dhe qi qe ribotuem prej G. Meyer-it në librin "*Albanesische Studien*" 2, faqe 4-5.

Nj' a 30 vjetë përpara kësaj dishmije, kemi edhe nji dokument tjetër gjuhësuer prej vjetit 1462, d. m. th. Nji formulë të shkurtën pagzimi, e cila u gjet në nji dorëshkrim latin të Bibljothekës *Laurentiana* dhe qi përmendet nga N.Jorga në librin "Notes et Extraits pour server à l'histoire des Croisades au XV-ième siecle" (IV-ième serie, Bukarest 1915, faqe 194). Shkrimtarët shqiptarë Dh. Beratti dhe Lumo Skëndo (Mid-hat Frashëri) e kanë ribotuem këtë dishmi të vjetër të gjuhës së vet amtare (Tribuna Albano –Romana) Nr.7 , Maj 1916 ;" Diturija" moti i dytë, Nr. 1 faqe 5)

Të nji kohe me fjalorthin e Von Harff – it duket të jetë nji formulë martese, qi na e lajmon G. Krispi në veprën e vet " *Memorie storiche di talune costumanze appartenenti alle colonie Greco-albanesi di Sicilia* ", Palermo 1853 faqe 88-89. Simbas Krispit, kjo formulë martese, e cila ka të gjitha karakteristikat e djalektit gegë, asht e vjetit 1500. Kjo formulë që zbuluem prej Krye-epishkopit të Shkupit D.Gjon Battista Nikollë Kazazit dhe që nxjerrë prej At Gjergji Guzzetës nga nji dorëshkrim i propagandës në Romë.

[7] *Katundi për të cilin flet këtu N. Jokl-i âsht Guri i Bardhë në Mat . (Shenim i përkthyesit).*

[8] *Libri nuk âsht aq fort i rrallë, pse përveç disa kopjeve qi gjinden në Seminarin e Palermit, e kanë edhe shum vetë dhe mjaft Bibljotheka. (Shenim i përkthyesit).*

Për krejt kohën, qyshë se Shqiptarët përmendën për herën në Mesjetë (Michael Attaliota 1040-1043) deri në dishmit gjuhësore qi parashtruem ma sipër, jemi të shtrënguem t`u sillemi vetëm pak çekjevet të rasëshme emnash dhe fjalesh shqipe në dokumentat latinë – romake, slave dhe greke.

Vetëm me "*Dictionarium latino-epiroticum una cum usitatioribus loquendi formulis per Franciscum Blanchum"*, të botuem në Romë në vjetin 1635 fillon radha e vorfën e përmendorevet ma të vjetra, qi janë ma të njoftuna. "*Blanchum*", qi gjindet në titullin e librit, asht nji përkthim nga shqipja i bardhë.

I sipër – permenduni Pjetër Budi botoi në vjetin 1664 në Romë me qëllim propaganda nji përkthim të katekizmit të famshëm të Kardinal Bellarminit "*Dottrina Christiana…Dal R. P. Roberto Bellarmino… tradotta in lingua Albanese dal Rev. Don Pietro Budi da Pietra Bianca.* Tue marrë parasysh vend-lindjen e Pjetër Budit, edhe kjo vepër asht hartuem në djalektin gegë, sikurse përgjithësisht, tue përjashtuem përmendoret gjuhësore të kolonivet shqiptare t`Italis, çdo gja qi kemi mbi dokumentat ma të vjetër të gjuhës shqipe, do t`u dihet Gegvet katholikë të Shqipnis Veriore.

Në pikëpamje të mbrendis, të shkrimit dhe të gjuhës, kryet e vendit në këtë letërsi e zen vepra e Pjetër Bogdanit *"Cuneus prophetarum de Christo salvatore mundi et eius evangelica veritate, italice et epirotice contexta et in duas partes divisa***"** Patavi , 1685. Vepra tjetër qi u botue në Venedik prej të njajtit auktuer në vjetin 1691 "*L'infabile Veritá della Cattolica Fede*" âsht e njâjtë përveç titullit me veprën "*Cuneus prophetarum*".

Bogdani qe prej njij familjeje fisnike të Gurit të Hasit (krahinë e Dukagjinit në prefekturën e Prizrendit), mâ vonë u bâ episkop i Shkodrës dhe pastaj pati drejtimin e Krye-epeshkopatit të Shkupit, ky pat nji kulturë te thellë skolastike-theologjike, zotnonte gjuhët klasike dhe shum gjuhë tjera lindore, na la nji vepër, e cila nuk asht vetëm nji përkthim, por na parashtron edhe nji dokrinë të gjanë mbi sendet hyjnore dhe nji histori biblike, të shkrueme në nji shqipe, në të cilën vihet re nji zotsi stylistike dhe nji pastërti gjuhe shembullore. Vepra e tij âsht nji meritim i mbrekullueshëm në qoftë se mendojmë se në kohën e tij gjuha shqipe ishte dhe âsht gjithnji sot nji gjuhë shum pak e përparueme.

Nën Papën Klementin e XI, i cili qe prej gjakut shqiptar, u mbajt në

vjetin 1703 nji Kuvend shqiptar krahinuer, vendimet e të cilit u botuen në vjetin 1706 në gjuhën shqipe gege"*Concilli provintialli o cunvendi i Arbënit*" Romae.

Misjonari Francesco Maria da Lecce na la me veprën e vet "*Osservazioni grammaticali nella lingua Albanese*" Romë, 1716 nji përpilim themeluer gramatike të gjuhës shqipe në djalektin gegë, i cili qe shtypë në shkurtim në Pasqyrat krahasuese të Vatersi-it (Halle 1822)

Në Chieuti (Capitanata n`Italin e poshtme) u gjet nji dorëshkrim, zanafilla e të cilit mrrinë në vjetin 1737, mbrendin e këtij dorëshkrimi na e paraqesin tri botimet e M.Marchiano-it:

1) "*Canti popolari albanesi delle colonie d`Italia*" Foggia, 1908. Kangët popullore të botueme në këtë libër përkojnë pjesërisht me kangët mbledhjevet të maparshme ( Basile, Vigo, Dorsa, De Rada: "*Rapsodie d`un poema Albanese*". Firencë 1866, Camarda, Biondelli) dhe me ato të mbledhuna ma vonë nga A.Scura: " *Gli Albanesi in Italia*", Neë –York (1912). Mbledhja e bame nga Marchiano i mbështetet në nji doreshkrim qi e ka daten; por pa dyshim këto kangë, për sa i përket mbrendis së tyne, jan shum ma të vjetrase të shekullit XVIII. 2) " *Poesies acre albanesi*" Napoli 1908 dhe 3) Nji katekizëm" *Il christiano Albanese*", qi u botue në revistën romake theologjike "*Bessarione*", vjeti 15, bleni 27. 185-217. Auktori i kangvet fetare dhe i Katekizmit asht Don Nikolla Figlia, kryeprifti i Mezzojuso-s në Siçili.

Kolonit shqiptare t`Italis kanë meritimin e poezis së parë shqiptare në shekullin XVIII 1): asht libri i Varibobës" Gjella e Shën Mëris Virgjër", Romë 1762; kjo vepër përmbanjetën e Nanës së Krishtit në vjershë, qi u ribotue në "*Grammatica Albanese*" (Manuali Hoepli, Nr.253, 254 Milan 1897, të Librandit).

Po të shtojmë edhe dy fjalorët e vogjel: të Kavaljotit "*Protopeiria*", Venedik, 1770 (i ribotuem në *Untersuchungen Ueber die Geschichte der Oestlichen Eurepaeischeu Voelker*" të Thunmann – it, Leipzig 1774, dhe në " *Albanesischen Studien* " të G. Meyer-it, bleni 4) dhe të Danjelit " *Eisagogike dhidhaskalia*" , Voskopojë 1770, kemi parasysh për sa dijmë deri sot, nji pasqyrë të plotë mbi burimet gjuhësore për kohën deri në fillimin e shekullit XIX.

Me gjith atë, shkrimtari italo – shqiptar G. Krispi ("*Memorie sulla lingua Albanese*" Opuscoli, faqe 127 vrejtje) na parashtron edhe dy dorëshkrime ma të vjetra fjalorësh, të cilat ruhen në bibljothekën e Seminarit Shqiptar: njeni nga Catelano, krye-epishkop i Durrsit dhe

tjetri nga Nikolla Chetta. Prej këtij të fundit na paraqet vetëm nji prove krejt të vogël. Nji radhitje mâ e përpikët e këtyne shkrimeve âsht sot për sot e pa mundun, pse nuk dijmë kurgjâ mâ të sigurtë mbi mbrendín e tyne dhe mbi kohën e përpilimit. I pari këtyne auktorve, Catelano, vdiq në vjetin 1694. Kot u përpoq Gustav Meyer-i për shfrytëzimin e këtyne shkrimeve.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Stela **KARAFILI**

LLUKE H. KARAFILI (BARDHYLI), personalitet i kulturës kombëtare.

(Shënime biografike sipas dorëshkrimit biografik të Bardhylit)

Llukë H.Karafili, me alias Bardhyli, i biri i Hristo Harallambi Karafilit dhe i Poliksenit Pavel Tehika, u lind në Berat, në lagjen Kala-Kështjellë në shtëpinë e stërgjyshëve .. *"më 17 tetuer të vitit 1892 ose pas vitit Muhamedan 1309 dhe në çertifikatën e Pagëzimit figuron i lindur në vitin 1893, po ky është shkruar me hamendje se mungonin rregjistrat kur e këmi kërkuarë ata, po më e sigurt është letërnjoftimi ottoman që ka datëlindjen në vitin 1892. Në letërnjoftimin e Shtetit Shqiptar është shënuar datëlindja, më 17 tetuer 1894.*

I ati, Hristo Karafili ka qenë një nga bashkëpunonjësit e Kostandin Kristoforidhit dhe nënpunës i lartë i drejtësisë në Perandorinë Turke, kurse e ëma ka qenë Polikseni Pavël Çika, njera nga pinjollët e familjes se moçme dhe bujare, Çika të Vlorës.

Mësimet e para i mori në Ersekë, pasi i ati si i nëpunës i qeverisë osmane punonte aty.

"Kur vajti im atë –shkruan Bardhyli - *në Kolonjë t'im vëlla vendosi ta dërgojë në Korçë për të mbaruar gjymnazin dhe unë ndenja me prindërit me shpië në Ersekë. . Me t'im vëlla im 'atë shpenzonte gati gjysmën e rrogës , dhe kjo më vinte inatë dhe zihesha me të.*

Në Ersekë Bardhyli u shtërngua të ndiqte shkollën fillore turke (Iptidadije) , ku kishim një hoxhë plak të quajtur Asim Efendi nga Libohova , .. "*një mësues që nuk kishte metodë dhe u mbante hatërtin djemvet të bejlerëve. Dy vjet zgjaten mësimet në këtë shkollë e më pas në të njëtin qytet futet në shkollën qytetëse (Rushdije). "Këtu –shkruante Bardhyli kishim një mësues të quajtur Sali Efendi nga anët e Bilishtit.* Edhe për këtë mësues ai ka rezervat e veta, ndonëse e theksonte se ai ishte zoti.

Me transferimin e të atit në Elbasan , Lluka vijoi të ndiqte shkollat turke. "*Vajta në Itadije (Gjymnas) –e cila pas fillores kish vetëm një klasë d.m.th. qytetëse dhe nji vit Lice. Këtu u rregjistrova në shkollë, por isha tepër i dobët dhe nuk vijoja dot mësimet, e para se nuk dija gjuhën dhe e dyta se isha i dobët dhe nuk vijova dot mësimet e tjera, kështu që im atë më hoqi nga shkolla dhe më vuri të mësoj mjeshtrinë e rrobaqepsit.*

Më pas, përmes vështirësive të shumta të lidhura këto edhe karakterin e tij, siç pohon vetë: *kokëfortë, i pabindur, i shkathët, tepër zgjuar nga natyra zemërak ndaj padrejtesive etj.arriti të mbarojë shkollën greke qytetësë të lagjes Shënkoll të Kalasë , për të vijuar më tej formimin në Gjimnazin e njohur grek të Janinës "Zosimeja Skoli". Këtu -shkruan ai- më futën në të dytën e Gjymnazit, d.m.th në të I Lice të Kursit të Lartë, atëherë ky gjimnaz kish 7 klasë dhe filloret e Janinës. Mirëpo unë isha shumë i dobët dhe i math për mësimet , e megjithëqë kisha vajtur vonë në shkollë ju vërtita punës me zell , por pas pak muajësh më përzënë nga shkolla për arsye se flisnja mirë për Shqipërinë dhe kisha vajtur në klupë të shqiptarëve duke tërhequr me vehte edhe shokë të tjerë shqipëtarë, gjë kjo që nuk u pëlqente propagandës greke, në atë kohë, dhe kjo shkaktoi dëbimin t'imë nga shkolla.*

Sikur të kisha vajtur –plotëson mendimin e tij Karafili- në nji shkollë Europiane dhe të kisha mësues edhe profesorë tërheqës me sgjuarsi që kanë patur dhe me studimin që bëja do ta kisha mbaruarë shkollën me sukses të math."

Përjashtimi nga gjimnazi e detyroi atë të kthehet përsëri në Korçë ,por kësaj radhe u vendos.".. *tek e ëma e njerkës, zonja Ana Dinçolli,*

pasi babai Hristo pas vdekjes së s'imëje ishte martur me Eupropsinëa Drançolli. Krahas punës si shergert ai studion *"..që të plotësonte klasat e Liceut që kishte mbetë pa dhënë provime, por më kot se shkollat atëherë nuk pranonin nxënës të jashtëm".*

Kjo situatë nuk e pengoi të përpiqej për zotërimin e njohurive, kësaj radhe në rolin e një autodidakti. .

."Studiova gjithë librat shqip që ishin botuar në Bukuresht, Sofje, Selanik dhe Korçë. Bleva shumë libra grekë historikë, letrarë, dhe romanca dhe rrinja gjer më natë për çdo ditë duke studjuarë gjithashtu studiova edhe librat e Liceut që i merrja prej shokëvet në Korçë gjer në fund të klasit VII të Gjymnazit. –shkruante ai.

Korça e asaj kohe ishte një qendër e rëndësishme e patriotizmit shqiptar. Në Korçë u njoh dhe zuri miqësi me Mihal Gramenon, Themistokli Gërmenjin, Stavro Karolin, Pandeli Calën, me Bejlerët e Pojanit, Spiro Belkamenin, Mihal Belkamenin, Mihal Xoxen, Sotir Pecin, Goni Katundin, Thoma Deshnicën etj.

Ambienti patriotik e yshti rishtazi t'i bashkohej nismave e aksioneve patriotike të kohës. Në biografinë personale ai na njeh me disa nga shoqëritë patriotike ku kishte marrë pjesë:

"*Që kur isha i vogël në Elbasan , mora pjesë në shoqërinë e Djemvet në Kala. Kur isha në Korçë mora pjesë në shoqërinë "Lidhja Ortodokse" dhe në Shkollën e së Djelës të shkollës Amerikane në Korçë.*

Në vitet 1911-1912 merr pjesë në Kryengritjen Shqiptare në çetat e Gorës bashkë me Kol Rodhën, Kajo Bej Zagarin, Xhelal Selcën dhe Kajo Babjanin. Ai ishte sekretar i kësaj çete. Me optimizmin e patriotizmin djaloshar, Lluka gjendet kudo në Shqipëri ku ndjehet era e lëvizjeve patriotike.

Më 1913, në Vlorë merr pjesë në klubin "*Labërija*", një shoqatë opozitare me Qeverinë e Vlorës ku i kërkohej Ismail Qemal Bej Vlorës, jo vetëm respektimi i veprimtarisë së patriotëve, por edhe marrjen e masave për rregullimin dhe lirimin e vendit nga të huajt. Ndërkohë shkruan dhe ankohet në fletoret e Londrës dhe të Romës për genocidin greko-serb ndaj shqipëtarëve.

Më 1914, nën komandën e Atë Stath Melanit, shkon në Mal të Sinjës në luftën që u bë kundra rebelëve të Shën Jakut. Mori pjesë në luftën e Vlorës, më 1920 dhe burgoset prej qeverisë italiane.

E më tej shënon të ketë marrë pjesë "*..në Shoqërit Fillodramatike që janë krijuarë në Vlorë, në Shoqërinë "Mbrojtja Kombëtare, në*

Federatën "Atdheu" në "Kryqin e Kuq"të të Rinjvet, në Akademinë Provizore për përkthimin e termavet administrarive dhe ushtarake në gjuhën shqipe.

Pasioni i tij si një atdhetar i thekur pasqyrohet dhe në fushën e oratorisë, në ligjërimet e tija publike në mitingjeve kundra greke apo edhe në rastin e përvjetorëve të Pavarësisë.

Në festimet e 15-vjetorit të Monarkisë, Bashkia e Vlorës në shenjë mirënjohje për kontributin e tij atdhetar ne 1927 i ka dhuruar libra të Hilë Mosit.

Studimet e Larta i kryen në vitet 1922-1924 në Itali, në Universitetin e Napolit për Shkenca Juridike. Më tej po gjatë viteve '20 të shekullit të kaluar vijon të studiojë në "*Istituto di Studi Medi e Superiori*" të Firences, ku merr diplomën ekspert në Shkenca Politike Sociale dhe për pak kohë ndjek disa kurse studimore në Rumani në Universitetin e Clujit.

Gjatë këtyre viteve ai bëhet edhe anëtar i mjaft shoqërive të ndryshme kulturoro-shkencore, që për kohën ishin të barasvlerëshme me Akademi Shkencore, si: "Societa della Cultura Macedo- Romana", "Circolo Religiose Universitario di Napoli", Academia Internazionale di Istituto di Studi Medi Superiori ed Fiduciario", anëtar i Akademisë Saveriane të Shkodrës, pranë kolegjit Saverian të Etënve Jezuitë në Shkodër, korespondent i Institutit Shqiptar të Tiranës, korespondent i shoqërisë "*Akadhemaiku Omilu Philosophikis Skolis Panepistimiu Athenon*"

Lluka Karafili ka dhënë një ndihmesë të madhe në zhvillimin e arsimit. Shërbeu si mësues i shkollave shqipe nën sundimin osman. Në vitet 1912-1914 mësues në shkollën Qytetënore dhe Fillore të Vlorës; 1916 – 1919, Drejtor i shkollës shqipe dhe didakt në Delvinë, në vitin 1920, Drejtor i shkollavet të fshatit Nartës të Vlorës, më 1924- 1925, mësues në shkollën e Kamenicës dhe në Korçë; më 1925-1926 mësues në shkollën Plotore dhe në atë Tregtare në Vlorë, po atë vit mësues në shkollën Plotore të Durrësit; më 1927, Drejtor i Strehës Vorfënore në Tiranë; më 1928-1929, përsëri mësues në Shkollën Tregtare në Vlorë; më1929-1932, mësues në Shkollën Plotore në Lushnjë; më 1932 – 1933, Drejtor i Korrispondencës në shkollën e Konispolit; më 1933-1940, Drejtor i Shkollës Femërore në Lushnjë. Më 1940 Lluka Karafili vendoset në Shkodër. Martohet me zonjën Angjelina Mirashin Karafilin dhe në periudhën e viteve 1940 – 1944 punon mësues në Institutin Saverian të Etnevet Jezuitë në Shkodër, cikli fillor dhe gjimnaz, dhe

më 1945-1946, mësues dhe përgjegjës i shkollës në fshatin Kallmet të Zadrimës.

Gjatë kryerjes së detyrave shtetërore Bardhyli ju kushtua edhe veprimatrive të ndryshme në lëmin e kulturës, si në kurset e mbrëmjeve kundër analfabetizmit, në krijimin e bibliotekave shkollore, etj.

Në shënimet biografike ai paraqet një tabllo të saktë të gjendjes së shoqërisë dhe arsimit shqiptar të kohës. *Ministria ose më mirë të thomi ata që rrinin nëpër ministriara kur shikonin një punëtorë donin që ta shtypnin; drejtorët me shumë mangësi në karrierën delikate të mësuesisë; inspektorë që kishin mbarur studimet e larta në Austri nuk mund të aplikonin metodat e reja të mësimdhënies pasi mungonin librat, baza materiale etj.*

"Shkolla të çveshura gati nga çdo gjë, nxënës pa mjete dhe pa veshje; nivel i ulët profesional etj.

Lluka H. Karafili pati miq intelektualët e kohës. Në rrethin e miqve të ngushtë shquheshin figurat e shquara ndër vite të shkencave albanologjike shqiptare, si: Ernest Koliqi, At Zef Valentini, Ilo Mitkë Qafzezi, Kole Koci, Eqerem Çabej, Mahir Domi etj.

Nxënësit e tij kanë qenë edhe figura të njohura. si: Petro Marko, Dom Simon Jubani, Jup Kastrati, Kolë e Gjon Kamsi etj.

Mjaft e spikatur është edhe veprimtaria e tij në fushën e publicistikës ku ka bashkëpunuar si gazetar me shumë të përkohshme të kohës, brenda dhe jashtë vendit, si: "Zgjimi"; "Dielli", "Hylli i Drites", "Leka", "Shekulli i Ri"; "Vatra e Rinisë"; "Gazeta Shqipetare", "Tomori i Vogël", "Donika" "Njeriu" etj. Ka drejtuar për pak kohë edhe gazeten "Shqipërija e Re" në Konstancë dhe fletoren "Mbrojtja Kombëtare" në Vlorë.

Si fletar, ka pasur gjuhë të kthielltë dhe të pastër me stil të thjeshtë dhe të kuptueshme e popullore, dhe artikujt e tij këndoheshin me shije prej publikut, por *Fletorizma* i kushtojë shumë në karrierën e nëpunësisë për kritikat e bëra veçanarisht Ministrisë s' Arsimit dhe gabimeve të bëra prej saj dhe prej nëpunësve të saj dhe nëpunësve të tjerë dhe ku ish shkaku kryesor që u luftua ashpërisht.

Nga shkrimet më të vlefshme që ai ka botuar në këta të përkohshme veçohet shkrimi i gjatë dhe analitik i shtrirë në 13 numra, në një hark kohor prej rreth gjashtë vitesh (XII/1937-nr. 11 XIX 1943, nr.1-3) që gjëndet në revistën "Hylli i Dritës", titulluar: "*Historija e bibliotekavet në Shqipërië*" i kushtohet të ndjerit At Shtjefën Konstantin Gjeçov

o.f.m. .

Jashtë vëmendjes së së Bardhylit nuk ngelen as analizat e censhme studimore për krahinat e Shqipërisë Qendrore dhe Jugore, për qytete e zona si: Lushnja, Delvina, Saranda, Çamëria, Konispoli, Valagati etj. Trajtesat gjenden në disa numra përgjatë disa viteve në fletët e "Hyllit..." dhe të "Lekës". Mjaft të vlefshme janeë edhe studimet mbi gjurmimet e hershme kulturore të *Sinisë Ilirike* dhe gjurmimi dokumentave historike dhe personaliteteve të shquara të historisë kombëtare.

Lluka Karafili ishte autor i disa veprave letrare përkthimeve dhe didaktikë, mes të cilave veçojmë: " *Decir' e dacurise*" , libra me vjersha shqip botuar në Korçë më 1912 ; Giuseppe Lo Iacono – "*Të parat fjal edhe të parat mendime*" libër gjuhësh, përkthim në shqip i ballafaquar me origjinalin në italisht, 1919; "*Lulishtja Djelmenore*" Abetare, Konstancë 1922.

Më 1946, rregjimi i ri komunist nuk e lejoi të punonte më. E nxorrën në pension pa të drejtë page, duke e orientuar që të bashkëpunonte me instucionet shkencore të sapo krijuara.

Ndonëse u cilësua si bashkëpunëtor dhe studiues i jashtëm në Fakultetin e Histori Filologjisë në Tiranë, në të shumtën e rasteve studimet e tij nuk u morën kurrë në konsideratë pasi ata nuk ecin paralel me idealet e atij sistemi. Artikujve të tij i mungonte partishmëria, por në vitet e mëpasme mbi të rëndonte edhe biografia. Lluka ishte i deklasuar, i vëllai u pushkatua. Në korrespondencën e gjatë të letrave,që ndodhen në familjen Karafili kuptohet qartë që studimet e tij ndonëse nuk pranoheshin, nuk i ktheheshin atij, e në ndonjë rast botoheshin edhe me emra të tjerë.

Në vështirësi ekonomike nga vitet e fundit të jetës Lluka H. Karafili u detyrua të shesë bibliotekën personale, njera nga më të mirat bibliotekë në Shkodër dhe më gjerë me mbi 2500 vëllime shumë të çmuara në gjuhën shqipe, greke, italiane, frënge të fushave të pedagogjisë, letërsisë, historisë, ballkanologjisë, albanologjisë dhe mjaft dorëshkrime. Fatmirësisht ishte këmbëngulja e bibliotekarit të shquar, Ë. Kamsi që kjo bibliotekë të qëndronte në Shkodër dhe të pasurohej kësisoj biblioteka e Institutit Pedagogjik të Shkodrës, sot Biblioteka Shkencore e U.Shkodër.

Vdiq më 1976, thuajse i lënë në harresë njëri nga personalitet e shquara të kulturës kombëtare.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Dr. Luigj **Martini**

DR. MIRASH IVANAJ, KALORËSI I MENDIMIT TË LIRË[1]

Hyrje

Atë ditë të largët shtatori, shtatori plot diell, 67 vjet më parë, atëherë nxënës i gjimnazit të Shkodrës, tek po kthehesha si zakonisht mbas mësimeve në shtëpi, në krye të rrugëzës Çekaj, që larg dallova në fundin e saj staturën e plakut të mirë z. Luigj Mjeda[2], tek qëndronte galuc, dhe në heshtjen e tij tymoste me ëndje, si zakonisht, një të dredhur.

Ishte një ritual pothuajse i përditshëm. Ndryshe nga ditët e tjera, atë ditë po më priste jashtë derës së madhe, siç e quanim ne atëhere.

Instiktivisht shpejtova hapat për t'ia kufizuar mundësisht kohën e qëndrimit në hije, ku binte drita, drita si zakonisht. Isha në vitin e parë të gjimnazit. Ai e donte shkollën, ndaj ishte përpjekur shumë që unë të ndiqja atë shkollë. Interesohej për mirëvajtjen time.

Sinqerisht donte që, unë të isha ndryshe nga bashkëmoshatarët e mi. Ndjehesha fatlum dhe i obliguar.

Ajo ditë, sikur, është fiksuar në kujtesën time, ndryshe nga të tjerat. Tek rrinim në heshtje, ai sikur vriste mendjen për të gjetur ndonjë frazë për të rifilluar bashkëbisedimin e zakonshëm për shkollën. Befas m'u kujtua që një ditë më parë më kishte pyetur, se kush është drejtor në gjimnazin e Shkodrës. Theva heshtjen dhe, pasi i thashë emrin e drejtorit shtova se akoma nuk e kam parë. Flitet se është në ikje dhe mendohet se do ta zëvendësojë Skënder Vila.

[1] *Libër (monografi) në proces pune. Pjesë nga libri.*

[2] *Luigj Mjeda (1890 -1962). Modeli klasik i njeriut të mirë. Nga profesioni rrobaqepës. Një nga themeluesit e Shoqërisë "Bogdani". Aktor me diapazon të gjerë artistik. Interpretues i mbi 50 roleve. Drejtor i gazetës "Ora e Maleve". Dy herë i dënuar në burg, nga Mbreti Zog dhe nga pushteti komunist.*

“Ashtu”?! - përsëriti me vete disa herë emrin dhe mbiemrin e drejtorit që i thashë. Mendova se mos e njihte. Heshti. Heshtja më dha të kuptoja, se ndoshta nuk e njihte.

Më bëri përshtypje toni i veçantë i zërit të tij. M’u duk sikur nuk ngjante aspak me atë të pak çasteve më parë. Kishte diçka të veçantë, të largët, me nota të theksuara nostalgjike që nuk e di, sepse më zgjoj një ndjenjë që lëkundej në mes simpatisë dhe një farë ndrojtjeje të papërcaktuar, që sa vinte dhe bëhej më e pazakonshme për mua. Z. Luigj kishte ndezur një cigare. E kishte vendosë në buzë të tavllës. Herëpashere thithte cigaren, por pa hequr vështrimin nga unë. Fliste me zë të ulët, duke u munduar të përmbahej. Dukej i emocionuar. Befas, theu heshtjen, duke përmendur një emër: Mirash Ivanaj. Më pas shtypi fundin e cigares, që kishte kohë që ishte shuar.

-*Kush është ky Ivanaj?* - pyeta unë i befasuar.

-*I□anaj, jo Ivanaj*, - korrigjoi ëmbël ai.

Ndjeva peshën e vështrimit të tij të rëndonte, megjithatë,ëmbël për shqipërimin e pasaktë.Në ndarje sikur dallova një mëdyshje në sytë e tij. Fryma sikur iu mek. Kolla iu bë më e fortë. Sikur pushtua nga një tik nervor jo natyral, ndonëse përpiqej ta maskonte me njëfarë buzëqeshje të shtirur që ishte e pazakontë për të.

Vendosa të mos hesht. Në çast e pyeta se kush është Mirash Ivanaj. Pyetjen time e përcolli me një heshtje të stërgjatur pa m’i ndarë asnjëherë sytë.

“ *Mirash Ivanaj është një nga figurat madhore të vendit tonë, si njeri, si intelektual i shquar, si publicist i guximshëm, si edukator, drejtues dhe reformator i guximshëm, si erudit dhe shqiptar atdhetar i pakompromentueshëm”*, - tha me një zë disi të zvargur e plot nota nostalgjie Luigj Mjeda.

-*E keni njohur personalisht?*

-*Po. Fillimisht si kundërshtar*.[3]

Por më vonë kur kuptova që jeta e tij ishte lidhur me idealet dhe jo me kolltukun, sikur ndryshoi puna. Të imponontе respekt, jo atë respektin e distancuar që njeriu ndjen për atë që i përket së kaluarës. Ishte aq i drejtpërdrejtë, sa që kur të fliste harroje se ishe përballë një përfaqësuesi madhor të arsimit të shtetit.

[3] *Gazeta “Ora e Maleve” (15 Prill 1923 - 15 Dhetor 1924). Luigj Mjeda ka qenë drejtor i dytë i saj mbas Shuk Gurakuqit. Ndërsa Mirash Ivanaj ka qenë në të njëjtën kohë drejtor i gazetës “Republika”. Gazeta ishte me interesa të kundërta. Në faqet e saj debati ishte përherë i pranishëm..*

Pasi drodhi një tjetër cigare, vështroi orën dhe u bind që kishte kohë, më pyeti:

- Ti e njeh profesor Kel Ujkën, që jeton këtu në lagjen tonë?

Unë nuk i dhashë përgjigje.

Z. Luigj Mjeda vazhdoi: "*Në vitin 1928, njëzet e gjashtë vjet më parë, kur ishte profesor në gjimnazin e shtetit, goditi një nxënës të padisiplinuar, rrebel që e kish ofenduar me fjalë të rënda në prani të nxënësve të tjerë të shkollës. I ati i djalit, i prekur për cënimin e sedrës të birit, i del përpara mësuesit dhe hakmerret duke e goditur me një flakaresh. Profesor Keli, i fyer publikisht, nxori revolen dhe e vrau*".

Mirash Ivanaj i prekur thellë për dinjitetin e mësuesit, ndjeu për detyrë t'i dilte zot. Së bashku me të vëllain, Martinin që asokohe ishte jurist në Tiranë e ndjejnë si detyrim mbrojtjen magjistrale të profesorit. Mbrojtja e vëllezërve Ivanaj në gjykimin e profesor Kel Ujkës nuk kaloi në heshtje, në Shkodër. Ajo pati një ndikim të madh në ngritjen e moralit qytetar të të gjithë mësuesve të Shkodrës. Dy vjet më vonë profesor Kel Ujka, i transferuar atëherë në Gjirokastër, do të përshëndeste kështu Mirash Ivanajn: "*..Në këtë datë mbush dy vjetë që jam liruar nga burgu pa ndonjë damkë ligjore vetëm prej vullnetit tuej të patundshëm dhe të z. Martin. Prandaj e ndjej për detyrë që në këtë ditë të veçantë me ju falenderuar dhe me ju përshëndetë me kuptimin e plotë të fjalës si bamirsit dhe shpëtimtarët e mi.*"

Mirash Ivanajt i dhimbsej shumë çdo humbje dhe çdo cënim i autoritetit të çdo mësuesi të shkollave të Shkodrës, edhe kur ai nuk i njihte personalisht. I tillë ishte ai burrë, pa artifica. Ai dinte të sillej me këdo. Edhe me kundërshtarët ai ishte ndryshe nga bashkëkohësit e tij."

-*Me ju si komunikonte si kundërshtar apo si bashkohës*? - e pyeta unë me instinktin fëminor.

Qeshi dhe më hodhi dorën në qafë.

"*Nuk ishte tip i shoqërueshëm, nuk i kërkonte miqësitë e reja. Por as nuk i shmangte.*

Përkundrazi ndjente kënaqësi kur i shërbenin punës. Dinte t'i përshtatej të gjitha moshave. Ndoshta këtë cilësi e kishte fituar gjatë karrierës së tij si mësues. Nuk fliste shumë. Dhe kur fliste mendimet i argumentonte pa ngut. Mendonte para se të fliste. Gjithçka që bënte e bënte mirë dhe pa mërzi. Në rrethin e tij shoqëror kishte edhe shumë nga ata që konsideroheshin personalitete. Ai kurrë nuk kërkoi vëmendjen apo ndërhyrjen e tyre. Parapëlqente që gjithçka ta kishte nga puna e tij.

Mirash Ivanaj nuk ishte nga ata njerëz që duan të gëzojnë privilegjin që të flasin të fundit. Udhëhiqej nga fakti që njeriu para se të shfaqte ndonjë ide duhet ta mendonte mirë që të mos lindte nevoja ta kundërshtonte atë, që e kishte përkrahur më parë.

Ishte fat i madh që ky meteor i mendimit të lirë u kthye në Shqipëri në kohën e duhur, atëherë kur asaj i nevojitej. Ishte pikërisht ajo kohë kur në skenën e historisë përpëliteshin shtresat e paformuara shoqërore për formimin e shtetit shqiptar. Të një shteti larg botkuptimit të vjetër. Të një shteti që të krijojë premisat e duhura për një shoqëri domosdoshmërisht të arsimuar", - shtoi plaku i mirë duke ngritur supet, shenjë që tregonte qartë pakënaqësinë e tij që Ivanaj nuk ishte kuptuar nga bashkëkohësit ashtu siç do të donte ai.

Ajo që filloi në ato ditë të shtatorit të largët të vitit 1953, ndoshta edhe nuk ishte e rastit, sepse mbartëte në vetvete një fat tragjik dhe një dhimbje të madhe. Konçidencë për të mos e harruar kurrë pikërisht ato ditë, Mirash Ivanaj përpëlitej në agoninë e vdekjes vetëm 12 ditë para se të përfundonte dënimin dhe të lirohej nga burgu. Këtë do ta mësoja 41 vjet më vonë nga libri impresionues i nxënësit, mikut dhe bashkëvuajtësit të tij, të nderuarit Lazër Radi, i titulluar "Misteret e një Ministri".

Takimet tona me z. Luigj Mjeda ishin pothuajse të përditshme. Ata ndiqnin rrjedhën e tyre të zakonshme, derisa mbarova gjimnazin. Por asnjëherë, çuditërisht, nuk u bisedua më për Dr. Mirash Ivanaj. Asnjëherë nuk më tha arsyen e kësaj heshtjeje.

Gjatë rrjedhjes së viteve u rrit natyrshëm dëshira për të ndjekë deri në fund fatin e tij, fatin e një shqiptari të madh që bënte pjesë ndër më të paktët intelektualë të vërtetë, që kishte pasur Shqipëria në ato vite të vështira, kur po hidheshin themelet e shtetit shqiptar.

Shtysa e parë në këtë çasje, nuk ishte thjeshtë predispozita ime, por edhe konstatimi i hershëm i një raporti disi ndryshe në mes tij dhe bashkëkombasve. Mirash Ivanajn, heshtazi të gjithë e donin dhe e respektonin, por për të shkruar për të, deri vonë sikur hezitonin. Ndjehem fatlum që i hyra kësaj rruge për të njohur sa më thellë madhështinë e figurës së Mirash Ivanajt.

Duke u kthyer, përsëri, tek i nderuari Lazër Radi, në mes të tjerash ai shkruante: ".. *Nuk e thotë pa bazë populli se në burg njihet vlera e vërtetë e një burri. Këtë të vërtetë do të mundohem ta paraqes edhe me anën e kësaj skice, të ngacmoj talentin e ndonji kompetenti, që ta*

shkund pluhurin e kohës që mund të ketë rënë mbi të dhe dhe t'ia tregojë brezave të ardhshëm tërë të vërtetën mbi këtë njeri të madh".

Autori

Mirash **IVANAJ**

Ishte një nga pasardhësit e denjë të derës së njohur të shtëpisë me zë të Mirash Ujkës nga Bekajt e Triepshit të Malësisë së Madhe, në administrim territorial të Malit të Zi.[4]

Prindërit dhe farefisi i tij i përkasin atyre shqiptarëve të zakonshëm që jeta u kishte mësuar të përballojnë të gjitha të këqijat, dhe nderin ta mbrojnë të pacënuar deri në at' cak ku mund të arrijë forca e tyre mendore. Natyrshëm dinin ta nderonin vëllazërinë, miqësinë, mikëpritjen dhe gjithçka tjetër të vogël apo të madhe. I gëzoheshin të paktës dhe të bukurës, ashtu siç i zemëroheshin të keqes, të shëmtuarës dhe të padrejtës. Kjo ndoshta ishte hapësira dhe dimensioni i tyre, aspak të dëmshme, përkundrazi të vetmet zgjidhje për një popull të thjeshtë, pa shtet, ku zakoni është ligji më i fortë që rregullonte jetën brenda fisit. Kjo siç duket e ka formuar dhe e ka begatuar karakterin e tyre dhe ka kultivuar tek ata nderin e tyre, për të cilin ishin kurdoherë të gatshëm të sakrifikonin gjithçka.

Është pikërisht kjo që na qartësoi faktin që edhe në ato kushte, edhe në shtigjet e ngushta të maleve dhe luginave atje larg në kullotat e pakta të Hotit, Grudës dhe Trieshit të lind, të rritet dhe të mbetet aq e pathyeshme edhe para pushtuesve më të tmerrshëm, të cilët asnjëherë nuk arritën të shuajnë shkëndinë e mendimeve fisnike kësaj treve.

"..... Vetëm ndërhyrja e diçkaje hyjnore, - shkruan Mark Milani, Vojvoda i madh i Malit të Zi, - i ka bërë shqiptarët që të lakmojnë aq shumë nderin dhe të jenë aq xhelozë për vendin e vetë sa të mos u dhimbet as edhe jeta...[5]

[4] *Në vitin 1878 tokat shqiptare iu aneksuan Malit të Zi. Banorët ishin të detyruar të deklaronin prejardhjen dhe mbiemrat e tyre. Një pjesë e tyre mbajtën emrin e gjyshit të tyre "Ujkës".Ndërsa Pjetri, Leka dhe Pali, mbajtën emrin e atit të tyre "Ivanit", qënë faktishte i vëllai i Ujkës.*

[5] *Mark Milani, "Zhivot i obiçaj Albanasa" (Jeta dhe zakonet e shqiptarëve). Përkthim i Lazër Radit. Tiranë, 1955. fq 46.*

Vëllezërit Ivanaj historikisht janë njohur si burra të mendimit dhe me kontribute të mëdha në mirëqeverisjen popullore të krahinës së Triepshit. Kryesisht në ruajtjen të pacënuar të vlerave e të zakoneve të mira dhe sidomos në mënjanimin e zakonit të gjakmarrjes, në ruajtjen me xhelozi të gjuhës dhe të pastërtisë së gjakut.

Shtëpia e tyre ka qenë strehë e përhershme e njerëzve të thjeshtë, që jetonin me ligjet dhe zakonet shqiptare, pa paragjykime, por me ndore të fortë.

Devotshmëria dhe vetmohimi i kësaj bashkësie e mbështetur në fe të lashtë, ruajnë dukshëm veçoritë kombëtare, historike dhe shoqërore të këtyre banorëve tipikë të maleve.

Kjo popullatë e shkathët e pasur me vlera shoqërore nga të cilat spikasin ato shpirtërore, pasqyrohen dukshëm që në takimin e parë në zemrën e hapur, në buzëqeshjen dhe në shkëlqimin e syve kur miku edhe i panjohur ia mësyen derën.

Kundërshtarë të fortë të pushtuesve osmanë dhe i çdo shkelësi tjetër. Është pikërisht kjo cilësi e përhershme që për shumë e shumë vjet ua vështirësoi jetën. Ata ishin ndër të parët që ju bashkuan lëvizjes së fuqishme kombëtare. Edhe pse në kushte të vështira jetese, përherë të përndjekur nga pushtuesit turq, në vitin 1878 pas kalimit të Triepshit nën administrimin e Malit të Zi, familja Ivanaj u vendos fillimisht në fshatin Rakiq në breg të lumit Cen.[6]

Fusha, dimri i butë dhe jeta larg pushtuesve osmanë ishin joshje dhe ëndërr për malësorin triepshian. Dodë Ivanaj bleu tokë. Duke qenë edhe blegtar i mirë arriti shumë shpejt të kishte ekonomi më premtuese. Ndërtoi edhe shtëpi, ndryshe nga ato që kishin në Bekaj.

Pak vite më vonë mori hov edhe ëndrra e tij e vjetër, arsimimi i fëmijëve. Për një jetë më të mirë, u vendos përfundimisht në Podgoricë, ku ndërtoi edhe një tjetër shtëpi banimi edhe më komode. Hapi edhe një dyqan manifakture, kryesisht metrazhe të importuara.

Edhe pse larg vendlindjes ndjehej mirë në gjirin e familjes. Pasi falë Zotit kishte shpëtuar për mrekulli prej hyqymetit turk që e kishte dënuar tri herë me vdekje duke e detyruar të jetonte pothuajse përherë në arrati.

Dodë dhe Zogë Ivanaj lindën gjashtë fëmijë, tre djem Zefin, Martinin dhe Mirashin dhe tri vajza që i dhanënuse në Dreshaj, në Nicaj, në Nikaj.

Mesa duket Pjetër dhe Dodë Ivanaj, ndryshe nga bashkëfshatarët e

[6] *Palok Gj. Berisha "Shkolla dhe arsimi në Malësi të Madhe të aneksuar nga Mali i Zi". Prishtinë, 2000.*

tyre u kujdesën shumë më tepër për arsimimin e fëmijëve të tyre.

Mirash Ivanaj lindi në Podgoricë, më 12 Mars 1891. Ishte djali i tretë i Dodë Ivanajt, që gëzonte dhe pasuronte me dinjitet trevën e konakut të tij.

Mësimet e para Martini dhe Mirash Ivanaj i morën në Podgoricë në shkollën fillore mashkullore në vitin 1879. Mendohet se kanë patur fatin të kenë qenë nxënës të mësuesve të mirënjohur Omer Bebeziq dhe Mustafa Haxhimehmetoviq.

Falë gjendjes së mirë ekonomike dhe më shumë mundësisë dhe predispozitës së prindërve dhe vullnetit të mirë të fondacionit "Sveti Sava" vëllezërit Martin dhe Mirash Ivanaj do të vazhdonin më tej studimet në gjimnazin klasik të Pazharavacit, qytet në juglindje të Beogradit.[7]

Në vitin 1910 Mirash Ivanaj do të mbarojnë studimet në Liceun Modern.

Në vitin 1911 familja e Dodë Ivanajt do të përjetojë me shumë dhimbje humbjen e papritur të djalit të madh Zef Dodë Ivanaj 26 vjeçar. Vdekja tronditi thellë gjithë familjen dhe farefisin e Mirash Ujkës. Ishte vdekje aksidentale që i tronditi thellë të gjithë, e cila pasoi me një krizë ekonomike e shpirtërore.

Në Tetor të vitit 1912 Mirash Ivanaj do të plotësojë studimet në gjimnazit klasik dhe do të regjistrohet në Universitetin e Beogradit, në Fakultetin e Letërsisë duke ndjekur leksionet në kursin e filozofisë.[8]

Gjatë qëndrimit në Pazharovac të Serbisë, Mirash Ivanaj kish lënë gjurmë të thella jo vetëm në trupën mësimore, por edhe në rrethet shoqërore dhe qeveritare, jo vetëm për pamjen e jashtme perfekte, por edhe mendësinë dhe aftësitë e tij të pakufizuara. Prandaj nuk kishte si të mos ishte në mesin e të zgjedhurve për t'u rekrutuar.

Kjo, ndoshta edhe gjendja ekonomike në rënie në familje, bëri që për një periudhë të shkurtër kohe, në kapërcyell të viteve 1911 - 1912, banorët e Podgoricës ta mbajnë mend edhe me uniformën e padëshiruar të oficerit.

Në vitin akademik mësimor 1912 deri në fund të qershorit 1913, Martin dhe Mirash Ivanaj kanë ndjekur rregullisht leksionet në kursin e filozofisë në Universitetin e Beogradit.[9]

---

[7] *Esat Myftari "Profili politik i Esat Mekulit". Saga Prishtinë, 2012, fq 40.*
[8] *AQSH, Dosja Ivanaj.*
[9] *AQSH, f.386, dok., dt. 3.2.1932.*

Ndërprerja e studimeve në Beograd është shumë e qartë. Jo vetëm thjeshtë për pamundësi financiare, por edhe për faktin që nuk ndjeheshin të qetë në një shtet që kishte historikisht synime të këqia për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Pa dyshim nuk mungonin as preferencat e tyre për universitetet e vendeve europiane si Austria, Gjermania dhe Franca.

Me 17 Nëntor 1913 Mirash Ivanaj do të nisë studimet e larta në Universitetin Mbretëror të Romës në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë me bursë të shtetit Italian.[10]

"... Me zgjuarsinë e jashtëzakonshme, tashmë të provuar suksesshëm dhe me ashkun e pashuar rinor për të përthithur dituri, Mirashi nisi studimet në specialitetin e dëshiruar", - shkruan për të studiuesi Iliaz Gogaj.

Lufta e parë botërore dhe ngjarjet që pasuan, ia vështirësuan akoma më shumë jetën Mirash Ivanajt, nga ana ekonomike. Gjatë gjithë vitit 1914 ai s'mundi të marrë asgjë nga familja, e cila ishte në vështirësi. Si të mos mjaftonte kjo, në vitin 1915 i vdes edhe i ati, Dodë Ivanaj dhe më 5 Janar 1916 edhe nëna, Zoga. Jeta studentore e Mirash Ivanajt do të bëhej akoma më e vështirë. Në këto kushte duke mos patur zgjidhje tjetër, Mirash Ivanaj në prill të vitit 1916 i drejtohet komisionit shqiptar të Ministrisë së jashtme me një promemorje për ndihmë modeste për të përballuar nevojat minimale e kryesisht për tekste mësimore e libra plotësues.[11]

Qëndrimi në pritje dhe demoralizimi nuk ishin në natyrën e Ivanajt. Prandaj ai do t'i përvishej punës si pjatalarës në restorantet pafund të Romës. Pas punës së stërmundimshme deri në orët e vona të natës, të nesërmen do të ishte si përherë i vëmendshëm në auditoret e universitetit.

Nuk do të humbë asnjë mundësi për të punuar për hiç gjë si mësues privat në shkolla të ndryshme, si përkthyes dhe daktilograf në studio të avokatëve dhe noterëve, etj. Pa dyshim në këto kohë teje të vështira nuk mungoi edhe ndihma e pakursyer e kushëririt të tyre, Nikollë Ivanaj.

Mirash Ivanaj, edhepse ishte në gjendje jo normale ekonomike, bile të vështirë, nuk e harroi kurrë vendlindjen Shqipërinë. Nuk u bë kurrë pre e politikës italiane. Me mprehtësinë e intuitës së tij dhe me formimin

[10] *Shteti Italian kishte interesa të mëdha ekonomike, politike dhe strategjike për Malin e Zi. Në vitin 1896, kur Elena, vajza e Mbretit të Malit të Zi, u martua me Viktor Emanuelin, marëdhëniet morën përmasa familjare dhe Italia ishte e interesuar të tërhiqte edhe shqiptarë të përzgjedhur nga Mali i Zi.*

[11] *AQSH, f.386, dok. 30, 32.*

e tij të plotë intelektual, me patriotizmin e lindur do t'i kundërvihej në vitin 1917, profesorit të Universitetit të Romës Dr. Oracio Pedrazi, i cili në mënyrë publike fliste për "të drejtat" italiane në Dalmaci dhe pretendimete "ligjshme" të serbëve për dalje në detin Adriatik nëpërmjet Bunës, Shëngjinit dhe Durrësit.

Mirash Ivanaj, ndonëse akoma nxënës, i prekur në ndjenjën e shenjtë të atdhetarizmit, pati guximin të mobilizojë bashkëstudentët shqiptarë, si: Kostandin Kota, Tefik Mborja, Josif Nasi, Izet Spahia, Demir Vila, Qemal Këlcyra, Ymer Berati etj., të protestojnë hapur në mënyrë kolektive kundër profesorit të tyre.

".....Ne studentët shqiptarë në Romë, - shprehës të ndjenjave të mbarë bashkëkombasve tanë, nuk mund të mos protestojmë me shumë indinjatë kundër pikëpamjeve të tilla tendencioze dhe të padrejta që serviren badihava opinionit publik, pa ma të voglin respekt të të drejtave të shenjta të atyre që kanë vuajtur aq shumë dhe po vuajnë, të atyre që i mbështesin shpresat më të mira për një përkrahje të fuqishme për të ardhmen në bujarinë dhe paanësinë e popullit ialian…" - shkruhet në protestën e studentëve shqiptarë që u botua edhe në një nga të përditshmet e Romës.[12]

Mirash Ivanaj si pasardhës i denjë i një familjeje me tradita të lashta patriotike nuk mund të ishte ndryshe, veçse një veprimtar aktiv i çështjes shqiptare. Kështu që protesta nuk ishte diçka e rastësishme, por shqetësim i ndërgjegjshëm i një intelektuali të mirëinformuar me dituri dhe besnik ndaj vendit të të parëve. Kjo vërehet qartë edhe nga letra që Mirash Ivanaj i dërgonte Mit'hat Frashërit në gusht të vitit 1917, ku studenti bënte fjalë për shqetësimet e tij për fatin e Shqipërisë pas luftës së parë botërore.

... "Brezat e Shqypnisë që kanë me ardhë, ma të madhin faj kanë me na gjetë që s'kena muejt me u lirue prej iluzionit që na çon kah e drejta. E ky iluzion që na kena besue me sy mbyllun edhe në ndihmen të huej...[13]

Më 15 Korrik 1921 Mirash Ivanaj, mbas tetë vitesh studime në Universitetin Mbretëror të Romës, do të mbrojë diplomën me temën "Nga historia e gjuhës shqipe në marëdhënie me gjuhët e tjera".

Ishte zgjedhja e të famshmit profesor Chezit, që për kohën ishte më i padiskutueshmi në gjuhët e lindjes.

---

[12] *AQSH, f.386, dok., dt. 29.7.1917.*
[13] *AQSH, f.386, dok., dt. 11.12.1918.*

Punimi u vlersua unanimisht si punë e mirëfilltë shkencore me notën maksimale.

Mirash Ivanaj gjatë gjithë viteve studimore në Universitetin e Romës, njihej jo vetëm për rezultatet e tij të larta në mësime, por edhe për karakterin e tij burrëror dhe të qëndrueshëm, si njeri i heshtur, serioz, social dhe i papërkulshëm ndaj çdo vështirësie. Ishte intelektual me një formim ekselent dhe mendësi të avancuar si në shkencat ekzakte ashtu edhe në ato historike dhe shoqërore. Ishte njohës i shumë gjuhëve të huaja. Të gjitha këto fakte që i kishte të stampuara në natyrën dhe karakterin e tij, bënëqë Mirash Ivanaj, me kohë të tërhiqte vëmendjen e Universitetit dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në fakt e ftuan zyrtarisht që ta kishin në stafet e tyre përkatëse. Por vëllezërit Ivanaj i përkisnin atij soji që e kishin lidhur ngushtë jetën e tyre me fatet e atdheut dhe nuk pranuan. Kjo duket qartë edhe nga korrespondenca e tij me kolegun Z. Demir Vila, i cili kishte mbaruar shkollën një vit më parë dhe që ju gjend afër Ivanajt në ditët e vështira të jetës së tij studentore dhe më pas.

... “ Dëshira e eme ka qenë dhe asht me i shërbye me çfarëdo mënyre atdheut, për të mirën e të cilit nuk paraqes as do të paraqes asnjëherë kondita”...

Kështu shkruan Mirash Ivanaj në letërpërgjigjen e tij të datës 1 Prill 1922 drejtuar Rexhep Mitrovicës që falë ndërhyrjes së Demir Vilës kishte menduar ta emëronte si mësues të gjuhës shqipe në Licen e Korçës me një pagë mujore 320 fr. ari.

Gjatë vitit akademik arsimor 1922 - 1923, Mirash Ivanaj punoi intensivisht për mbrojtjen e tezës së diplomës në Fakultetin Juridik.

Me datën 18 Korrik 1923 ai do të paraqitet para komisionit shtetëror me temën: “Mbi kodin e imperatorit Stefan Dushanit të shekullit XIV”. Punim i tij u konsiderua origjinal, sepse shpjegoheshin shumë qartë jo vetëm kushtet politiko - shoqërore në të cilat u hartua, por edhe marëdhëniet e tij me ligjet para tij, duke e bërë atë objekt shumë interesant për studime më të thelluara në fushën e gjerë të historisë së jurisprudencës.

Gazata italiane “Il nuovo paese”, e datës nëntë shtator, shkruan: “Dr. Mirash Ivanaj, shqiptari që dy vjet më parë është diplomuar në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë të Universitetit Mbretëror të Romës me 18.07. 1923 u dha fund provimeve të degës së drejtësisë të këtij universiteti tue paraqitë si tezë të diplomës Kodin e Imperatorit

Stefan Dushanit.”

Mbrojtja u bë në sallën e madhe të Universitetit ku ndodheshin gati të gjithë profesorët. Në fund kryetari i famshmi profesor Carusi vlerësoi Dr. Mirash Ivanajn me 110 pikë, duke shtuar edhe lavdrimin “Cum Laudeae” dhe urimet e sinqerta për juristin e ri shqiptar.

▪ **Arsim** ▪

Lindita **KAZAZI** dhe Njazi **KAZAZI**

"ABETARET SHQIPE dhe PAVARËSIA KOMBËTARE"

Historia e abetareve të gjuhës shqipe është e vjetër dhe e lavdishme. Me abetaret janë të lidhura përpjekjet e shqiptarëve për mbijetesë përballë pushtimeve të njëpasnjëshme. Me përmbajtjen e tyre ato ndikuan fuqishëm në edukimin e gjeneratave të tëra me ndjenjat më të larta atdhetare dhe fisnike. Ato ndikuan në ruajtjen dhe mbajtjen gjallë të gjuhës së ëmbël shqipe dhe trashëgimin e saj brez pas brezi.

Abetarja, si asnjë libër tjetër në të gjithë rruzullin tokësor, lidhet ngushtë me jetën e çdo fëmije që ulet për herë të parë në bankat e shkollës. Me këtë libër fillon dhënia dhe përvetësimi i një kulturë dhe arsimimi të programuar. Me të mësojnë lexim-shkrimin në gjuhën amtare, por veçanërisht për ne shqiptarët ajo ka pasur funksione shumëplanëshe.

Rilindësit tanë e kanë konsideruar si "*abetare të parë*" veprën e Pjetër Budit, që u botua në Romë, më 1621. Kalendari i Shoqërisë "Dija" në Vjenë, më 1908, fq. 3 shkruan se *"Më 1621, kur doli në dritë libri shqip "Speculum confessionis",e të ndyerit Emz. Budi, u lind edhe i pari abetar shqip".*[1]

Abetaret për nga metoda janë shumë të ndjeshme ndaj çdo hopi pedagogjik, ndaj çdo bumi teknologjik, duke iu përshtatur kurbës së zhvillimit të pandërprerë të diaktikës bashkëkohore. Këtu e gjen

[1] *Shefik Osmani, Njazi Kazazi: "Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike". Botim i MASH dhe shtëpisë botuese "Idromeno", Tiranë, 2000, faqe 49.*

shpjegimin dhe shqetësimi i përfaqësuesve më të shquar të kulturës shqiptare që morën përsipër autorësinë e këtyre teksteve, si: N. Veqilharxhi, K. Kristoforidhi, D. Boriçi, S. Frashëri, A. Kulluroiti, V. Ruso, N. Mjeda, L. Gurakuqi, P. Qiriazi, M. Logoreci, A. Xhuvani, K. Xhumari, R. Hoxha, Xh. Gega, Q. Batalli, M. Gjevori, Gj. Gjokaj, F. Camaj, A. Mustafa, F. Mjaku etj. etj. Por në vitet që po flasim, dolën edhe firma të reja si: Lef Nosi, Jashar Erebara, Nikolla Lako, Kolë Kamsi, Marko la Piana, Thoma Papa Pano, Dhimitër Paparisto, Shefqet Daiu, Simon Shuteriqi, Hafiz Ali Korça etj. Gjatë punës për hartimin e monografisë "Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike", së bashku me Prof. dr. Shefik Osmanin [2], paraqitëm monografinë që u botua nga Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Tiranë, 2000, me 367 faqe, analizuam të gjitha abetaret e gjuhës shqipe gjatë gjithë periudhës deri tani dhe arritëm në përfundimin se:

Në jetën e saj mbi 175-vjeçare, ky tekst mësimor që numëron rreth 225 abetare shqipe dhe ribotime, në të gjitha trojet shqiptare dhe më gjerë, u lidh, si asnjë tjetër, me historinë e arsimit shqiptar, shkollën dhe gjuhën shqipe. Gjeografia e Abetareve shqipe është e gjërë dhe përfshin trojet shqiptare dhe jashtë tyre si në: Bukuresht, Stamboll, Bruksel, Sofje, Vjenë, Napoli, Selanik, Athinë, Paris, Milano, Bari, Ëorçester, Laipcig, Konstancë, Aleksandri të Egjiptit etj.[3]

Për vetë kushtet historiko-shoqërore të Shqipërisë, abetarja kreu funksione të ndryshme, si:

- Mjet pune për mësimin e gjuhës së shkruar shqipe dhe jo vetëm nga fëmijët, por edhe nga të rriturit.
- Për mëkimin e idesë së lirisë kombëtare dhe shoqërore.
- Mjet për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare.
- Hapi rrugën dhe krijoi përvojën në fushën e teksteve tona origjinale shkollore etj.

Për nga koha krijimit të abetareve shqipe *(kujtojmë se Naumi më 1845 botoi "Fare i ri ëvetar shqip...")* ne nuk jami të vonuar me ato të abetareve Ballkanike: të rumunit George Lazar (1820), të bullgarit Petrer Beran (1824), të serbit Vukë Karaxhiç (1827) dhe autorit të

[2] *Prof. dr. Shefik Osmani (1923-2012), pedagog e didakt i njohur, autor (dhe bashkautor) i më shumë se 40 veprave me karakter didaktik (i qindra artikujve) të cilat janë paraqitur në librin "Në gjurmët e një didakti" (Nga veprimtaria dhe trashëgimia e didaktit Sh. Osmani). Botim i Insitutit të Kurrikulkës dhe Stadardeve, Tiranë 2005, fq. 444.*

[3] *Sh. Osmani, Nj. Kazazi: "Abetaret shqipe…". Botim i MASH. Tiranë, 2000, fq. 13.*

abetares greke [4] .

Viti 1912 ishtë *"fatlum"* edhe për botimin e abetareve shqipe. Vetëm këtë vit u botuan 7 abetare shqipe, ndryshe nga vitet tjera që kishte një numër më të vogël, si p.sh.: më 1913: vetëm 2 abetare, 1914- 2 të tilla, 1915 - 3, 1916 - 3, 1917- vetëm 1, 1918- vetëm 1 dhe më 1919 - 3 abetare shqipe.

Vitin e Pavarësisë së Shqipërisë, siç thamë, u botuan, abetaret si më poshtë:

1. Anonim: Abetari i vogël shqyp. "Nikaj". Shkodër, 1912, 32 f.
2. D/iogjen/ H/arito/: Abetari i gjuhës shqipe. Mot i parë. Athinë, 1912. 62 f. me il.
3. D/iogjen/ H/arito/: Shtimi i abetarit shqip për çunat. Athinë, 1912. 56 f. me il.
4. Anonim: (Editor Lef Nosi). Abetare shqipe për djelmoshët gegë. Shtypje e parë. Shtypshkronja Tregtare Nderkomëtare. Manastir, 1912. 16 f.
5. Anonim: Abetare toskërisht. Përshtypjë e gjashtë. Sofje, 1912. 16 f.
6. Anonim /Jashar Erebara/: Abeceja shqype e Kumanoves. Botim i Klubit shqiptar të Kumanovës. Supliment i gazetës "Shkupi". Shkup, 1912.

Por ne do të ndalemi në abetaren shqip-italisht, duke e shikuar në një këndvështirim të ri, jo duke përsëritur ato që kemi thenë në botimin tonë.

7. Anonim: Abetari për fmit qi msojnë shqip-italisht. Për msimoret e Shqipëries. / Il

SILLABARIO për i bambini che studiano Albanse-italiano. Per le scuole d'Albania /. Botues "Antonio Vallardi", Milano, Genova, Roma, Napoli, 1912. 64 faqe me ilustirime dhe një 1 hartë. Teksi u botua në janar të vitit 1912.

Nga përmbajtja e tyre, trajtimi didaktik si dhe teknikat e shtypit, ky tekst ndryshon ndjeshëm në krahasim me ato tekste abetaresh të autoreve shqiptarë. (Kujtojmë se në nëntor të vitit 1913, botohet nga ajo shtëpi botuese edhe teksti "IL COMPLIMENTO dell Sillabario albanese-italano").

Në faqet e para të këtij libri jepen të gjithë tingujt-shkronjat e italishtes dhe shqipes me shembujt përkatës dhe me rregullat e shqiptimit. Këtu shihet dallimi i dy gjuhëve, në alfabetet përkatëse, duke bërë sqarimet e

[4] *Po aty, fq. 54.*

nevojshme për secilin rast.

Abetari... dhe Perkryesimi i abetarit... botuar nga shtëpia botuese " Vallardi gjatë viteve 1912, 1913.

Mësimet fillojnë me tingullin "i" dhe "u", pastaj vijojnë me tingujt e tjerë. Në fq. 9 vijon puna me rrokjet, siç thotë edhe titulli "Sillabario...", nga italishtja "sillaba", rrokje. *(Këtë e gjejmë në një tekst tjetër, të viteve të fundit, "Dizionario di Didattica" i Leonardo Trisciuzzi, (Trishuci) Edizioni ETS, 2011, fq. 439),* ku thotë se *"...silabari-rrokjësori (sillabario), është teksti shkollor, që shërbente për mësimin e leximit me rrokje, apo thënë ndryshe metoda e rrokjeve"*. (Po aty, fq. 378).

Si metodë për paraqitjen e tingullit të ri është përdorur ajo sintetike (saktësisht kombinimi i metodës së tingujve dhe i metodës rrokjesore, që zë vendin kryesor, ashtu siç vetë teksti italisht "Il sillabario...", pra veprohet me këtë rrugë medodike: jepet tingulli i ri, bashkohet ai me të gjitha zanoret, duke ndërtuar rrokjet e hapura e të mbyllura, të mundshe si: va, vu, vo, ve, vi dhe av, uv etj. Dhe pjesën në gjuhën shqipe: ka, ku, ky, ko, ke, kë, dhe ak...etj. *(Shih fotokopjet për librat në fjalë të bëra për rrokjet: va... dhe ku...)*

Në vitet që u botuan këto tekste, në Shqipëri ishin hapur disa shkolla nga Italia, si në Veri dhe në Jug. Këto tekste u hapën pikërisht për këto shkolla ashtu siç kuptohen nga titulli ato janë botuar *"...për fmit qi mësojnë shqip-italisht"*.

Ndryshe nga shumë abetare të tjera, që e fillojnë procesin e të mësuarit të gjuhës së shkruar nga leximi, në këtë tekst fillohen nga

shkrimi. Kështu secila shkronjë e re vihet në fillim të faqes, paraqiten elementet e saj që janë viza të pjerrëta, të përkulura, ovale etj. të cilat duke u bashkuar formojnë shkronjën e re të dorës. Si model përdoret shkrimi i pjerrët.

Të dy tekstet kanë një vëllim prej 120 faqesh, shtypur sipas sipas modelit të teksteve italiane, Nga përmbajtja e tyre, trajtimi didaktik si dhe teknika e shtypit, tekstet ndryshojnë ndjeshëm në krahasim me ato të autorëve bashkëkohës shqiptarë të botuara në Shqipëri dhe jashtë saj, me ilustrime shumë të bukura, bardh e zi.

Nga pikëpamja e vendit që zënë dy gjuhët "Abetari..." ndahet në dy pjesë: pjesa e parë prej 48 faqesh, ku mbizotëron gjuha italiane, ka vetëm pak fjalë dhe shpjegime shqip, kryesisht vetëm për tinguj-shkronja që ndryshojnë me italishten.

Ndërtimi i frazës shqip nuk është i pastër. Përdorimi i disa fjalëve herë gegërisht e herë toskërisht brenda një teksti. Ose fjalën Shqipëri e gjejmë në forma të ndryshme, si: *Shqypri, Shqypni e Shqypënia, ("Abetari…" fq. 63 dhe "Përkrysimi …" fq.37*) nuk ia ulin vlerat teksteve.

Pavarësisht nga këto që thamë, kemi mendimin se këto tekste janë një kontribut për gjuhën shqipe dhe aq më tepër nga një shtëpi botuese prestigjoze, dhe kanë ndihmuar nxënësit shqiptarë të kohës për mësimin e gjuhës amtare.

▪ **Histori** ▪

Nexhmi **BUSHATI**

100-VJETORI I KUVENDIT TË BUSHATIT

(korrik 1919 – korrik 2019)

Në Seminarin II Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", (*Shkodër, 1998, seksioni i historisë)*, nga studiuesi Nuh Topçia është mbajtur kumtesa:"Kuvendi i Bushatit (2 korrik 1919)". Kumtesa e shkurtë mbështetet tërësisht në botimin *"Shqipnia para Konferencës së Paqës*", *bleni i dytë* i Shtypëshkrojës Françeskane, Shkodër 1921.

Ajo hapet me këtë informacion:"*Më 2 korrik 1919, fshati Bushat i Shkodrës u bë qendra e një kuvendi të madh mbarëkombëtar*", e më tej vijon me një stil shumë konçiz duke renditur, në pak radhë, shkaqet që përcaktuan shqetësimin e jashtëzakonshëm të popullatës shqiptare për rrezikun që u kanosej trojeve amtare nga synimet shoviniste serbo-kroato-sllovene (jugosllave), posaçërisht Shqipërisë Veriore me Shkodrën në qendër.

Për të qenë më bindës, autori ndalet tek emrat e firmatarëve të Memorandumit përkatës , nënshkruar në fshatin Bushat më 2 korrik 1919, dhe dorëzuar më 8 nëntor 1919, Konferencës së Paqës që zhvillohej në Paris, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore[1]

Me kaq, të dhënat konkrete mbyllen dhe vazhdohet me disa konkluzione të përmbledhura të autorit për përmbajtjen e Memorandumit të mësipërm, duke i shoqëruar me citate të shkurtëra. Bëhet fjalë për pretendimet e paligjshme të qeverive fqinje; për vendosmërinë e

[1] *N.Topçia: "Kuvendi i Bushatit (2 korrik 1919)" në Seminarin II Ndërkomb. "Shkodra në shekuj",viti I, Shkodër, 1998,fq.183*

qytetarëve dhe fshatarësisë së Shkodrës me rrethina në mbrojtjen e trojeve stërgjyshore nga lakmitë shoviniste, si dhe për mbështetjen në parimet e Deklaratës së Presidentit amerikan Uillson "Mbi të Drejtat e Vendeve të Vogla", duke u mbyllur me betimin mbarëkombëtar për t'i mbrojtur me gjak trevat e kërcënuara. Autori shpreh bindjen se kërkesat e Kuvendit të Bushatit qenë patjetër një kontribut shumë i çmuar në mbarë lëvizjen popullore të viteve 1918 -1920, për të mbyllur "Çështjen e Shkodrës".

Me sa konstatojmë ne, deri më sot, rezulton se autori N.Topçia mbetet i vetmi studiues, që siç u nënvizua, e ndërtoi kumtesën duke u mbështetur tërësisht në botimin e vitit 1921 "Shqipnia para...", si një përpjekje dashamirëse për të vënë një gur në "*tempullin*" e historisë kombëtare. Krahas këtij fakti, në një aspekt tjetër, është shumë domethënës, pse jo edhe i çuditshëm fakti që libri i cituar nga autori, i përbërë nga një seri dokumentash autentikë, një pasqyrim "par exellence" i ndërgjegjësimit atdhetar në ato vite aq problematike për vendin tonë, nuk ka tërhequr deri në vitin 1998, vëmendjen minimale të asnjërit prej historiografëve që kanë trajtuar ngjarjet e viteve 1918-1920.

Vetëm disa autorë që kanë trajtuar probleme historike, lidhur me zonën e Bushatit, si: Repishti[2], Bushati [3], Muhaj[4],Shima [5], Dibra [6] e kanë pasqyruar dhe në studimet e tyre.

Duke e pranuar të mirëseardhur emërtimin "Kuvendi i Bushatit", le të ndalemi te problemi emblematik i organizimit të tij. Kemi të bëjmë me një kuvend të tipit të traditës, qindra burra *"ulur shesh"*, apo me një takim të kufizuar përfaqësuesish, delegatë të mandatuar, që kanë sjellë emra dhe firma; le t'ia lëmë hamendësimit ?! Kryesore është fryma e një manifestimi të fuqishëm të ndërgjegjes kombëtare për të ndaluar copëtimin e mëtejshëm të shtetit shqiptar dhe ndarjen e Shkodrës nga pjesa tjetër e krejt shtetit.

Kuvendi me keqardhje konstatojmë se disa nga historiografët e ballafaquar, në vështrimin tonë, nuk rezultojnë të vëmendshëm, edhe kur shkrimet e tyre nuk u përkasin viteve të çensurës apo të autoçensurës, kur duheshin shmangur emra e shkrime klerikësh?! Kemi në radhë

---

[2] *Xh.Repishti:" Lufta për mbrojtjen e Shkodrës në vitet 1918 -1920",Shkodër 1998 fq.160-163*

[3] *H.Bushati-N.Bushati:"Bushatllinjtë"(Suplementi'),Shkodër,2003,fq.270-356*

[4] *A.Muhaj: "Vendi që zënë Bushatllinjtë..."Seminari III Ndërkomb."Shkodra në shekuj",nëntor 1998*

[5] *K.Shima:"Historiku i arsimit në z.e Bushatit", Shkodër,viti 2012, fq.30*

[6] *Z.Dibra: "Fjalori enciklopedik i hapës.shkodrane",Lezhë, viti 2015,fq.77-112*

të parë një botim akademik[7] ku, në pak rreshta flitet për bashkimin e Shkodrës me qeverinë e Tiranës me 11 mars 1920; fillimisht, aksioni i forcave qeveritare, të prira nga dy ministrat e Tiranës, A.Zogu dhe H.Kadria dhe të mbështetura nga atdhetarët shkodranë me rrethina, ndjek më pas 12 marsi që shënon largimin e forcave franceze, ndërsa 13 marsi, saktësohet si zyrtarizimin e bashkimit. Kështu, pra, asnjë fjalë për rolin e fshatit Bushat[8], qendër nevralgjike për të koordinuar aksionet qeveritare të rastit, e po kështu për Kuvendin në fjalë, i cili fokusoi atë bashkim.

Po i njajti qëndrim mospërfillës konstatohet dhe tek tre historianë e shquar: M.Çami[9], P.Milo[10], P.Dibra[11], ndonëse materiali historik i trajtuar prej tyre është i pajisur dhe me një aparat shkencor të gjërë!

Duke u rikthyer tek treshja e studiuesve Repishti, Bushati e Shima, vërejmë një përkushtim dashamirës të tyre në drejtim të zgjerimit të informacionit me anë të pasurimit të të dhënave me interes, veçanërisht për sa i përket mjedisit[12]ku u zhvilluan kontaktet e ministrave të Tiranës

---

[7] *Akademia e Shkencave e Shqipërisë:"Historia e popullit shqëptar",vëll.III, T. 2007,FQ.148-149*

[8] *Turisti osman E.Çelebi e ka përshkruar Bushatin në vitn 1640 si një qytezë e zhvilluar,me shumë shtëpi. Buzë lumit Drin, rrethuar me kopshtije të bukur, e kishte rezidencën verore sundimtari i Shkodrës .. Sipas studiuesit H.Bushati, ky fshat ka qenë qendra e Prefekturës së Shkodrës me shumë zyra, sepse në atë kohë qyteti ishte i pushtuem nga ushtria franceze."*

[9] *M.Çami:"Lufta çlirimtare antiimperialiste e popullit shqiptar 19i8-1920",Tiranë ,1969,fq.161*

[10] *P.Milo:"Shqipëria e Jugosllavia 1918-1927",Tiranë,1992, fq.71-78*

[11] *Z. Dibra:"Fjalori enciklopedik i hapësirës shkodrane" Lezhë, 2015,fq.771*

[12] *Sipas studiuesve Xh.Repishti, K.Ulqini, N.Bushati, ,K.Shima: dy ministrat e qeverisë, A.Zogu e H.Kadria, tëu vendosën në Bushat pasi në Lezhë nuk kishte stabilitet. U stabilizuan në shtëpinë ma të mirë të fshatit, në " Kullën e Hasan Begut, për të cilën do të informonin qeverinë se diskutimet me komisionin e Shkodrës e me përfaqësuesit e klerit i kishin zhvilluar "...në shtëpinë që gjindej nën rrapat e mëdhenj që i kanë ba hije familjes së vezirit". Me këtë elozh ata donin të shprehnin mirënjohjen për pronarin e shtëpisë ,i cili ishte trashëgimtar i trojeve të stërgjyshërve sundimtarë,. Ata çinarë të mëdhenj, tri pemë gjigande kishin jë histori të veten: në vitet 1912-13 ,ushtarët serbë, pasi dogjën kullën e begut si raprezalje, deshen të prisnin edhe çinarët legjendarë, por u penguan nga oficerët e tyre, sepse, sipas një kënge të vjetër serbe, nën hijen atyre pemëve legjendare, kishte kaluar orët e zhegut Helena e Car Dushanit. Ironi e fatit, atë që s'banë serbët, do ta realizonin militantët e partisë, andej nga vitet '60! Nuk vonoi dhe këtë fund të dhimbshëm do pësonte dhe krejt "kulla". Ajo s'meritonte të shpallej monument kulture!*
shtëpinë që gjindej nën rrapat e mëdhenj që i kanë ba hije familjes së vezirit".

me Komisionin e Shkodrës dhe përfaqësuesit e klerit për të përcaktuar modalitet e aksionit për bashkimin e Shkodrës, ashtu siç ishte projektuar në Kuvendin homonim që në korrikun e 1919-ës.

Në mbyllje të këtyre shënimeve i shpreh mirënjohje redaksisë që e vlerësoi si duhet përpjekjen time për të përkujtuar datën e një ngjarjeje 100-vjeçare, në dukje "minore", por që luajti një rol me rëndësi për ta shpëtuar Shkodrën me rrethina nga "goja e ujqërve të unshëm".

Sereta **KOPERAJ**

DITËT E FUNDIT TË MBRETËRISË SHQIPTARE, PARA PUSHTIMIT ITALIAN (1939), NË DOKUMENTET BRITANIKE

Pushtimi i Shqipërisë nga Italia ngjante si një ngjarje e paralajmëruar më parë, por pak kush donte t'ia dinte që një vend i Lidhjes së Kombeve do të pësonte një pushtim klasik nga një shtet tjetër, me të cilin nuk ndante pretendime territoriale, apo popullate. Në fillimin e vitit 1939, pushtimi Italian i Shqipërisë kishte filluar të përgatitej, por pritej të zgjidhej mënyra e ndërhyrjes[1]. Konti Ciano, që ishte ideatori i aneksimit të Shqipërisë, luftonte me mëdyshjen e Musolinit, i cili nuk donte një ndërhyrje të drejtëpërdrejtë ushtarake dhe pa një shkak të forte nga pala shqiptare[2]. Situata e turbullt ndërkombëtare favorizonte italianët, pasi pushtimi i një shteti të vogël në brigjet lindore të Adriatikut nuk do të kishte aq reagime, në një kohë kur "të fortit" druheshin dhe ndjenin që lufta botërore ishte në prag. Shtetet fqinje, edhe pse ndiheshin të rrezikuara nga një pushtim i mundshëm i Shqipërisë nga Italia, nuk reagonin, madje, e deklaronin atë si një problem periferik[3].

Planin për aneksimin e Shqipërisë, Konti Ciano ia kishte bërë të ditur edhe jugosllavëve, të cilët shfaqin në këtë periudhë reagime të ndryshme. Në fillim me Stojadinoviçin, që ishte dakord me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, por donte marrjen e disa territoreve shqiptare nga Jugosllavia, një kërkesë më e madhe kjo sesa nga oferta e Çianos për një

[1] *V. Duka, " Histori e Shqipërisë 1912-2000", SHBLU Tiranë, 2007, fq.205-206*

[2] *Fr. Jakomoni, "Politika e Italisë në Shqipëri", Tiranë 2005, fq.83-84. Vetë tek Ditari i tij, Ciano shprehet që "depërtimi ynë në këtë vend po bëhet më intensiv, programi që kam përpunuar po zbatohet pa pengesë", shih në Diario 1937-1943, Torino 1998, fq.231,*

[3] *Shih dhe Fischer J.B. "Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945", Tiranë, 2004, fq.34-35, si dhe A. Puto Shqipëria politike 1912-1939, Tiranë. 2009, fq.614-615.*

rrumbullakosje kufijsh, dhe më pas me Markoviçin (pas dorëheqjes së Stojadinoviçit), kur Jugosllavisë "i mjaftonin dhe i tepronin" shqiptarët e Kosovës, por që çështja shqiptare nuk mund të krijonte problem në marrëdhëniet italo-jugosllave. Sipas F.Jakomonit,ministri jugosllav i punëve të jashtme, Markoviç, i kishte thënë se, sipas mendimit të tij, gjendja e krijuar në marrëdhëniet italo-shqiptare, ishte një manovrim i një stili të madh, me të cilin Mbreti Zog prirej që të turbullonte ujërat e përzemërsisë së marrëdhënieve italo-jugosllave në Londër, në Paris, në Beograd etj. Kishte shtuar se Mbreti Zog nuk ishte i atij niveli sa të mund të prishte marrëdhëniet miqësore që ishin vendosur ndërmjet dy vendeve.

Nga biseda me ministrin e jashtëm jugosllav dilte e qartë se rrethanat kërkonin një tutelë të njëmendtë të interesave tona dhe jetës së italianëve në Shqipëri[4]. Kërcënimi italian ndihej gjithnjë e më shumë. Në dokumentet britanike del qartë se shteti shqiptar përpiqej ta menaxhonte situatën, të mos i jepte një shkak acarimi marrëdhënieve me Italinë, por edhe të ruante integritetin dhe pavarësinë e tij.

Në fund të muajit shkurt të vitit 1939 ministrit anglez në Durrës, A.Ryan, iu kërkua nga Foreign Office një raport i zgjeruar për situatën në Shqipëri në lidhje me rrezikun e një ndërhyrjeje ushtarake nga ana e Italisë, sepse megjithë interesat për marrëdhënie më të mira me Italinë, qeveria britanike ishte e interesuar edhe për pavarësinë dhe integritetin e shtetit shqiptar.

Në raportin e tij, Rayan e sheh fillimin e situates konfliktuale mes italianëve dhe Mbretit Zog që dy vite më parë. Në në një sërë raportesh bëhet vlerësimi nga burime të ndryshme duke dhënë një tablo më reale të asaj situate të turbullt në Shqipëri, ku Zogu nuk ka probleme vetëm me situatën e jashtme, por edhe atë të brendshme.

Sipas Rayan-it, pakënaqësia e Italisë ndaj mbretit Zog kishte filluar të rritej që nga festimet për përvjetorin e pavarësisë në nëntor të 1937. Pavarësisht nga entuziazmi i shfaqur në aparencë, qeveria italiane nuk aprovonte shpenzimin tejmase të bërë për festimet, e sidomos në demonstrimin ushtarak ky tensionim që vazhdoi të ishte i pranishëm në të gjithë këtë periudhë, ishte rritur ndjeshëm muajt e parë të vitit 1939. Madje, Rayan del në përfundimin, se loja e dyanshme me italianët i kishte prishur punë edhe me opinionin e brendshëm në Shqipëri. "Këndvështrimi i italianëve për mbretin Zog mund të përmbidhet në

[4] *Fr. Jakomoni, "Politika e Italisë në Shqipëri", Tiranë 2005, fq. 146*

një fjali të vetme, të përmendur edhe në telegramin e dërguar në Romë, nr.136 të 26 shkurtit që për ata, Zogu është shumë shpenzues dhe shumë kërkues. Ajo çfarë e bën tragji-komike situatën e tij është se, nëse nga pjesa më e madhe e shqiptarëve akuzohet se i ka shitur vendin e tij Italisë, ai i ka dëshpëruar italianët duke i rezistuar kërkesave të tyre në shumë drejtime. Ai gjithnjë ka refuzuar çdo gjë që mund të shpinte në një kolonizim në shkallë të gjerë[5]. Së fundi, theksi vihet edhe tek metodat e administrimit të financave të qeverisë shqiptare, të cilat kishin krijuar hije dyshimi në Romë dhe ishte e sigurtë, që hedhja poshtë e skemës së tyre për organizimin e rinisë fashiste ishte një zhgënjim i madh për qeverinë italiane. Madje, edhe në fushën ekonomike, Mbreti nuk shkoi aq larg, apo aq shpejt sa italianët do të kishin dëshiruar, për të plotësuar kërkesat e tyre ekonomike. Në një mori telegramesh, të muajve shkurt dhe mars, në dokumentet e Foreign Office, del që mosmarrëveshjet filluan të nxirrnin krye pas procedimit të G.Giros, një italian i adhur për të bërë organizimin e rinisë shqiptare, sipas modelit fashist italian (faktet do të dëshmonin më vonë se ishte një prej protagonistëve në planet e Cianos, për aneksimin e Shqipërisë). G.Giro, i cili pati shumë konflikte me autoritetet shqiptare, kryesisht me ministrin e brendshëm shqiptar, M.Jukën, në muajt e fundit të 1938[6] dhe sidomos në muajt

[5] *F.O.371.23711 R.16 97/ 725/ 90 From A.Ryan to Lord Halifax, 4 mars 1939, Durrës.*

[6] *Aktiviteti i Giovani Giro-s kundër Zogut del edhe tek edhe tek dokumentet e F.O.371.23710 R1640,dt23 janar 1939, F.O.371.23710 R 1645/41,6 shkurt 1939; F.O.371.23710 R. 1273/41, 22 shkurt 1939 nga A.Ryan për Lordin Halifax, porgjithashtu shih dhe B. J. Fischer "Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945", Tiranë 2004, fq.39. G.Giro jepet si protagonist i përgatitjes së një skeme për rrëzimin e Zogut edhe tek "Historia e Shqipnis" e Tajar Zavalanit, sipas të cilit "Komendatore Giro, nji gangster i fashizmit, u dërguenë Shqipni për të pregatitë sheshin politik. Në raportet q'i dërgoi Çianos, ai u mburr se kishte ndën kontroll elemente të randësishëm të popullit shqiptar, të cilët po ktheheshin "kundër Mbretit dhe hajdutve qi e rrethonin". Qëllimi i Çianos dhe i agjentit të tij Giro, ishte me provokue trazime në Shqipni për të paralizue çdo rezistencë kundër agresionit fashist. "Mbretit Zog, shkruen Çiano, - do t'i japim nji jot (anije luksi private) me nji ekipazh italian, në mënyrëm qi të mos ket se si me u arratisë." Parashikimet e Çianos, i cili ishte fare i sigurtë përsa i përket suksesit të "grushtit", shkonin aq larg sa me llogaritë fitimet ekonomike qi kishte me prue zaptimi i Shqipnis. Nji grup ekspertësh qi kishte ba studime në vënd i kishte raportue se zbatimi i nji programi të gjanë kanalizimi dhe irigacioni të tokave bujqësore do të shtonte prodhimin* ***e*** *drithit për bukë me 200.000 ton në vit, dhe kjo sasi do të shërbente për ushqimin e Italjanve.. Nji pikë tjetër e komplotit sajue me kaq kujdes nga klika e Çianos ishte se, ditën qi të debarkonte ushtërija italiane në brigjet e Shqipnis, Mbreti Zog do të vritej nga bandat besnike t'Italis qi do të zbrisnin në Tiranës prej maleve të veriut. Në gjyqin qi u ba në Romë mbas lufte, Jakomoni mohoi*

shkurt, mars të 1939, u akuzua se kishte qenë i angazhuar në një lidhje kompromentuese me armiqtë e Mbretit Zog jashtë Shqipërisë[7], dhe se kishte bërë përpjekje të korruptonte kryetarë fisesh të mëdha në Shqipëri që t'i kundërviheshin Mbretit. Sipas raporteve të përmendura, megjithëse nuk kishte prova zyrtare për këto akuza, ministri britanik në Shqipëri, A.Ryan njoftonte për korrespondencën kompromentuese që Giro kishte pasur me emra të njohur të malësive të veriut, kryesisht kryetarë fisesh, të cilët nuk kishin ndonjë simpati për Zogun, sidomos pas mbledhjes së bërë prej tij të armëve në këto zona. Bajraktarit të Mirditës, Gjon Marka Gjoni, thuhej se i ishte ofruar një shumë që do ta bënte pronar të një shtëpie të Mirditajve në Shkodër. Murat Kaloshit, besohej se i ishte ofruar një shumë e madhe nga Giro, dhe më pas, vetë Kaloshi kishte lajmëruar Mbretin[8], por, duke cituar Rayan-in, ai nuk kishte lajmëruar aq shpejt sa disa të tjerë, prandaj ishte ende i dyshuar. Në këto dokumente përmendet edhe Ceno Elezi, si një prej atyre që kishte pranuar paranë e italianëve. Mbreti Zog kishte filluar të ndihej i kërcënuar, prandaj në fillim të muajit shkurt bëri një mobilizim të pjesshëm, sidomos të atyre forcave, të cilët i kishte në një varësi implicite, si kryetarët e fiseve të Matit, vendit të origjinës së Mbretit, që ai i përdorte si një element të ndërmjetëm mes sistemit ushtarak të rregullt. Si pasojë e këtyre ngjarjeve, Zogu bëri disa lëvizje për të treguar se ai vazhdonte të kishte autoritetin e duhur për të kontrolluar situatën në vend, edhe në rastet kur ata që ndëshkoheshin ishin pro-italianë. Kështu, të paktën një qeveritar u pushua nga puna, pati emërime të reja dhe rishpërndarje të oficerëve të ushtrisë dhe xhandarmërisë. U vendos që Giro të linte Shqipërinë. Pati shumë persona që u morën në pyetje dhe katër u arrestuan. Të pyeturit nuk dhanë ndonjë material për të vazhduar procedimin ndaj personave të arrestuar, të cilët u liruan pas katër-pesë

se ishin ba plane për të vra mbretin Zog. Sidoqoftë për të plotësue legjendën se e gjith kjo punë do të kryhej me pëlqimin e viktimave të agresionit fashist, Çiano kishte caktue qi nji grup Shqiptarësh "të besueshëm" të shkonte në Romë për me i ofrue kunorën e Shqipnis Viktor Emanuelit të III." T. Zavalani," Historia e Shqipnis",Tiranë 1998, fq. 310gjith kjo punë do të kryhej me pëlqimin e viktimave të agresionit fashist, Çiano kishte caktue qi nji grup Shqiptarësh "të besueshëm" të shkonte në Romë për me i ofrue kunorën e Shqipnis Viktor Emanuelit të III." T. Zavalani," Historia e Shqipnis",Tiranë 1998, fq. 310

[7] *Bëhet fjalë për emigrantët shqiptarë jashtë shqipërisë, sidomos, për emigrantët antizogistë të Parisit.*

[8] *Shih dhe B.J.Ficher "Shqipëria gjatë luftës 1939-1945". Tiranë. 2004. fq.37*

ditësh[9]. Më 20 shkurt në një takim me kryeministrin shqiptar, diplomati britanik u interesua për mobilizimin që po bëhej, dhe megjithëse merr një përgjigje rutinë, ai raporton se thirrja e rezervistëve nuk ishte diçka normale, sepse nëse do të kishte qenë e tillë do të bëhej në fund të vitit dhe jo në mes të shkurtit[10].

Në raportet e Foreign Office përmendet edhe rasti i Jak Koçit, një deputet që thuhet se ka qenë agjenti i Giro-s, për shpërndarjen e parave, por edhe pjesëmarrës në një tentativë për helmimin e Zogut[11]. Tashmë ajo çfarë dyshohej në muajt e parë të vitit 1939, tani për Foreign Office përforcohet: italianët duan përmbysjen e Zogut, si një shkak për të ndërhyrë edhe ushtarakisht në Shqipëri.

Ekzistenca e një komploti ndaj Zogut, tani perceptohej nga i tërë opinioni i brendshëm. Vetë ministri shqiptar i punëve të jashtme, M.Libohova, I njohur si një pro-italian, i deklaroi ministrit britanik në Shqipëri, A.Ryan, në një takim që pati me të me datën 19 shkurt pas ardhjes nga Italia, se "këtu ka pasur një komplot. Ai nuk prodhoi pasoja të tilla që qeveria të merrte masa më drastike sesa ato që bëri. Për asnjë çast nuk patëm frikë për një agresion të jashtëm "nga ofendimi", siç kishin menduar disa. Nëse do t'i ishim frikësuar kësaj, do të kishim vepruar ndryshe. Fakti është që z. Giro u bë në këtë rast qendra e një "blloku" të elementëve të pakënaqur. Qeveria mori masa paraprake dhe e ka situatën nën kontroll.- janë thëniet e Libohovës. Nga kjo shihet se edhe qeveritarët e Zogut, ose prej një miopie politike, nuk e ndjejnë ngushtimin e rrethit që Italia po i bën Shqipërisë, duke përgatitur një protektorat të plotë përmes pushtimit, ose janë ndjerë të paaftë për të qenë aktorë të kësaj situate. Kjo shihet edhe tek ministri Libohova që e vlerësonte z. Giro si një njeri me reputacion, por edhe pamëdyshje i paditur mbi realitetin shqiptar. Siç duket duke qenë i mirëpritur nga Mbreti sa herë që mbante qëndrim oponent, ia lejoi vetes të futej në drejtime të rrezikshme[12].

[9] *F.O.371.23711 R.16 97/ 725/ 90 From A.Ryan to Lord Halifax, 6 mars 1939, Durrës.*

[10] *F.O.371.23711 R.16 97/ 725/ 90 From A.Ryan to Lord Halifax, 6 mars 1939, Durrës ; F.O.371.23711 R.16 97/ 725/ 90 From A.Ryan to Lord Halifax, 4 mars 1939, Durrës.*

[11] *Koçi ishte një afarist pa ndonjë reputacion të dukshëm. Duke qenë se ai u mor shumë me përgatitjet e ceremonisë së dasmës mbretërore më 1938, ai qe i preferuari i Oborrit mbretëror, por pas tentativës për helmimin e Zogut, pasi e demaskoi, Mbreti e la të ikte. Disa burime,disi në mënyrë romantike theksojnë, se Zogu bëri kështu nga ndërhyrja e Mbretëreshës Geraldinë.*

[12] *PRO F.O.371.23711 R.16 97/ 725/ 90 From A.Ryan to Lord Halifax, 4 mars 1939, Durrës.*

Duket se vetëm Zogu dhe rrethi i tij shumë I ngushtë ishte i alarmuar për situatën që po afrohej.

Ai ishte informuar dhe kishte mjaft dijeni për marrëveshjen e fshehtë mes Jugosllavisë dhe Italisë

(takimi Çiano-Stojadinoviç). Prej informacionit që nxjerr nga M.Libohova, Ryan raportonte: Ai (Zogushënim imi S.K.) mendon se diçka jo e mirë për të dhe vendin e tij është planifikuar, por mohohet mundësia që Mbreti të ketë kërkuar azil për familjen mbretërore në Jugosllavi në rast nevoje. Por tani, Zogu ka filluar të lëkundet mbi një ndihmë të mundshme nga ana e Jugosllavëve, në rast të një sulmi të mundshëm nga pala italiane[13]. Komplotet, të organizuar vërtetë, apo të amplifikuar, ishin sinjali i parë i dukshëm i frikës nga një pushtim i huaj. Kjo frikë ka qenë në qendër të shumë raportimeve dhe informacioneve që vinin nga Shqipëria, aq sa ishte e pamundur që të mos shkaktonte preokupim në qarqet diplomatike angleze. Vetë Foreign Office e kishte të vështirë të gjykonte mbi efektin e tërë këtyre ngjarjeve mbi marrëdhëniet shqiptaro-italiane, që rrodhën me shpejtësi Brenda dy muajve. Në dy muajt e parë të vitit 1939, dukej se italianët ishin të shqetësuar nëse Mbreti Zog do të përqendrohej tek marrëveshjet me ata, vetëm në aspektin financiar të tyre. Por situata nuk po shkonte drejt një mirëkuptimi për realizimin e marrëveshjes dhe dukej se Zogu po i bënte rezistencë kërkesave të qeverisë së Musolinit. Çështja Giro, ndoshta, vetëm kishte precipituar pak a shumë në mënyrë aksidentale një situatë të acaruar që më përpara. Nga ana tjetër, Foreign Office nuk mund të mos mendonte që qeveria italiane të ishte dorë jashtë në përpjekjet për trazira në Shqipëri, në mënyrë që të rrëzohej Mbreti Zog dhe të justifikonte një ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake[14].

Një rrjedhë e tillë ngjarjesh, tërë zigzake, vinte edhe si rezultat i strategjisë së ndërlikuar dhe të pasaktësuar që kishte bërë "arkitekti" i pushtimit italian të Shqipërisë, Kontit Ciano[15]. Kjo strategji mori hov, ndoshta edhe prej vizitës së kryeministrit britanik, Nevil Chamberlain, dhe ministrit të jashtëm, Lordit Halifax, në Romë, ku qëndrimi britanik u tregua shumë i zbutur ndaj veprimeve të Fuqive të Boshtit, si dhe pranimit të prioriteteve të interesave italiane në Adriatikun perëndimor[16].

[13] *PRO F.O.371.23711 R.26 97/ 725/ 90 FO minutes A.Noble 28 mars1939*

[14] *Po aty.*

[15] *Fr. Jakomoni, "Politika e Italisë në Shqipëri", Tiranë 2005, fq. 81, shih edhe B.J.Ficher "Shqipëria gjatë luftës 1939-1945". Tiranë. 2004.fq.42-43*

[16] *Shih K.G.Ciano, Diario 1937-1943, Torino 1998, fq.211, dt.11 janar 1939.*

Në këtë periudhë të viteve 1937-1939, Chamberlain dhe Halifax-i do të ishin protagonistët më të zellshëm të politikës së paqësimit përballë vendeve të Boshtit. Madje më 1937, viti pas rimilitarizimit të landit të Rinit nga Gjermania, Halifax-i u bë simboli i tërheqjes morale të demokracive, duke vizituar selinë e Hitlerit në Berhtesgaden. Ai ngriti lart Gjermaninë naziste si "mburojë e Evropës kundër bolshevizmit"[17]. Madje shprehja e tij për ndryshimin e kufijve lindorë të Gjermanisë, se "Anglia ishte e interesuar të shihte që çdo ndryshim të bëhej nëpërmjet evolucionit paqësor dhe të evitoheshin metodat që mund të shkaktonin shqetësimet serioze"37[18] tregonte më së miri qëndrimin e diplomacisë britanike, për të cilën parimet demokratike me të cilat kishin ngritur Lidhjen e Kombeve, kishin kaluar në plan të dytë.

Më 9 mars 1939, Mbreti Zog i kërkoi një takim ministrit britanik në Shqipëri, A. Ryan, ku mendonte t'ia bënte prezent shqetësimin e tij ndaj rrezikut italian. Nga ana tjetër, Zogu, siç duket dëshironte edhe të maste pulsin e Anglisë, si do të reagonte ajo ndaj një pushtimi të mundshëm të Shqipërisë nga Italia.

Në fakt, qëndrimi britanik i ishte bërë i qartë Zogut edhe më parë, që në fillim të vitit, më 23 janar, kur një i besuar i Zogut kishte kontaktuar me A.Ryan, për ta informuar se Italia po përgatitej ta përmbyste Mbretin Zog. Këtë do ta arrinte përmes një komploti të organizuar nga G.Giro me Mustafa Krujën dhe disa emigrantë shqiptarë në Paris, për të rrëzuar Mbretin Zog, si dhe për ta zëvendësuar mbretërinë me një regjim më pranë ideve italiane. Italianët, madje duhej të kishin pasur në mendje një regjim me një princ nga oborri i Savojës në krye, ose një lloj bashkimi mes Shqipërisë dhe Italisë, gjë që do ta bënin në javën e parë të pushtimit (më 13 prill1939). Rayan shprehej për personin e kontaktit se ai nuk minimizonte kapjen që Italia i kishte bërë Shqipërisë, por ai ishte i bindur se z. Giro dhe M.Kruja ishin duke punuar së bashku kundër Mbretit Zog për interes të italianëve. Përsa u përket emigrantëve në Paris, shumica e të cilëve supozohej se ishin kundërshtarë të politikave të Italisë, ai vinte në dukje se ata mund të përdornin çdo mjet për t'u çliruar nga Mbreti Zog dhe shoqëria shqiptare mund të emancipohej nga ndikimi italian[19].

[17] *H. Kissinger "Diplomacia", Tiranë 1999, fq.307.*

[18] *Memorandum i FO, cituar nga I.Taylor në "Origins of the Second World War", fq. 137.*

[19] *F.O 371.23711 R 2065/145/ 90, 23 janar 1939, Durrës, from Sir A.Ryan to Lord Halifax.*

Por synimi i takimit ngjante të ishte tjetër gjë: tërheqja e mbështetjes britanike, për të çuar drejt dështimit skemat, që informatori shqiptar ia atribuonte qeverisë italiane dhe z.Giro. Përgjigjia e Ryanit nuk kishte qenë shpresuese. "Unë e dekurajova atë me vendosmëri, duke mos e lënë të shpresonte që në rrethanat e tanishme, Qeveria Britanike do të përfshihej në një çështje të tillë."-ishte ky raportimi i ministrit britanik në Shqipëri.

Është e dukshme se Zogu ishte i qartë për pozicionin në të cilin ndodhej, por me precipitimin e situatës, kur presioni italian mbi qeverinë shqiptare ishte i ndjeshëm, Zogu shpresonte tek një reagim, apo dhënia e një sigurie nga Britania e Madhe. Por nga vetë përgjigjia që i jepte Rayan-i Zogut, kuptohej që për Foreign Office, asgjë nuk kishte ndryshuar që nga janari: "Ndër të tjera ai (Mbreti Zog, shënim i imi. S.K.) më pyeti për qëndrimin e Qeverisë Britanike, nëse historitë e fundit (fjalën e kishte në lidhje me një sulm të Italisë ndaj Shqipërisë) do të bëheshin realitet. Unë i thashë se nëse pyetja ishte e bërë zyrtarisht, unë duhej t'i drejtohesha qendrës, dhe me shumë mundësi do të merrja një përgjigje që qeveria britanike nuk mund të prononcohet në lidhje me situata hipotetike. Por unë shpreha një mendim timin, personal, që ajo (qeveria britanike, shënim i imi. SK) nuk do ta shihte të arsyeshme të ndërhynte në një çështje të tillë, të paktën përderisa ajo të mos krijonte një luftë të përgjithshme."[20] Zogu, nga ana e tij, kishte shprehur palëkundëshmëri në qëndrimin e vet, duke e konsideruar integritetin e vendit si mjaft të rëndësishëm në lidhje me marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë. Nga biseda në takimin me diplomatin britanik, del që Zogu ishte gjithashtu shumë skeptik në lidhje me një kërcënim italo-jugosllav, nga diskutimet për një marrëveshje për ndarjen e Shqipërisë, që kishin pasur ministri i jashtëm italian, Konti Cianno me atë jugosllav, Stojadinoviçin. Zogu nuk besonte që Jugosllavia të merrte pjesë në ndarjen e Shqipërisë, pasi, në asnjë rrethanë, shtetit jugosllav nuk I interesonte të kishte Italinë në Ballkan. Ai mesa duket e kuptonte se pas marrëdhënieve të mira në dukje mes Italisë dhe Jugosllavisë, kjo e fundit i frikësohej një sulmi nga vendet e Boshtit, e sidomos nga Gjermania në veri, që pas bashkimit me Austrinë e kishte në kufi të drejtëpërdrejtë. Me ndërrimin e qeverisë së Stojadinoviçit, Zogu shpresonte që qëndrimi jugosllav, kundër një ndërhyrjeje të mundshme ushtarake të Italisë në Shqipëri, të ishte më i

[20] *F.O 371.23711 R 2065/725/90, 10 mars 1939, Durrës, from Sir A.Ryan to Lord Halifax (bisedë me mbretin Zog)*

dukshëm, por mendonte që diçka e tillë do të kishte pak gjasa[21].

Mbreti Zog kishte folur me A.Rayan, edhe për përpjekjet për t'u lidhur me Gjermaninë, siç duket përpjekja e fundit për t'u shkëputur nga italianët, por qëndrimi I "Herr Hitler-it" kishte qenë jomiqësor, duke treguar kështu një shenjë të qartë mosinteresimi. Mendimit të Rayanit që interesi ekonomik i Gjermanisë nuk mund të shtrihet deri në këtë vend të Ballkanit, Zogu i është përgjigjur "*se ai nuk mendonte vetëm për interesin ekonomik, por edhe për atë politik, dhe për Gjermaninë. Shqipëria nuk paraqiste asnjë interes, as atë ekonomik, as atë politik.*"

Diplomati britanik raportonte asokohe se Mbreti Zog të jepte përshtypjen e një njeriu që pasi i ka studiuar me hollësi të gjitha mundësitë, nuk sheh alternative tjetër, vetëm atë të vazhdimit të marrëdhënieve me Italinë, duke iu mbështetur asistencës financiare, por duke shprehur vendosmërinë që të mos pranojë kontrollin e tyre. Për shembull, ai do të pranonte, në varësi të negociatave për hua, skemën e italianëve për ndërhyrjen në procesin e zbatimit, por nuk do të pranonte në asnjë mënyrë që italianët t'i menaxhonin ato. Në realitet, Zogu sapo kishte miratuar një ligj për institucionin e kulturës popullore dhe nuk përjashtonte mundësinë e mbështetjes teknike nga ana e italianëve.

Duke e parë me shqetësim tensionimin e marrëdhënieve italo-shqiptare, gjë që mund t'i jepte shkak hapjes së një konflikti të ri që mund të prishte balancat e ratifikuara në marrëveshjen mes Anglisë dhe Italisë, për ruajtjen e status quo-së në pellgun e Mesdheut, qeveria angleze shtoi presionin ndaj italianëve për të shmangur një ndërhyrje ushtarake të Italisë, por gjithnjë duke i bërë të ditur palës italiane që Britania e Madhe nuk ka asnjë interes për Shqipërinë.

Më 22 mars, A.Ryan, në emër të Qeverisë së Madhërisë së Tij, i kërkon shpjegime vetë Fr.Jakomonit në Tiranë në lidhje me situatën e marrëdhënieve italoshqiptare, e cila ka krijuar shqetësim tek pala angleze, gjithnjë duke sqaruar, se "*ky shqetësim vinte nga roli vëzhgues i një Fuqie së cilës i interesonte stabilitetii Shqipërisë, por që asnjëherë nuk kishte qenë kundër rritjes së ndikimit të Italisë në këtë vend*"[22].

Ministri Italian i ka treguar që çështja Giro ka qenë një keqkuptim, ndërsa problem kryesor mbetet në mospërmbushjen e marrëveshjes ekonomike të viti 1936. "Kolegu im italian theksoi se interesat italiane

[21] *Po aty.*

[22] *F.O.371.23711 R 1999/ 725/90 22 mars 1939 Durrës, from Sir A.Ryan to Lord Halifax.*

ishin në plan të parë, por Italia do të respektonte një Shqipëri të pavarur duke bashkëpunuar me qeverinë shqiptare- të cilën unë e nënkuptova atë të MbretitZog,”- raporton Ryan, i cili ende nuk sheh një klimë të tensionuar mes dy shteteve, madje edhe përpjekje për radikalizimin e saj i quant ë superuaua. ”*Mjaft qarqe në Romë kanë kërkuar veprime më drastike, por këshillat për një qëndrim më të moderuar i kanë prevaluar ato. Në këtë drejtim ka ndikuar edhe influenca e Jakomonit*”[23]. Nga fjalët e Jakomonit shihet qartë që dhe vetë zyrtarët italianë nuk kishin koherencë në qëndrimet e tyre dhe në atë çfarë pritej të ndodhte. Nga ana tjetër kjo mund të mendohet se ishte pjesë e një taktike për të fshehur qendrimin e vertetë të Italisë: pushtimin e Mbretërisë së Shqiptarëve.

Pushtimi i Shqipërisë nga Italia do të sillte një prishje ekuilibrash jo vetëm në Mesdhe, por edhe në Ballkan. Për shtetet e Ballkanit, megjithëse konflikti do t’i shpërthente fare pranë, mundësia e një ndërhyrjeje ushtarake të Italisë në Shqipëri nuk merrej seriozisht.

Mbreti i Bullgarisë, Boris, megjithëse e quante një aventurë të rrezikshme, në bisedën që ka zhvilluar me konsullin britanik në Sofie, M.Rendel, shprehej që “ngjan disi e vështirë që Italia të ndërmarrë një hap të tillë, duke përjashtuar vetëm rastin e një konflikti të përgjithshëm”[24]. Edhe pse ndërhyrja ushtarake do të ndodhte pas tre javësh, e tërë çështja ishte krejtësisht e re për të. Mbreti bullgar ishte shprehur që çdo ndërhyrje aktive e Italisë në Shqipëri, do të ishte një problem tejet serioz për tërë vendet e Ballkanit, dhe duke marrë në konsideratë një ide të tillë, ai është shfaqur fillimisht disi i shqetësuar. Por, sipas tij, “është shumë e vështirë të besohej që italianët të ndërmerrnin këtë veprim në një moment të tillë. Nuk kishte arsye të mendohej që të ndodhte ndonjë gjë që do ta lëvizte nga pozicioni i tij Mbretin Zog”, tëcilin Mbreti Boris e ka përshkruar si ekstremisht “të mençur” dhe të mirë trajnuar “me të gjitha metodat e shkollës së vjetër turke të politikës dhe përgjithësisht i aftë të kujdeset mirë për veten”. Çdo gjë që mbreti bullgar dinte, ishte që seria e “jubileve” dhe festimeve tjera, pas të cilave, sipas tij, shqiptarët ishin shumë të dhënë, por që kanë qenë përgjithësisht të financuara nga Italia. Ai besonte që në rastin e fundit italianët e kishin kapërdirë me vështirësi faturën, nga njëra anë, sepse vetë ishin keq me financa, dhe nga ana tjetër se dyshonin në mundësitë e qeverisë shqiptare për t’i

[23] *F.O.371.23711 R 1999/ 725/90 22 mars 1939 Durrës, from Sir A.Ryan to Lord Halifax.*

[24] *F.O. 371.23711 R.1764 / 725/ 90 16 mars 1939, Sofie, from M.Randel to Lord Halifax.*

kthyer paratë.

Por, Italia kishte filluar përgatitjet e saj për pushtimin e Shqipërisë. Nëse deri në gjysmën e muajit mars, Mussolini dëshironte më shumë një marrëveshje me Zogun, sesa një ndërhyrje ushtarake në Shqipëri, kjo e fundit u kthye në planin e ditës për qeverinë fashiste, kjo edhe në sajë të këmbënguljes së Çianos. Situata siç duket ndryshoi, me pushtimin e Çekosllovakisë nga trupat naziste gjermane, më 15 mars, si edhe kur forcat frankiste në Spanjë morën Madridin dhe ishin drejt fitores përfundimtare. Duke qenë se Hitleri as që i kishte vënë në dijeni italianët për veprimet ushtarake të Gjermanisë, Mussolini e quajti momentin e përshtatshëm për të vepruar.

Xhahid **BUSHATI**

ARIF GJYLI, PËRSHTATËSI I PARË I EPOSIT TË KRESHNIKËVE...

(Optikë rileximi për librin "Trimat e Jutbinës" të shkrimtarit Arif Gjyli)

Shkrimtari Arif Gjyli vdiq, më 23 shtator në moshën 76 vjeçare, në Tiranë. Emri dhe veprimtaria e tij e luftës dhe ajo letrare u kujtuan vetëm nëpërmjet një shkrimi. Më vonë, koha vërtetoi se, ky shkrim-kujtimi ishte i fundit, por jo përmendja e emrit, e kontributit të tij si mësues e didakt *(nga të parët që u mor gjerësisht e me hollësi me problemin e mprehtë të teksteve të leximit dhe të letërsisë për fëmijë)*, krijues e studiues *(ka meritën për vënien në pah për të parën herë, të figurës së poetit popullor tiranas Zenel Bastari dhe të një vlerësimi poetik - analitik të jetës dhe problematikës së veprës të Migjenit*).

Si krijues, Arif Gjyli la "gjurmën" e tij në fushën e letrave për fëmijë e të rinj. Konfiguracioni i kësaj "gjurme" ka dhe mbart në thelbin e saj, modelin e një krijuesi që përvetësoi disa tipare, si: idealin, përkushtimin dhe natyrën që e kishin rilindësit tanë të shquar e të ditur që, mesa duket, ia mëkuan me dashuri edhe intelektualit Arif Gjyli. Duke përqafuar atë model,ai ndoqi atë rrugë të ndritur; u mor dhe dha ndihmesë në fushën e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj e më gjerë *(pedagogji, psikologji, mësuesi),* kuptohet në një kontekst të ri historik, i cili shpërfaqte ditaditës dukuri të reja në jetën shoqërore e kulturore.

Arif Gjylin nuk e kam takuar qoftë edhe një herë në jetë, ndonëse emri i tij ishte i "shëtitur" në Shkodër. Nuk pata rast ta njoh personalisht dhe të bisedoj me të, ndonëse kam pasur shumë dëshirë... Së paku, t'i bëja një portret sa njerëzor aq dhe artistik. Pas shumë vitesh, gjeta si relikte të çmueshme, disa grimca të portretit të tij në librin "Muhamet

Uruçi, babai im”. Në pjesën e titulluar: “Në vend të hyrjes” të këtij libri memuaristik, citoj: “*Ka një memorie të jashtëzakonshme..., ... ka mbetur si gjithmonë i ndershëm.*” Gjithashtu citoj: “*Më shikoi drejtpërsëdrejti dhe unë për herë të parë dallova nën xhamat e tejdukshëm një palë sy plot dritë.”; ... “Pas kaq vitesh mund të them se takimi me Arif Gjylin më ka lënë një shije shumë të ëmbël, jo vetëm për kulturën e gjithanshme që rrezatonte, por edhe për saktësinë me të cilën ai kujtonte dhe njihte gjithçka me detaje nga ato vite të vështira.*”

Edhe pse kanë kaluar disa dekada nga çlirimi i Shqipërisë, Arif Gjyli nuk është i shkëputur nga kujtimet e luftës, që për të në thelb, ato, duhet të ishin realizueset e ëndrrave të tij të vërteta. Për ato ëndrra, ai la peng jetën. Siç duket për Arif Gjylin, një pjesë mbeten vetëm ëndrra... Ata merrnin ‘jetë’vetëm kur ai i kujtonte (herëpashere) nëpërmjet bisedës së tij të heshtur për plagët e luftës dhe përmendjes së emrave të shokëve të vërtetë. Ishte një bisedë e dhembshur dhe tragjike. Kujtonte edhe momente si këto: “*Më mbanin të lidhur me tela, më kanë mbajtur pa gjumë, më kanë mbajtur për një kohë të gjatë në çimento... ... Natën më linin pa gjumë dhe gjithë ditën i binin një gramafoni të madh shurdhues sa të mos mundja që të fle asnjë minutë. ... Më morën e më shoqëruan në një pyll aty pranë. Në këtë kohë unë fillova të dyshoja dhe fillova të bërtas. ... Më bënë një gropë në formë varri dhe më kërcënuan se do të më vrisnin si buharinist. Pastaj më sollën me automobil këtej tek Tirana e re. Më vonë e pashë se më kishin çuar në një shtëpi në rrugën e Elbasanit. Në këtë shtëpi më mbajtën 43 ditë mes torturave ç’njerëzore”*.

Marrëdhënia e krijuesit Arif Gjyli me letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj janë objekt i këtij shkrimi. Përmes këtyre rreshtave kërkoj një shikim ndryshe, një optikë rivlerësimi veçanërisht në dialog me kohën e pas kohën që jetoi e krijoi ky shkrimtar. Librat e botuar, duke parë vitet përkatëse të botimit, nuk përkojnë me fillimet e vërteta të ndihmesës së Arif Gjylit në fushën e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Vitet e “ndajnë” dhe e “largojnë” nga fillimet dhe të vërtetat letrare. Arsyet... sikur mbeten të pakuptueshme, nganjëherë absurde.

Si krijues, fakt, i takon brezit të shkrimtarëve që krijuan traditën e re të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Si krijues vetëm emri i përmendët. Në të rrallë edhe nja dy gisht rreshta. Kur në të vërtetë ai dhe brezi i tij: “... zgjeruan shumë diapazonin tematik, që thelluan fondin realist dhe që e ngritën në një nivel më të lartë cilësinë ideoartistike...”. ...

Më tej, po për këtë shkrimtar thuhet ... “Në këtë kuadër, gjithashtu, duhet parë edhe kontributi i shkrimtarëve më me stazh si M. Kuteli, Arif Gjyli, M. Zaloshnja, që bënë një punë të mirë për popullarizimin e letërsisë së pasur të popullit për fëmijë, ose përmes ritregimit, në formë të përshtatshme, të rapsodive dhe baladave të moçme shqiptare, ose përmes përpunimit të përrallave popullore dhe tregimeve të tjera të kësaj natyre. Në traditën e re hyn edhe kriteri i vlerësimit, tek i cili u mbështetën shkrimtarët B. Dedja, M. Gurakuqi, Arif Gjyli, M. Zaloshnja dhe N. Jorgaqi për të mbledhur dhe redaktuar vepra të disa autorëve të shquar të së kaluarës për fëmijë”. Dhe për të vijuar mendimin e mësipërm, me atë që një studiues tjetër e quan absorbim të folklorit, gjejmë nga ai këtë formulim, formulim që gjen mbështetje në marrëdhëniet të ndërsjelltë të krijimit letrar dhe folklorit: “Një pjesë shumë e konsiderueshme e vjershave me subjekt ose e poemave të De Radës, Darës, Serembes, Sakos, Çaçit, Jakovës, Siliqit, Balës, Qafëzezit, Çomorës, **Gjylit** e më vonë akoma Agollit, Kadaresë, Arapit, Dedes, Beqarajt e Gjokutajt, dëshmojnë për lidhjet e qëndrueshme të poezisë sonë për fëmijë me folklorin, për absorbimin që i kanë bërë të gjithë këta poetë folklorit për nevojën e përhershme që ata kanë ndier për t’u dhënë fëmijëve të brezave të ndryshëm vargje, ku njomështia dhe shpirti popullor të ndihen me po atë forcë që i ka edhe populli”.

Në mes shumë studiuesve, gjykimet dhe interpretimet e Prof. Vehbi Balës për këtë model krijuesi, sikur kanë hyrë më në thellësi të procesit krijues të tij, gjë që kanë sjellë më njohje dhe interpretim të veprës letrare. Mendoj se edhe sot, ata janë aktuale në shikimin dhe zbërthimin e figurës së Arif Gjylit në këtë lëmë letrar, lëmë që mbart vlera bashkëjetuese e bashkudhëtuese. Kjo është arsyeja që, studiuesi i mirënjohur i Letërsisë për fëmijë dhe të rinj Prof. as. Dr. Astrit Bishqemi në veprën e tij, me të drejtë ndihmesën letrare si parësore të shkrimtarit Arif Gjyli e vendos te kapitulli “Përshtatja dhe rikrijimi”, ku e pozicionon vlerësueshëm dhe meritueshëm, duke e lidhur emrin e tij me lëvrimin e këtyre dy zhanreve (veçanërisht me të parin), qëllimi i të cilit, (dhe të tjerëve krijues që u morën me këto dy zhanre) është: “... që ta bëjnë të kuptueshme e të këndshme për lexuesin e vogël një krijim madhor të folklorit ose një vepër të shquar të letërsisë për të rriturit”.

Hulumtimet tona për këtë figurë që, (shkëlqimi, denigrimi dhe heshtja jetuan brenda shpirtit dhe jetës së tij të ndershme) si brez i parë që krijuan traditën e re të letërsisë shqipe për fëmijë, na flasin se në

periudha të ndryshme kohore studiuesit, kur kanë dhënë mendime për veprat e Arif Gjylit, pothuaj vëmendjen e kanë përqendruar më shumë te libri “Trimat e Jutbinës”. Ky interesim, mendoj, se duhet pranuar.

Nga një vështrim i hedhur në rrafshin historik të procesit të zhvillimit të kësaj letërsie, emri i Arif Gjylit i takon të jetë nga të parët që lëvron përshtatjen dhe rikrijimin, këto dy zhanre, që ende përbëjnë një traditë të re botimi në Shqipëri. Mendimi im përkon me atë të një poeti të mirënjohur, i cili thotë: “Është meritë e Arif Gjylit që, me veprën e tij më të mirë “Trimat e Jutbinës”, nisi nga të parët traditën e rrëfimeve të shkruara në bazë të ciklit tonë të mrekullueshëm të kreshnikëve, ...”. Ndërsa për dy veprat e tjera të këtij autori: “Historia e dhelpnës plakë”. dhe “Djathtas, majtas 1, 2, 3”, janë më në periferi nga ana e kritikës sonë letrare. Edhe atëherë kur është dhënë mendimi për to, më shumë ka ngjasuar me ato rrezet e vagëlluara të diellit vjeshtak, që ndoshta kishin nisur t’i përjetonte pak e pak trishtueshëm edhe vetë shkrimtari, jeta dhe koha e të cilit, dikur ishte ëndërrimtare... Për librin “Djathtas, majtas 1, 2, 3” mund të themi se disa nga poezitë e kësaj vepre poetike zgjojnë interes pranimi në tekste shkollore e antologji.

Me të drejtë, nga disa studiues të kohës, është thënë se, “Trimat e Jutbinës” është vepra më e arrirë artistikisht e shkrimtarit Arif Gjyli. Kjo vepër zgjoi dhe interes diskutimi për kohën kur u botua.

Sipas studiueses dhe bibliografes Faire Tabaku kjo vepër shfaq disa marrëdhënie e disa rrafshe vlerash. Në mënyrë të përmbledhur autorja e shkrimit nënvizonte këto:

*Libri “Trimat e Jutbinës” i A. Gjylit doli në qarkullim në tremujorin e fundit të vitit 1960.

*Brendia e tij është vetë Eposi popullor, janë rapsoditë e Veriut, këngët e bukura të kreshnikëve që populli ynë i ka përcjellë gojë më gojë gjatë shekujve.

*Fëmijët i kanë shumë qejf veprat fantastike dhe me aventura, ... Ja, pra, pse libri “Trimat e Jutbinës” u bë i dashur për fëmijët.

*Suksesi i librit qëndron në subjektin e tij.

*Burimi kryesor i librit është Eposi i Veriut. A. Gjyli ka ditur të zgjedhë disa nga më të bukurat, që u përshtatën më tepër veçorive të moshës së fëmijëve, që janë më afër psikologjisë së tyre.

*A. Gjyli për të shkruar librin “Trimat e Jutbinës” është mbështetur në dy botime “Visaret e Kombit” 1937 dhe “Këngët popullore legjendare” 1955.

*Në këto tregime mëshihet dëshira për pamvarësi. (Jutbina bëhet simbolikë e trimërisë, e lirisë, e vlera dhe e virtyteve të shqiptarëve, - nënvizimi im Xh. B.).

*Në tregimet paraqiten qartë dhe në mënyrë të gjallë të gjitha karakteristikat e shqiptarit, si: besa e Zanave e Orëve dhe e kreshnikëve, trimëria dhe burrëria e tyre..., besëtytnitë e popullit tonë; doket, miku, dashuria dhe nderi i familjes, trimëria, etj.

*Vetë A. Gjyli thotë se duke u dhënë për botim këtë libër është nisur nga dëshira që t'u bëjë të njohur fëmijëve disa nga rapsoditë e bukura të Veriut, t'i përgatisë ato që t'i shijojnë në origjinal.

Duke mos iu larguar problemit që po trajtojmë rreth krijimtarisë së shkrimtarit Arif Gjyli, një studiues që e njeh mirë veprën e këtij autori, thotë se: "Aspekt i veçantë i mbështetjes së shkrimtarëve te folklori ishte, ndër të tjera, përshtatja për të vegjlit e pjesëve nga cikli i kreshnikëve. Disa nga këngët më të bukura të rapsodive të Veriut përfshihen në librin "Trimat e Jutbinës" (1959) e A. Gjylit. Autori i mblodhi dhe i përpunoi ato me kujdes, duke ruajtur vlerat origjinale të tyre. ... Gjatë përpunimit të motiveve, autori ka ruajtur veçoritë e ligjërimit popullor, si përdorimin e fjalive të shkurtra e të ngjeshura me mendim, përforcimin e ideve dhe të veçorive të personazheve me anë të përsëritjes dhe të rimarrjes së situatave, përzgjedhjen e shprehjeve dhe të figurave karakteristike për krijimtarinë gojore të popullit, etj. Mirëpo, përshtatja në prozë e Eposit të kreshnikëve, solli në shumë raste humbje të ritmit të veprimit, si dhe dobësim të forcës shprehëse të gjuhës e të figurave artistike të origjinalit".

"Trimat e Jutbinës" e kapërcyen me "trimëri" kohën kur u shkrua. Autori ruajti më shumë se një marrëdhënie me Këngët Kreshnike. Reflektimin shumë kuptimor e shumë shtresor e gjeti autori duke pasur parasysh këto vlera të krijuara që më parë, por duke i shtuar edhe vlerat që i përçoi në libër, siç janë:

*"Veprat janë krijime popullore-gojore dhe mbajnë shenjat e thella të kësaj forme në strukturë e në destinim. Duke qenë vepra kolektive, që rrinë të gjalla në kohë, ato kanë në vete edhe shenja të kohëve të ndryshme".

*"... në Kangët kreshnike gjithëçka është e mundshme, ngase e thëna bazohet në mrekullitaren dhe në fantastiken".

*"Këto këngë, prandaj, e japin ndodhinë, apo ngjarjen të figuruar, nëpërmjet një procesi krijues të tregimit, përshkrimit dhe sigurimit".

(gjithashtu nënkupto dhe “Trimat e Jutbinës”).

Vepra jeton dhe sot. Kjo është vlerë e veprës. Për arsye se, autori i ruajti hapësirat e Jutbinës. I njohu mirë dhe i dashuroi. Ashtu siç i përftoi me ndjesinë e shkrimtarit, ashtu edhe i dhuroi si “Jutbinë” krijimtarie. Mbi këtë bazë, optika e sotme e rileximit na thotë se, vepra e Arif Gjylit i mbarti dhe i ruajti vlerat përmes një fenomeni të njohur, siç ishte ai i marrëdhënies mes letërsisë së shkruar shqiptare dhe folklorit e letërsisë gojore, (ekuilibër që e ruajti artistikisht si në formë, strukturë e veçanërisht në përmbajtje, - nënvizimi im Xh. B.).

Në mënyrën e perceptimit dhe të paraqitjes në shtjellimin artistik, ashtu siç e theksuam më lart, shkrimtari preferoi përshtatjen.

Vepra “Trimat e Jutbinës” ka shenjën dhe koherencën e saj. Nocioni kohor, nocion që shoqëron veprën mbetet një marrëdhënie që duhet parë e studiuar. Për këtë problem studiuesi Jorgo Bulo thotë: “Në qoftë se me “Tregimet e moçme shqiptare” M. Kuteli, duke çelur rrugë në prozë, ritregoi me një ndjenjë të hollë artistike subjektet dramatike të këngëve të ciklit heroik dhe legjendar, stilizimet e disa prej tyre dhe motive të shkëputura formojnë bazën e subjekteve të shumë krijimeve në prozë, sidomos për të vegjël, por edhe për të rritur. Rëndësia e këtyre krijimeve (të N. Priftit, A.Gjylit, M. Zeqos etj.) qëndron në radhë të parë në popullarizimin e traditës folklorike dhe në pohimin e mundësive të saj për të ushqyer zhvillimin e prozës së re me subjekte dhe ide që e ruajnë aktualitetin edhe në kohën tonë dhe i shërbejnë edukimit të brezit të ri me virtyte morale të trashëguara nga të parët edhe përmes folklorit.

Por, ndërmjet kësaj mënyre të shfrytëzimit të motiveve të eposit heroik, që u mbetet besnike subjekteve tradicionale dhe mënyrës tjetër, ku subjektet folklorike shërbejnë vetëm si pikënisje për të ndërtuar një ngrehinë të re artistike, qëndron një mënyrë e tretë, ajo e integrimit të motiveve të ndryshme të këngëve të eposit në subjekte që s’kanë asnjë lidhje me kontekstin social-historik të ciklit, të cilit i përkasin ato motive”.

Në optikën tonë të rileximeve sollëm në kujtesë veprën “Trimat e Jutbinës” të shkrimtarit Arif Gjyli, edhe për një arsye tjetër, se “Brezave të rinj ai do të vazhdojë t’u rrëfejë për “Trimat e Jutbinës”. Si gjysh i mirë ai do t’u tregojë vogëlushëve “Historinë e dhelpnës plakë”, kurse në përmbledhjen me vjersha për fëmijë “Djathtas, majtas 1, 2, 3!” do t’u flasë për stinët e bukura të Atdheut tonë të shtrenjtë, ...”.

Shkodër, maj 2019

Literatura e shfrytëzuar:

- *Siliqi, Llazar: "Me mendjen te brezat e rinj", Drita, 01.10.1989*
- *Uruçi, Dashamir: "Muhamet Uruçi, babai im", Geer, Tiranë, 2011.*
- *Po aty., f. 23., thënie e Xhavit Gjylbegajt, mjek pediatër. Ishte ky, Piciruku i famshëm që u bë burim frymëzimi për veprën me të njëjtin emër të shkrimtarit Teufik Gjyli.*
- *Dëshmia e ish-deputetit Arif Gjyli, botuar në gazetën Dita, 14. 05. 2013.*
- *Gjyli, Arif botoi këto libra: "Historia e dhelpnës plakë" (përrallë në vargje, Naim Frashëri, Tiranë, 1958),"Trimat e Jutbinës" (punue simbas motiveve popullore, Naim Frashëri, Tiranë, 1959), "Djathtas, majtas 1, 2, 3", Naim Frashëri, Tiranë, 1960), "Trimëri e burrëri". Naim Frashëri, Tiranë, 1964 (përzgjedhje nga tekstet e këndimeve të përdorura deri në vitin 1927).*
- *Simpoziumi i parë kombëtar për problemet e letërsisë për fëmijë" (27 - 28 maj 1974), Naim Frashëri, Tiranë, 1975; shkrimi: "Probleme të studimit të traditës së re të letërsisë sonë të sotme për fëmijë" autori: Prof. Vehbi Bala, f. 38.*
- *"Probleme të traditës dhe të aktualitetit në letërsinë tonë për fëmijë", Naim Frashëri, Tiranë, 1976; Adriatik Kallulli: "Poezia jonë për fëmijë dhe folklori", f. 117.*
- *Bishqemi, Prof. As. Dr. Astrit: "Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj" (kapitulli: Përshtatja dhe rikrijimi), 4.2.2.3.6, f. 537 – 538., Botim i tretë, i plotësuar dhe i përmirësuar, dy Lindjes dhe dy Perëndime, Tiranë, 2008.*
- *Bibliografia e Letërsisë për fëmijë dhe të rinj (1945 – 1964), përpiluar nga: Faire Tabaku dhe Diana Kosturi, (Instituti i Studimeve dhe Botimeve shkollore, Tiranë, 1965), zëri: 59. Gjyli, A. Historia e dhelpnës plakë. (Përralla). (Pikt. V. Lalo), Tiranë, "Naim Frashëri", 1958. 56 f. Me ill. 18 cm. Tir. 3000, L. 15.*
- *"Anija e çuditshme", vjersha për fatosat, Naim Frashëri, Tiranë, 1962. Në këtë antologji poeti Arif Gjyli përfaqësohet me poezitë: "Unë e babi", "Kukulla Mirushkë e sëmurë", "Rreth e rrotull", "Treni ynë".*
- *Më 23.04.1961 Komisioni i letërsisë për fëmijë pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve organizoi një diskutim krijues rreth librit "Trimat e Jutbinës" të shkrimtarit Arif Gjyli. Mbi këtë vepër foli Faire Tabaku, përgjegjëse e bibliotekës për fëmijë të Pallatit të*

pionierëve në Tiranë.

-Çadri, Prof. As. Dr. Ramazan: "Lindja dhe formimi i Letërsisë shqipe për fëmijë", Redona, Tiranë, 2009, (Nga pjesa 1.1. Fillimet e përrallës së re për fëmijë, F. 113 – 114)

- Hamiti, Sabri: "Albanizma", Botues: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta CIII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 42, Prishtinë, 2009; (Letërsia Monumentale, 2. Monumentet: Historia, Kanuni, Kanga), f. 62.

-Bulo, Jorgo: "Magjia dhe magjistarët e fjalës", Dituria, Tiranë, 1998, shkrimi: "Eposi legjendar në prozën e sotme", f. 99.

▪ **Letërsi** ▪

Zef **ZORBA**

MBI TRAGJEDINË E PAPËRFUNDUAR "HAJRIJA" TË AT GJERGJ FISHTËS

Data "7 Fruer 1939" që gjindet në dorëshkrimin e tragjedisë "Hajrija" të nisur së shkruari nga Fishta është vështrimplotë.

Në atë kohë ai, edhe pse i mposhtur nga sëmundja (do të vdiste pak muaj mbrapa), reket sërish me vazhdu prodhimtarinë letraro-artistike, edhe pse i vrare e i zhgënjuer në idealet e veta patriotike e shoqërore nga rrjedhja e asohershme e punëve në vendin tonë. Ose ndoshta për virtyt të instinktit ironik të vet (ç'ka duket se i gëzojnë poetët) po parashikonte, i tmerruar e i pezmatuar, kobin e "7- të Prillit"

Sepse mbetet gjithmonë ajo që ka pasë kodifikuar Shelley: "*Poetet janë buritë që therrasin për beteja, poetët janë ligjevënësit anonime të botës*"

Dhe ai, si katapultë për të tillë sulm shkallmues, si kurdoherë në mbrojtje të drejtesisë, do të zgjidhte mjetin më efikas e të preferuem: dramatikën, art të cilin e ka pasur kështjellë të pamposhtur e ngallënjyese gjithmonë. E për shumë arsye madje.

së pari, dashuria e prirja që ka pasë vazhdimisht për skenën. Ai e ndjente në shpirt se prej një podi të tillë, tribunë objektivizmi estetik, mund të shpaloste pa cen subjektivizmin që i mufatej hareshëm ose edhe kobshëm me poliendrizmin e shpirtit të vet. Me sypar të hapun e shifte vetvehten, jo vetem nismëtar e flakërues idealesh e parimesh, por njëherit edhe personazh dialogues me popullin. E dëshmon këtë jo vetëm prodhimtaria e tij e gjerë në dramatikë, por edhe thurja teatrale që ndeshet rëndom edhe në gjinitë e tjera poetike të përqafuara prej

tij. Ai deri një sonet satirik "*lum i forti*" e ndërton si bocet skenik me personazhet dialogues të emërtuar (jashtë metrikës) në krye të vargjeve–batutë.

Së dyti, e kjo më kryesorja, e saktë se Fishta e ka ditur mirë sa virtuozitet e afërsi mbarte në vete raporti audio-viziv me masën. Si predikator i shquar që ka qenë, e ka pasë të qartë se komunikimi shqisor është me emotiv e i frytshëm sesa raporti liberator "autor-lecites", pavarësisht nga popullariteti që mund të gëzojë faqja e shkruar. Pse në fund të fundit leximi ka më tepër tipar akademik të kufizuar, kurse spetakli është kurdoherë asociativ. Prandaj Fishta kurdo që ka ndjerë nevojën e një kuvendimi, referendar në synim, i është drejtuar skenës. Qoftë për të fishkulluar të meta e dobësi, qoftë për të dënuar pa mëshirë mendësi e komplotime të poshtëra, të ishin ato edhe nga "Fuqi të Mëdha ", që mizorisht po coptonin atdheun.

"Juda Makabe " i shkruar në vorbullën e Luftës ballkanike, bëhet akuzë aq e fuqishme, saqë Atë Gjergj Fishta, i turitur nga padrejtësitë, duke harruar petkun e vet fetar dhe virtutet theologjike, rreshqet pasionalisht në blasefemi:

" O Perendi , a ndjeve?
Tradhetaret na lane pa atdhe
E Ti rrin e gjuen me rrfe
Lisat n'per male kot!"

Tri janë tragjeditë e Fishtës:" Juda Makabe","Ifgjnia" dhe " Hajrija". Kjo e fundit mjerisht e pambaruar, i janë gjetur e botuar vetëm dy aktet e para. Dy tragjeditë e para, sikundër edhe pjesa dërmuese e veprave të tjera skenike të tija, kanë gëzuar mjaft herë skenat teatrale, kanë hasur aty miratim emotiv të gjithembarshëm, që pa frikë mund të konsiderohet kritike popullore. S'ka pasë si të ndodhte kështu me « Hajrijen ». Nga ana tjeter, » Hajrija » e Fishtës është mjaft pak e njohur edhe si lexim, megjithëse në dy aktet e botuara, shtron e zbulon shumë veçori të spikatura estetike, si dhe mjaft për të qëmtuar mbi evolucionin poetik të autorit.

Për këtë arsye, por edhe për tiparin ultimativ të saj, duket me vend kufizimi te « Hajrija ». Do të dëshironim që këto pak fjalë të vlenin sadopak për një këndvështrim tjetër të artit të Fishtës, qoftë ky edhe i karakterit limitativ.

Edhe pse me folë për heterogjeninë e veprave teatrale të tija ka rrezik të shkitet në kodifikime bibliografie e komentative që shpeshherë tingëllojne pedante.

Porse edhe analiza spekulative mbi një vepër të papërfunduar i ka rreziqet e veta. Veçse edhe shmangiet mund të mënjanohen, po të mos u largohemi treguesve të gjetur si dhe analogjive krahasimore. Mbase na ndihmon këtu ligji matematik i probabilitetit.

Mbeshtetje, madje edhe inkurajim na jep kritika e përbotshme që dendur merret edhe me vepra cunge e fragmentare, të trashiguara nga lashtësia. Kushedi pse, po kur lexoj dy aktet e 'Hajrijes ', më vete mendja gjithmonë te „*Skllavi*" i papërfunduar i Mikelangjelos, tek rropatje e tij të stërmundimshme për t'u shkoqur prej gurit që e robëron.

Vështirësia për një gjykim panoramik mbi këtë tragjedi thellohet edhe më tej, ngase, siç duket, s'është gjetur ndonjë skene ose stesurë paraprake e thurur nga autori. Të ketë humbur ajo bashkë me të tjera gjëra të vyera gjatë bastisjeve rrënimqare të kryera në Kuvendin Franceskan? Sepse s'është e besueshme që Fishta, i ballafaquar me një teme aq të harlisur, të ketë nisur redaktimin e tragjedisë në mënyrë bashkëkohore, pa pasë hartuar paraprakisht tërë zhvillimin psikologjik e skenik të veprës. Për një skemë të tillë flasin projektimi i veprës në 5 akte, si dhe renditja në listën e vehtjeve të dramës të mjaft personazheve që nuk dalin në skenë në dy aktet e para të tragjedisë.

Nga ana tjetër tregues të tjerë analogjike, mbase na hapin rrugë për të gjykuar mbi veprën e sidomos mbi autorin vetë, qoftë edhe nëse tani i mërtisur nga një vel trishtmi, por gjithsesi i kordinuar si gjithmonë tek moduli i vet poetik.

Në dy tragjeditë e tjera (sikurse te "Lahuta") protogonist i mirëfilltë përshkues është idea e lirisë e pavarësisë dhe personazhet të gjithë duke ruajtur identitetin e vet shërbejnë për ecjen zhvillimore, te"Hajrija", drama e tragjedia thelbësisht subjektive është njëkohësisht e egërsisht objektive. Ajo travajimet e veta i flakëron dhunshëm kundër mjediseve, të shoqërisë, kundër mykurive e perçudnimeve që e ngujojnë.

S'ka dyshim që Fishta të jetë njohur me mitin e *Medeas* nëpërmjet të veprave te Euripidit, Senekës, Kornejt e sa e sa dramaturgëve të tjerë, që janë marrë me ketë subjekt.

Për të gjithë ato burim ka qenë mitologia greke:"*Medea*" e tradhëtuar prej burrit të vet Jasonit, hero i Argonanteve, që hakmerret duke mbytur fëmijët që ka pasë me të.

Pra pak a shumë të gjithë ato drama me burim *Medean* kanë një bosht erotik të përçudnuar nga xhelozia. Kurse"Hajrija" e Fishtës nuk ngacmohet nga e tillë ndjenjë e sidomos s'është mitologjike. Ajo është historike, e martuar në një mjedis amoral e ç'njerzor. Autori s'na ka lenë shtjellimin psikologjik të personazhit, por mund t'a imagjinojme atë mjaft mirë. Duke njohur personazhet e tjera femrore të Fishtës (*Tringa,*

Ifgjenia, Motra e Avdise, Ferina etj.) e sidomos duke i ditur bindjet e tija të mbështetuna fuqimisht në eskatologjinë theologjike, por edhe në filologjinë zakonore na lejohet të supozojmë që" Hajrija"e Fishtës është fundamentalisht humane edhe pse e rrasur në infanticid nga pabesia e zvetënimi, ku e kanë katandisur rrebeshet.

Ndoshta nga ndikimi i Molierit që "Tartufin"e neveritshëm e nxjerr në skenë vetëm në aktin e tretë e mbrapa, edhe Fishta, Hajrijen nuk e paraqet në dy aktet e para. Por ngurrimi i Fishtës është dhimbja për personazhin, e cila do të jetë dinjitoze e fisnike edhe në krim. E këtë tipar ajo duhet ta konfirmojë edhe në katarsin sublimativ të vetvrasjes (e thotë këtë edhe folklori e s'do mend që Fishta do të jetë bazue mbi këtë). Kurse infanticida mitike, *Medea*, mbijeton e madje vazhdon rrugën e vet erotike e kriminale.

Një tjetër veçori për t'u rilevuar është raporti krejt specifik "*vëlla –motër"*, që verehet në literaturen tonë edhe gojore e që shpesh e kemi takuar të gjithë në mesin tonë deri në ditët e sotme. *Antigona* e Sofokliut ngre krye kundër tiranisë e diktaturës edhe me veteflijim, kurse *Hajrija* shkon më tutje, shumë më tutje.

Pastaj gjuhëtarë të shquar, na mësojnë, se ndërsa në gjuhët e tjera indo-europiane nga rrënja sankriste "*ma*" kanë ardhur termat: *motër, matter, mat, madhër*, në shqipe termi është tjetërsuar në substantivizëm, "*motër*". Kjo mund të ketë ndodhë nga zhvillimet demografike e klanore, por mbase s'është guxim të menduarit që në kodin gjenetik të femrës shqiptare të jetë i tiparizuar ky dualizëm raportativ: nënë-motër". Si rrjedhojë mund të afirmohet se Hajrijes i kanë tradhëtuar e vrarë vëllezër e bij njëheri.

E prej kësaj s'është i veshtirë dallimi me zemren e brengosur të poetit, kërkimi i një shtegu për të përligjur, nëmos etnikisht, protogonisten fatzeze e për t'ja drejtuar rrufetë e veta çmoralizuesve të kombit.

E ketë na e pasqyron më së miri me ravijëzimet e mjedisit amoral dhe të personazheve kriminelë e çnjerzore të dy akteve të para, përgjegjës këto për tragjedinë e *Hajrijes* e të kombit të robnuar e të nëpërkëmbur.

Mos ai t'i ketë parë ata prap të ngrysyra e gjithnjë të thëngjillosura dhe pas njëzet e shtatë vjetësh pavarësie aq fort të dihatur dikur?

E u rrek t'i gjuante me rrfe!

DEMOKRATI AT GJON SHLLAKU [1]

Edhe mund t'i vrasë veshin dikujt atributi i këtij emri, por s'do t'i vijë e papritur atyre që janë mësuar tashma me të tilla errësime emrash, si është ky i françeskanit të martirezuar. Jo, mbase mund të trembet ndokush, që për karrierë vetjake u bë megafon i atyre që dënuan me vdekje Atë Gjon Shllakun, misionarin shëmbullor, patriotin e demokratin e papërkulur, intelektualin e pamort.

Për opinionin publik, sot e kësaj dite, dënimi dhe pushkatimi i tij janë krejt të pa-spjegueshme e të paligjëshme. Madje shumë prej nesh presin ditën kur ai dhe martirë të tjerë të rifitojnë dritën e pafajsisë, gjithmonë me anën e një rishqyrtimi publik të procedurës së ndjekur për dënimin e tyre. Jo se me demaskimin e epokës dhe të personave përgjegjës do të kërkohet njëkohsisht edhe hakmarrje. S'është ky qëllimi i askujt, e mund të thuhet me plot bindje se nuk do të ishte as i vetë Patër Gjonit, i cili edhe për së vdekuri do t'ju drejtohet ithtarëve të vet me vargjet e mjeshtrit dhe kolegut të tij Atë Gjergj Fishtës:

" Ndalniu! Ku veni, burra!
Pashe Zotin lshoni hutat,
pse teper gjak asht derdhun,
pse teper bajte kem futat!..."

Pra jo hakmarrje. Por edhe që ish–prokurori, Aranit Çela, që derdhi helm, fyerje e shpifje në gjygjin mashtrues e të kurdisur, ish- prokurori i cili edhe për këto "merita" i ngjiti shkallët deri në Gjykatën e Lartë, tani të caktohet anëtar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ?! Kjo me të vërtetë është e patolerueshme. Pajtimi kombëtar që sot po kërkohet, i ka kufijtë e vet….

Por të përpiqem tash e të hjedh një fill dritë mbi ketë dëshmor të lirisë, në pragun e 45- vjetorit të vrasjes së tij.

Në numrin 3-4 të vitit 1942, revista "Hylli i Dritës" botonte tre elegji për tre dëshmorët e mëdhej të Shqipërisë. ("Shpellë e Dragobisë", "Syrgjyn Vdekur" të Fan Nolit, si dhe për Dom Gjon Gazullin). Këto poezi priheshin nga një shkrim i shkurtë i drejtorit të asokohshëm të revistës, Atë Gjon Shllaku, me titullin: "Fatosave të harrum". I tillë koncepsion editorial ka qenë kuptimplotë në atë kohë (Atdheu ishte i pushtuar), por merr vlera edhe sot, posaçërisht për dy rreshtat e fillimit dhe të fundit të artikullit, që ishin kështu:

[1] *Nga kumtesa e mbajtur në shkurtin e vitit 1991, në Radio Shkodra. Autori i referohet artikullit të At Gjon Shllakut: "Fatosave të Harruem".*

"Tjeterkun, njerizit e idealit,
ne u mbyteshin për së gjalli,
nderon së dekuni.
Ndër ne ata mbytën dy herë: Harrohen"

Një komb që lindet ka nevoje për fatosa qi desin. Por fatosat qi desin nuk kanë çe të bajnë në një komb qi i harron dhe i përbuz"

Fatkeqësisht këto apostrofime tingëlluen deri sot si profeci të trishta, por s'duhet të jehojnë më ashtu në të ardhmen. Dëshmorët mos u harroshin kurrë.

Atë Gjon Shllaku, bir i një qerraxhiu të varfër lindi në Shkoder në vitin 1905. Që në dha shënja zgjuarsie dhe krejt i vogël hyri në Kolegjin Françekan të Troshanit, drejtor i të cilit ishte Atë Gjergj Fishta, i cili duke vlerësuar drejt prirjet e nxënësit të vet e dërgoi atë për studime në Holandë, ku ai u diplomua për teologji, e pastaj në Lovain të Belgjikës: dy vitet e para në Fakultetin e Kimisë, dhe dy tjerat në atë te Filozofise. Pas këtij viti u transferua në Francë në Universitetin e Sorbonës, dhe në vitin 1937, u diplomua aty në filozofi. Para se të kthehej në Atdhe, ai ndoqi , po në Paris edhe një kurs specializimi për gazetari.

Teza e diplomës të cilën e mbrojti para docenteve të Universitetit të Sorbonës, titullohej: **"** *"Kritikë për filozofinë e Giovanni Gentile*" (shënojmë se Gentile ka qenë një mendimtar i përkrahur nga fashizmi, aq sa Musolini e pati emëruar Ministër të Arsimit)

Për këtë arsye, si dhe faktin që ai gjatë qëndrimit në Francë frekuentonte rrethet e të arratisurve politikë, njëheri eksponentë të rëndësishem të qeverisë Noli, u arrestua në Torino dhe u mbajt në burgun Santa Margerita, rreth 20 ditë.

Mbas kthimit në Shkodër ai u emrua profesor në Gjimnazin Françeskan, detyrë që ai e kreu ma së miri, deri në fund të vitit 1944, pa lanë mbas dore detyrat e tjera si meshtar dhe publicist. Në mes tij dhe studentëve u krijua shpejt një atmosferë dashamirësie e ndersjelltë, mëgjithë që ai kërkonte shumë dhe ishte i shtërnguar në nota.

Plejades së lavdishme të etërve françekanë, si Fishta,V. Prendushi, A. Harapi, M. Gjoka, J. Rrota,Q.Nika, P.Bardhi e shumë të tjerë nisën t'ju shtohen françekanët e rinj, të diplomuar në fusha të ndryshme të dijes në Universitet më të përmendura të Evropës, si Gj. Shllaku- doktor në filozofi, A. Gegaj– laurat në histori, J. Marlekaj-laurat në letërsi, L. Kabashi- i diplomuar në artet grafike e një varg të rijsh që vazhdonin studimet e larta në degë të ndryshme, pas diplomimit paraprak të sejcilit në teologji. Françeskanët ndiqnin e përkrahnin veprimtari me

vlerë të madhe në të gjitha fushat kulturore e artistike, në muzikë, në botime librash e revistash, në konferenca studimore, si dhe në takime të programuara ose të improvizume me pjesëmarrje të intelektualëve, profesorëve, ekonomistëve dhe studiuesish të gjitha shkencave dhe pa ba as ma të voglin dallim.

Në brumin e traditës patriotike, kulturore dhe artistike tani zunë të ngjesheshin dituri bashkëkohore të fituara gjatë këtyre studimeve, duke e kthyer Kuvendin Françeskan të Shkodrës në kulmet ma të nalta të zhvillimit kulturor.

Atë Fishta, në atë kohë drejtori i revistës" Hylli i Drites", kishte fillu me pasë problem me shëndetin (në fakt një vit më vonë ai vdiq), dhe kështu në vitin 1939 ja besoi këtë detyrë Atë Gjonit, të cilin e vlerësonte shumë.

Me humorin e tij karakteristik ai i shkruante drejtorit të ri: *"Po ta la ty "Hyllin e Drites" e Gomarin ta kam lanë lidhë për derë të shtypshkronjës. Ban ti çka të duesh me të" (ishte fjala për pjesën e dytë të veprës së Fishtës:"Gomari i Babatasit").*

Në drejtimin e" Hyllit të Dritës" aftësia e Patër Gjonit spikat shkëlqyeshem. Shpejt revista u kthy në një forum kombëtar me pjesmarrjen e personaliteteve të shquara të kulturës, si E. Çabej, K. Prela, N. Ndoja, F. Alkaj, P. Kacinari, K. Naraçi etj

Në vitin 1940 detyrohet të ndërpresë punën, mbasi informohet se autoritet fashiste donin ta arrestonin. Kështu françeskanët bënë të mundur që ai të arratisej në Jugosllavi prej ku do kalonte në Austri për të vazhdu studimet pasuniversitare në filologji indo-evropiane, një sugjerim ky nga miku i tij Eqrem Çabej. Por, pas disa muajsh rikthehet edhe një herë në drejtimin e revistës. Revista nisi të fitonte përsëri frekuentimin kulturor të larmishëm dhe nuk ra kurrë në pozitat politike të rregjimit.

Nga takimet e shumta që zhvilloheshin tek françeskanët duhen përmendur ato me profesor Kolë Prelën. Megjithëse bazat filozofike të tyre ishin antipodike *(idealiste ato të Patër Gjonit dhe materialiste ato të Prof. Prelës)* raportet mes tyre ishin mes një respekti reciprok dhe tolerance të ndersjelltë. Prof. K.Prela u zgjodh deputet në Kuvendin Popullor, por kjo nuk e pengoi atë të dilte para gjykatësve si i vetmi dëshmitar në mbrojtje të mikut tij, Atë Gjon Shllakut. Aty profesori konfondoi me argument të parrëzueshme akuzat e rrejshme të trupit gjykues. Ky gjest i kushtoi atij shtrejt, mbasi humbi mandatin e deputetit, mbrapa u burgos dhe u dënua me vdekje. Kjo është një tjetër histori tragjike për të cilën duhet folur.

Në vitin 1945, një grup intelektualesh shkodranë përmes një

konference shpallën krijimin e Shtëpisë Kulturës në Shkodër. Patër Gjoni u zgjodh Kryetar Nderi. Ai mbajti një fjalim që mbeti i paharruar për auditorin. Foli me gjithë shpirt për prespektivat, për zhvillimin e kulturës, ekonomisë, etj. tashmë në një Shqipëri të lirë e të pavarur. Por fjalët e tij nuk i pëlqyen forcave të errta që merrnin udhëzime nga përfaqësuesit e Beogradit e Moskës. Siç dëshmuan në vijim ato kërkonin të shtypnin që në lindje çdo inisiative liridashëse, kulturore e demokratike .

Një ditë të ftohet dimri të viti 1946, kur Atë Gjoni kishte hy në klasë dhe po përgatitej të fillonte mësimin erdhën dhe e arrestuan. Për ironi të fatit në mbrëmje Radio Shkodra transmetonte paturpësisht, se: "*U arrestua armiku popullit, Atë Gjon Shllaku, në tentativë për t'u arratisur nëpër kufi".*

Një mëngjez të vrejtur më 4 mars, zemrat e shkodranëve u dridhën kur dëgjuan të shtëna mitralozi që vinin nga Zalli Kirit. E vërteta ishte tragjike. Atë Gjoni me të tjerë të pafajshëm kishin rënë nën plumbat e skuadrës së pushkatimit.

U shua një shqiptar i vërtete, një demokrat, një intelektual i pazëvendsueshem, një njeri i ndershëm faji i vetëm i të cilit ishte se e deshi Atdheun dhe se u përpoq për liri e demokraci.

Krishti në darkën e mbrame, duke i ofruar verën Apostujve të vet, pati thënë:

"Ky është gjaku im i derdhur për ju e për të gjithë, për alencën tonë të re e të përjetshme"

Këto fjalë që Padër Gjoni kushedi sa herë i ka përsëritur në meshët e tija të përditëshme, le të jenë edhe testamenti që ai u len shqiptarëve të rinj, që ato të çojnë gjithnjë përpara lirinë e demokracinë e fitueme me gjak.

KËNGË PËR GJIN PJETËR PERVIZIN

Në tokë të Kurbinit lshon kushtrim,
Njaj Gjin Pjetri i urtë e trim,

* * *

Ai Gjin Pjetri ç'ka ka thanë,
Një besë kam dhe ia kam dhanë.
Gjithë Kurbinit e Vogjilisë,
Me ia rritë nderen Shqipnisë.
E ju burra gjithë sa jini,
C'ka falë Zoti hani e pini.
Nesër herët tre djelm të ri,
Shëndosh ju qesin der n'kufi.
Në mbarë Kurbinin ka que fjalë,
Të rrokim armët burrë dhe djalë.
Kush lirinë don me e fitue,
T'vijë mbas meje me luftue,
ujku shpejt ka me na msy,
Burra besën mos me thy.
N'kodra t'Zhejes për nën kishë,
Janë struk pritat porsi bishë,
Prin Gjin Pjetri, Llesh Bib Brozi,
Nikoll Ndreu, Pjetër Bajlozi,
E dy Lleshat prej Miloti,
Trima tëçartun flakë baroti.
E Llesh Vathi e Zef Piroli,
Pjeter Hidri e Ndrec Sokoli,
Prend Bardhoku me djelm tjerë.
Tokës Kurbinit na i lanë nderë.

* * *

Por shqiptart n’dor smujt me i shti.
Thuj sulltanit e thuj barbarit.
Asht que n’kam kombi i shqiptarit.
Mjaft këtë tokë e ke dhunue.
Dum në liri na me jetue.
Dum atdhe e dum liri..
Dum flamurin kuq e zi.
Kur agoi e bardha dritë.
Vesh e mbath e pushk tuj qitë.
Mblidhen tok djelmt e Kurbinit,
Rreth parisë e perreth Gjinit.
E Gjin Pjetri e Bajraktari,
Ngrejn flamurin që na la i pari,
Pesqint vjet mshefun nën dhe,
Valon sot flamur mbi ne.
Se me gjak në te kem ble.
Merr valë pushka e qiftelija..
T’gjithë brohorasin rroftë Shqipnija.
Rrnoftë flamuri kuq e zi.
Mbi tokë të lirë të ksaj Shqipnije.

▪ **Përkthimi** ▪

Përkthyer nga:
Amila **GJYREZI**[1]
Domenico **REA**[2]

KOSHI I LETRAVE

Shend e verë, Luçia dhe Anamaria dolën të blejnë fletore, ditarë, lapsa, goma fshirëse e kuti lapsash. Mbas pak ditësh do të fillonin të ndjekin liceun. Ndjeheshin dy studente, dy zonjusha. E me këtë mendim, duke kujtuar mësimet e edukatës qytetare, vendosën si qytetare të rregullta ta hedhin kupën e akullores që kishin ngrënë në njërën nga

[1] *Amila Gjyrezi lind në Shkodër më 14 Mars 1977. Është diplomuar në Universiteti i Studimeve të Siena, Fakulteti i Letërsisë dhe Filozofisë, Siena, Itali. Që nga viti 2004 mban titullin Doktoreshë në Ruajtjen e Pasurive Kulturore historike, artistike dhe arkitektonike. Fushat e saj të ekspertizës janë art, trashëgimi kulturore, turizëm, si dhe perkthim i teksteve italisht –shqip dhe shqip-italisht, në të cilat ka kontribuar për më shumë së një dekadë. Bashkëpunëtore në organizimin e ekspozitave të artit: "I Castica", "Piero della Francesca" në Arezzo(Toskana, Itali). Ajo ka një karrierë të pasur si drejtuese dhe eksperte në Drejtorinë e Kulturës dhe Turizmit në Bashkinë e Arezzo në lidhje me promovimin e territorit të Toscanës me kulturën dhe traditat. Ka marrëpjesë në shumë kurse formimi me tematika: trashëgimi kulturore, art, muzeografi, turizëm kulturor, agro-turizëm dhe në promovimin e territorit të Toskanës (Itali). Ka eksperiencë në mësimdhënie në lendët e Letërsisë Italiane, Gramatikë, Historisë, Historisë të Artit, Historisë së Turizmit dhe Kulturës Turistike; në përfshirjen e te rinjve në kurse per rivleresimin e Trashëgimise Kulturore.*
A.Gjyrezi ka mbledhur dhe perkthyer "Antologji me tregime Italiane", botimet Camaj-Pipa, 2011.

[2] *Domenico Rea, autor napolitan, lindur më 1921, me një karrierë të gjatë në fushën e krijimtarisë, kryesisht të prozës së shkurtë, dhe i vlerësuar me çmime të ndyshme letrare. sidomos Është konsideruar si njëri nga shkrimtarët më të njohur të asaj radhe të rinjsh jugorë që ndiqnin rrugën e hapur nga Giuseppe Marotta.*

koshat e shumta të letrave nëpër rrugë, që profesori i kishte siguruar se do i gjenin, nëpër qytetet moderne e të qytetëruara, në çdo 200 metra.

Duke patur besim të plotë në Napolin e tyre të madh, dy vajzat i përshkuan më kot metrat e para. Kaluan distancën e 200 e 300 metrave, por nuk takuan në asnjë objekt të rrugës që t'i ngjante një koshi letrash. Të ndrojtura e të guximshme, ashtu siç mund të jenë dy vajza në lulen e rinisë, iu drejtuan një polici rrugor dhe e pyetën se ku mund të gjenin një kosh letrash. Polici, që s'e priste fare një pyetje të tillë, i pa si ai zogu i pulës që trembet nga këmijtë. Luçia dhe Anamaria, pak të lodhura, vazhduan të ecin, arritën në sheshin Trieste e Trento – që i famshmi komandant Lauro[3] donte t'a shndërronte në kafaz zogjsh e që mbeti e shëmtuar nga një çezmë me tuf gëlqeror (një lloj guri), dhuruar po nga ai, e vlefshme vetëm për t'i stërpik ujë fatkeqëve, në atë vend në mëshirë të erës së detit- ku shikojnë e kontrollojnë përreth dhe të zemëruara nga që nuk gjejnë asgjë vazhdojnë të ecin. Kalojnë rrugën Karolina, rrugën Kiaia, sheshin Santa Katerina, të sigurta tashmë se në rrugën Filanxheri – salloni i Napolit - do të jetë edhe një kosh letrash.

Përshkojnë rrugën me hapa të ngadalshme e të dëshpëruara dhe ja që pikërisht atëherë kur ishin gati të hidhnin përtokë dy kupat prej letre, u del para, pranë Rampe Brankaçios, objekti misterioz.

Me vrap i shkojnë pranë, e shikojnë dhe e studiojnë me gëzim të madh. Besimi i tyre ishte shpërblyer e së bashku hodhën në kosh letrat që, për fat të keq, ranë mbi këmbët e tyre.

Koshi i letrave ishte pa fund ! e instrumentalizimit të letërsisë nga ideologjia politike. Ka më shumë mundësi t'i rezistojë kohës poezia e të dy periudhave, që përshkohet nga motivet universale dhe metafizike, poezi në të cilën shprehet bota e vërtetë dhe mjeshtëria poetike e autorit.

[3] *Lauro = Akile Lauro –Qiradhënës anijesh dhe person politik. Kryetar Bashkie në Napoli nga 1951-1955.*

Bibliografia:

Agolli, D. Fletorka e mesnatës. Tiranë, 1998.
Agolli, D. Poezi, Tiranë, 1979.
Agolli, D. Udhëtoj i menduar. Vepra letrare 11. Tiranë, 1987.
Agolli, D. Pelegrini i vonuar. Tiranë, 1993.
Agolli, D. Lypësi i kohës. Tiranë, 1995.
Agolli, Dritëro. Lutjet e kembanës. Tiranë, 1998.
Agolli, D. Jeta në letërsi. Tiranë 1987.
Aliu, Ali. Don Kishoti shqiptar. Toena, Tiranë, 2010.
Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist. Tiranë, 1978.
Kadare, I. Autobiografi e popullit të vargje. Tiranë, 1971.
Kadare I. Vepra letrare 1. Tiranë, 1981.
Kuçuku, Bashkim. Pas eklipsi letrar. Tiranë, 2014.
Lëngu, I. "Imazhi poetik dhe disa veçori të tij te Agolli, Arapi, Spahiu". "Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare". Prishtinë, 2005.
Selmani, Ahmet. Bashkëbiseduesit e mi. Tetovë, 2001.
Sinani, Sh. "Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit". Tiranë, 2010
Sinani, Sh. "Mitet dhe demonët e letërsisë së realizmit socialist". Letërsia shqiptare e realizmit socialist. Studime albanologjike. Universiteti i Tiranës, viti XV, 2010/2.
Vinca, A. Alternativa letrare shqiptare. Shkup, 1995.
Zisi, R. Letërsia bashkëkohore shqipe-poezia. Tiranë, 2008.

Achille **CAMPANILE**[1]

PANTOMIMË

E bukura Anxhelika Ribaudi, me flokët e saj të verdha të shpupurishura dhe mollëzat e freskëta të faqeve të skuqura të një tetëmbëdhjetë vjeçareje, duke gulçuar nga që i kishte ngjitur shkallët katër e nga katër, ndali për një çast në kryeshkallë për t'u qetësuar, pastaj futi ngadalë çelësin në bravë, e rrotulloi lehtë, e shtyu derën pa bërë zhurmë dhe hyri vjedhurazi në shtëpi si një hajdute.

Donte të arrinte para nënës së saj, që ia kishte zënë syri në fund të rrugës duke zbritur nga trami. Nuk e shqetësonte idea se do vonohej për darkë, por duke ardhur sëpaku një herë më pak vonë se zakonisht, mund të shmangte qortimet e frazat e hidhura të nënës e ndoshta do t'a bënte të besojë se kishte ardhur shumë kohë më parë. Nuk i kishte ndodhur kurrë që të kthehej në shtëpi kur nëna nuk kishte ardhur akoma. Kaloi korridorin duke ecur në majë të gishtave. Ndali për një çast para dhomës të të atit, pa marrë frymë, e shtyu edhe më derën gjysmë të hapur, shikoi brënda e u mbush me frymë : dhoma ishte e errët. I ati nuk kishte ardhur akoma. Përsa i përket vëllezërve, nuk rrezikonin të vinin në shtëpi para se të zbardhte dita. Dhe gruaja e shërbimit, gjithmonë e mbyllur në kuzhinë, nuk e merrte vesh asnjëherë se kush hynte e kush dilte dhe çfarë ndodhte në atë shtëpi të madhe.

Anxhelika u mbyll në dhomën e saj. U zhvesh shpejt e shpejt pa e ndezur dritën, hodhi në trup një rrobë dhome (rrobëdëshambër) dhe në errësirë shkoi e u shtri në shtrat, sepse donte që familiarët, kur të vinin

[1] *Gazetar, shkrimtar, komediograf, ka lindur më 1900. Ka bashkëpunuar në gazeta e periodikë të ndryshëm italianë kryesisht të karakterit kulturor. Eshtë cilësuar si shkrimtar humorist, dhe si i tillë është autor i mjaft komedive të shkurta, emisioneve televizive, por edhe studiues dhe kritik letrar i gjinisë së humorit. Vdiq më 1977 në Romë.*

në shtëpi, t'a gjenin kështu e të mendonin se kishte qenë në shtëpi prej kohësh. E ndërkohë po përgjonte se mos dëgjojë nga njëri çast në tjetrin rrotullimin e çelësit në derën e shtëpisë dhe hapat e nënës së saj që po hynte, zërin e saj që pyeste gruan e shërbimit :

"A është kthyer zonjusha ?" dhe gruan e shërbimit që do të përgjigjej: "Jo akoma".

Nënën që pasi të ankohej për vonesat e vazhdueshme të saj, do të vinte t'a gjente në dhomë duke fjetur. Së paku nganjëherë, një fitore të vogël. Por s'po dëgjohej asgjë.

Zonja akoma rinore dhe tërheqëse Iride Ribaudi, me flokët pak të shpupuritura e duke gulçuar nga ngjitja e shpejtë e shkallëve, e futi ngadalë çelësin në bravë, e rrotulloi lehtë, shtyu derën pa bërë zhurmë dhe hyri fshehurazi në shtëpi si një hajdute. Deshi të vinte para të shoqit që ia kishte zënë syri në fund të rrugës. Kaloi korridorin duke ecur në majë të gishtave. Kur po kalonte para dhomës të së bijës, u mbush me frymë. Dhoma ishte e errët dhe e heshtur. Anxhelika nuk ishte kthyer akoma. Jo se duhej të justifikohej. Por në disa raste është e mërzitshme dëshmia e fëmijëve,dhe, pastaj (e sidomos) ,e një vajze si Anxhelika!

Zonja Iride u ndry në dhomën e saj, u zhvesh shpejt e shpejt pa e ndezur dritën, hodhi në trup një rrobë dhome (rrobëdëshambë), dhe në errësirë shkoi e u shtri në shtrat, sepse donte që familiarët, kur të vinin në shtëpi, të besonin se ajo kishte qenë në shtëpi prej kohësh.

Xhiovani Ribaudi, gulçues nga ngjitja me shpejtësi e shkallëve, e futi ngadalë çelësin në bravë, e rrotulloi lehtë, e shtyu derën pa bërë zhurmë dhe hyri vjedhurazi si një hajdut. Donte që familiarët të mos e vënë re që ai po vinte kaq vonë në shtëpi. Shtëpia ishte e madhe dhe me ndonjë finokëri mund t'i bëjë bisht të gjithëve. Kaloi korridorin duke ecur në majë të gishtave, ndaloi për një çast e si ndjeu një heshtje të plotë, u mbush me frymë. Gratë po flinin.

Pas pak, dëgjoi zërin e gruas së tij që po e pyeste gruan e shërbimit :

"A është kthyer zotëria ?".

"Jo, zonjë" - tha gruaja e shërbimit.

"Kush është në shtëpi ?"

"Asnjeri."

Xhiovani doli në derën e dhomës së tij. "Po, e dashur" – tha - jam këtu që prej një ore. Meqë të gjeta duke fjetur s'desha të të zgjoj."

"E po -tha zonja Iride- kam ardhë në shtëpi që prej dy orësh, e meqë s'kishte njeri në shtëpi, desha të pushoj pak."

Pastaj shtoi me një psherëtimë:
“Anxhelika s’është kthyer akoma?”.
Gënjeshtra, mendoi Anxhelika, që sa s’po qante nga marazi.
Por në atë çast i ati hapi derën e dhomës së Anxhelikas.
“Është këtu”- bërtiti.
“Oh” -thirri zonja Iride- nuk e dinja.”
Anxhelika bëri sikur po zgjohej.
“Nuk dola fare- tha- fjeta tërë mbasditën.”
Hëngrën darkë në heshtje.

Eugenio **MONTALE** [1]

ARMIQTË E ZOTËRI FUKSIT

Prej shumë kohësh isha i impresionuar nga "armiqt e zotëri Fuksit"[2]. Nuk i njihnja por ai më fliste shpesh për ta: armiq të shoqërisë së lartë, të fuqishëm, armiq të errët, shumë të përunjur, burra e gra, si mund të urrenin atë monumenttë respektueshmërisë, të fenomen diturie, atë studjues të çinteresuar të snobizmit që ishte zotëri Fuksi ? I gjatë, i dobët, varfërisht i veshur, me mustaqe të gjata të verdha të varura mbi gojën e babëzitur, zotëri Fuksi, njeri që fliste shumë gjuhë, me moshë e prejardhje të panjohur, ishte shumë i njohur në rrethet mondane e intelektuale, në Itali e gjetkë. Pa para si tërë poetët e vërtetë (sepse i tillë konsiderohej megjithse ai nuk shkruante vargje) profesioni kryesor i tij ishte Mik, mik i pritur si mik, që do të thotë jo mikpritës (që nuk pret miq). Kërkonte familje të pasura e mundësisht fisnike që i vinin në dispozicion një dhomë dhe dy të ngrëna në ditë në një kështjellë mbi lumin Loira[3], në një kullë në Vosgi[4], në një vilë në San Sebastiano[5] dhe në një apartament dosido të Firenzes, të Venedikut, të Milanos. Kërkon e gjen ,ose më mirë gjente, por mbas dy luftrash të mëdhatë pasurit ia shitën kështjellat e tyre shtetit dhe mekanizmi i patronazhit (mecenatizmit) erdhi gjithmonë e duke u rralluar. Ndodhi kështu që edhe

---

[1] *Poet e kritik lindi në Genova (Xhenova) më 12 tetor 1896. Hapat e para të karrierës ishnin në fushën e muzikës, si këngëtar lirik dhe kritik muzike. Ishte fitues i çmimin Feltrinelli, senator i përjetshëm dhe fitues çmimit Nobel për letërsi në vitin 1975. Ishte njëri nga personalitet e shquara në fushën e kritikës letrare, por edhe poet dhe prozator i shquar. Vdiq në Milano më 1981*

[2] *Fuks (Fuchs) =mbiemër gjerman. Ka kuptimin "dhelpër"*

[3] *Loira=lumi më i gjatë në Francë(1.010 km.).*

[4] *Vosgi=vargmali 250 km. që ndan Alsasën nga Lorena(në Francë).*

[5] *San Sebastiano=qytet në Spanjë.Dikur residencë verore luksoze.*

njeriut shumë të çmuar Fuks, iu desh që nganjëherë të vendoset nëpër hotele të dorës së fundit, ku e gatuante vetë ushqimin e përditshëm në një furnelë të vogël me alkol. Menuja e tij e përditshme ishte një quatuor, një kuartet (Fuksi zakonisht shprehej në frëngjisht), për shembull, një copë e vogël mishi (qengji) ,dy panxharë të kuq të zier, një copëz djathë dhe dy dardha, një gjellë që juve dhe mua do na dukej diçka e dobët (e varfër), për atë një muzikë e denjë e Mozartit. E s'kalonte ditë që mos t'ia përmendte miqve të tij përbërësit (ingredientët) e kuartetit të radhës. Sepse Fuksi kishte edhe, përveç armiqve, mjaft miq të cilët duke mos patur mundësi t'a ftonin në vilë e ftonin megjithatë në qytet dhe i ofronin dreka më të mira se të tijat, megjithse injoronin rregullat e kuartetit. Ai ishte mjeshtër në artin për të bindurata që e ftonin se me këtë i bënin një nder të madh vetes së tyre. Në këtë grackë ranë të gjithë dhe rashë edhe unë. Për disa muaj isha miku i tij dhe e ftova më shumë se një herë, në shtëpi ose në restorant, i joshur nga shpirti i tij dhe gjallëria e bisedës së tij. Pastaj një ditë miqësia e jonë mori fund në mënyrë pothuaj tragjike dhe unë zbulova të fshehtën (misterin) që më pasiononte. Ishte një dimër i ftohtë, në Firenze, pak pas çlirimit (mbas Luftës së Dytë Botëro-

re). Nuk gjendej qymyr ose (s'më kujtohet) bashkëbanorët e mi s'mund t'a blinin. Unë ngrohesha me një furnelë elektrike me katër spirale ("elementë") që i ndiznja dy e nga dy. Po drekonim me Fuksin kur ai papritmas tregoi një farë shqetësimi për nxehtësinë e tepruar. U ngrita dhe i fika dy spiralet që ai i shihte të tepërt. Pak më vonë Fuksi i hoqi mustaqet nga kofsha e qengjit (mrekulli e tregut të zi) që po kafshonte për të më thënë se ngriu nga të ftohtit. Brofa në këmbë duke kërkuar të falur dhe e ndeza furnelën me të katër spirale.

S'kaloi as një minutë që zotëri Fuksi të shprehë mendimin se tre e jo dy apo katër spirale do të kishin krijuar klimën më të volitshme për të biseduar.

"Më vjen keq" i thashë "që s'mund të të kënaq për këtë sepse furnela e ime funksionon me dy ose katër spirale dhe tjetër furnelë nuk kam."

Vazhduam të bisedonim,unë ngrihesha herë pas here për të hapur e mbyllur dy çelësat por dukej sheshit se zotëri Fuksi ishte i fyer dhe kishte pak besim në aftësinë time si fokist. Së fundi u ngrit ai vetë, u përkul mbi furnelë, u rrek për njëfarë kohe duke i rrotulluar disa herë çelësat sa andej këndej, gjersa furnela u fik përfundimisht me një fërshëllimë të gjatë.

“Me sa duket e prisha furnelën”- tha- duke i ngritur mustaqet nga spiralet akoma të nxehta.

“Të shpresojmë se jo” -i thashë - por sidoqoftë nuk ka rëndësi. Do t’a përfundojmë bisedën tonë në një kafene që ka ngrohje të mirë.”

Dukej tmerrësisht i zemëruar.

“Janë dy raste –tha- ose e kam prishur unë ose në fakt nuk është prishur dhe ti duhet t’a shohësh e t’a vësh në funksionim. S’di ta bësh ?”

(E provova nja dy herë por pa rezultat.) “A e sheh : do të thotë se furnela nuk punon

dhe atë e kam prishur unë.”

“Mos i jep rëndësi- i thashë - do t’i ketë rënë ndonjë sigurecë. Nganjëherë më ka

ndodhur edhe mua.”

“Ç’do të thuash me këtë ?-tha zotëri Fuksi. Edhe ty të paska ndodhur ? Me këtë

do të thuash se këtë herë e kam prishur unë.”

“Unë nuk thashë gjë, zotëri Fuks- i thashë- Furnela nuk punon, faji është i imi sepse nuk kam marrë një furnelë më të mirë se kjo. Dëmi është i vogël dhe deri nesër do të jetë e rregulluar.”

“Ju i komplikoni gjërat duke e treguar veten fajtor, por në fakt them se fajtori jam

unë. Dua të theksoj se fjala faj është e tepruar.”

“E theksova dhe kërkoj të falur, por e kisha fjalën për mua, jo për ju.”

“Përderisa kjo gjë nuk është sqaruar fjala më prek edhe mua. Hyra si një i ftuar e po

dal si një fajtor. Dua të shtoj se rënia e dokeve dhe zakoneve është me të vërtetë e pandreqshme. Kur theva pasqyrën e princeshës Thurn und Taxis ajo e hoqi nga puna

kamerierin dhe pasqyra u zëvëndësua menjëherë. Edhe atëherë isha fajtor, sot çeshtja

është në duar të gjykatësit(i kalon gjyqit). Mos u ripafshim”.

Me një përkulje të lehtë shkoi drejt derës. U mundova t’a ndaloj por më kot. Qe e pamundur çdo përpjekje për pajtim. Pa dashur, pa e ditur, u regjistrova edhe unë në morinë (legjionin) gjithmonë në rritje të armiqve të tij. U ndjeva mirë duke menduar se ndoshta isha më i dobishëm kështu.

Stefano **BENNI**[1]

TABELA "BAR SPORT"

Tabela "Bar Sport" është vërtet e çuditshme. Shkronjat ndizen me ndërprerje, vibrojnë si një raketë në nisje dhe –kur funksionon– i shkakton dëme të mëdha impianteve elektrike, që ndodhen aty afër. Me pak fjalë, është e pakontrollueshme dhe, për më shumë, e pandjeshme ndaj çdo riparimi që i bëhet.

Tabela "BAR SPORT" ishte shumë e bukur , dhe pronari i barit, Antonio i thirrur Onassis[2], e kishte paguar 60 mijë lire në vitin 1965. Atë ditë ishte e hënë. Një ditë më përpara elektriçisti ishte nisur për të parë ndeshjen Bologna – Firenze, me motorçikletë. Afër një vendi të quajtur Pian del Voglio[3] kishte hasur në një stuhi bore dhe pas pak kilometrash nga të ftohtit iu bllokuan të dy krahët.

Nuk donte të hiqte dorë dhe vazhdoi rrugën, duke i bërë kthesat me ndihmën e peshës së kokës. Duke qenë se kishte një kokë shumë të madhe dhe të ekuilibruar mundi të bënte deri në 86 km., pastaj në një galeri, goditi kokën në mur dhe ra bashkë me motorr nga një urë. Mundi të dëgjonte ndeshjen nga një radio e vogël mbi një pemë lisi dhe pastaj i telefonoi zjarrfikësve.

Të hënën kishte një dhimbje të fortë koke, dhe 39 temperaturë. Kështu që për të montuar tabelën erdhi djali i Amosit(elektiçistit), i quajtur Sugerone sepse kishte kokën më të madhe se i ati, por më bosh

[1] *Lindi në Bologna në vitin 1947. Është shkrimtar i shumë romaneve dhe tregimeve të suksesshëm. Romanet dhe tregimet e tij përmbajnë një satirë të fortë të shoqërisë italiane bashkëkohore. Stili i shkrimit të tij është karakteristik dhe plot me lojëra fjalësh. Ai mbështetet edhe në stile letrarë të huaja*

[2] *Onassis: emër i një miliarderi të famshëm grek.*

[3] *Pian del Voglio: vend në Appennino, ndërmjet Bolonjës dhe Firences.*

brenda.

Sugerone erdhi tek bari dhe tha: e rregulloj unë. Mori një kaçavidë dhe montoi shkronjën B. Menjëherë semafori aty afër filloi të bënte zhurmë dhe pas pak ra në tokë copa copa. Në të njëjtën kohë u dogj televisori dhe makina e kafes vezullonte një dritë jeshile. Atëherë Sugerone mori një tel dhe e futi në xhep, pastaj këputi dy ose tre rezistenca dhe montoi shkronjën A. Në mesditë kishte montuar krejt fjalën BAR; zbriti nga shkalla dhe shkoi për të ngrënë. Në këtë kohë shkronja B filloi të dridhej dhe ra vertikalisht duke lënë pas një rrymë neoni blu. Shkronjat A dhe R u afruan me njëra tjetrën. Në atë kohë në të gjithë televizorët e pallatit iku figura. Sugerone u kthye dhe tha se kishte një kontakt. Hipi në shkallë, por ngaqë ishte rënduar nga të ngrënit, ra, duke tërhequr me vete disa metra teli, aq sa trolejbusi u gjet i varur në ajër. Në orën katër e gjysëm montoi BAR PSOTR, me tre shkronja që punonin me ndërprerje dhe me dy të djegura. Në orën shtatë montoi BRA SPORKT, dhe megjithëse këmbëngulte që K nuk dukej keq, iu desht të smontonte gjithçka. Në darkë montoi një BAR SPORT që u ndez mirë, por nga Bashkia morën në telefon për arsye se ndriçimi në tangjenciale nga një orë ishte me ndërprerje dhe ishin shkaktuar tetëdhjetë përplasje me makina. Atëherë Sugerone tërheqi edhe tre tela të tjerë dhe simboli u fik. Në orën tre të natës më në fund simboli ishte komplet, pa efekte të njëanshëm. Të gjithë shkuan të flinin dhe simboli u fik prapë. Për një muaj fikej rregullisht në shtatë e gjysëm, për tu ndezur kur zbardhte dita. Bovinelli, kështu quhej një burrë që dinte të bënte ghithçka dhe fuste hundën në gjërat e të tjerëve, erdhi fill pas nisjes së Sugherones për të rregulluar simbolin dhe iu desh të hiqte dorë; dhe të gjithë elektriçistët e tjerë të interesuar thanë që ishte një rast misterioz dhe i paspjegueshëm. Thirrën edhe një elektriçist shumë të zoti gjerman, Frannenberg, i cili kishte drejtuar punën për ndriçimin e Reichstag[4], dhe e konsideronin një artist. Frannenberg qëndroi tre ditë dhe tre netë duke kontrolluar telat dhe çelësat elektrik. Ditën e katërt ngreu kokën dhe tha "Ëas is knupf", që do të thotë "Këtu është një rrëmujë e madhe", pastroi duart në tutat që kishte veshur dhe iku, duke treguar një faturë prej tetëmijë markash.

Sipas këshillës së gruas, Antonio thirri një shtrigë nga Termoli[5] ,që ishte eksperte në vizat që formohen në televizor. Shtriga kaloi tre herë

[4] *Reichstag: pallati i qeverisë gjermane para luftës së Dytë botërore.*
[5] *Termoli: vend në Molise.*

lavjerrësin mbi tabelë, bëri një kërcim dhe më vonë tha se duhet të prisnin mesnatën dhe të hidhnin ujë dhe vaj të bekuar mbi simbol, duke patur kujdes që të linin një kamion të kuq plot me djathë parmixhan njëqind hapa larg. Në mesnatë hodhën ujë dhe të gjithë ishin të gëzuar: mrekullisht simboli u ndez, ndërsa shtriga me kamionin plot me djathë ndodhej në autostradë drejt Peskarës.

Simboli funksionoi një muaj me këtë orar: ora 5-7: BR SPT. La A e la OR ndezeshin në orën shtatë e një çerek, kur fikeshin të tjerat. Nga ora 7 në orën 8 rrinte e ndezur vetëm Bja; pastaj dy orë komplet errësirë. Nga ora 10, ndezje me ndërprerje të dy Rve, në bojërozë dhe në vjollcë. Në orën 11, simboli u ndizte, por lexohej mbrapsht. Pastaj një orë BAR ORT. Derisa një ditë një klient i barit solli një kushëririn e tij siçilian, i cili ishte bërë miliarder në Amerikë duke u marrë me gjuajtje me grushta ndaj sendeve elektroshtëpiake. Kushëriri pau simbolin, pështyu në duar dhe ia futi me grusht shkronjës B: simboli(tabela) filloi të ndizej rregullisht. I gjithë bari rrahu shplakë: mblodhën disa para me kapele, por siçiliani nuk i pranoi. Tre muaj më vonë erdhi nga Chicago Magic Kick[6], një faturë prej një mijë dollarësh.

[6] *Chicago Magic Kick: Grushti magjik i Çikagos.*

▪ **Intervista** ▪

Enia **MATISHI**

"*EMIRA*", E SHKRIMTARIT ARBËRESH FRANÇESK ANTON SANTORI, NË SKENË NGA STUDENTËT E UNIVERSITETIT "*LUIGJ GURAKUQI*".

Intervistë me pedagogun dr. Gëzim Puka

Në kuadër të 200 vjetorit të lindjes së shkrimtarit arbëresh Françesk Anton Santori, Gëzim Puka, profesor i lëndës "Letërsi e vjetër shqipe" të degës Gjuhë shqipe-Letërsi dhe "Kritikë letrare dhe arti" të degës Gazetari-Komunikim të universitetit "Luigj Gurakuqi", së fundmi, ka vënë në skenë një fragment nga drama "Emira" e këtij autori, njëkohësisht dhe dramë e parë e letërsisë shqipe. Shkruar më 1885, me një tematikë interesante dhe ndërtekstualitet të ritualit folklorik arbëresh, ajo rreket të sjellë marrëdhënie, zakone e norma morale që vepronin në mjediset shqiptare të fshatrave arbëreshe të Italisë së Jugut.

1. ***Si fillim, si lindi ideja e vënies në skenë të një fragmenti nga drama "Emira" e Santorit?***

"Emira" e Santorit konsiderohet e para dramë me strukturë të rregullt në historinë e kësaj gjinie në letërsinë shqipe. Siç dihet, drama është një tekst letrar që e nënkupton shfaqjen në skenë, prandaj pjesë e këtij teksti parashikohet të bëhen edhe elementet e tjera, që e mbushin me emocion këtë krijim letrar, i cili më pas prodhon spektaklin. Tekstura skenike rishkruhet përmes elementëve të skenografisë, muzikës, kostumeve, koreografisë, etj. Pa dashur të bëjmë shumë histori, rrugëtimi i shfaqjeve teatrore ka ndjekur rrugëtimin e prodhimit dramatik shqip që në fillimet e tij. Meqë këtë tekst e studiojmë në historinë e letërsisë shqipe, pse të mos përpiqemi t'i japim edhe një jetë skenike. Në këtë mënyrë më lindi ideja dhe zgjodha atë fragment që u shfaq.

2. ***Çfarë ju frymëzon për të tilla aktivitete artistike?***

Kam qenë gjithmonë i apasionuar pas teatrit. Në fëmijërinë dhe rininë time kam pasur rastin të interpretoj në disa role në teatrin "Migjeni". Gjithashtu kam ndjekur edhe një kurs për regji në fund të viteve 80 me mjeshtra të skenës, si: Serafin Fanko, Tinka Kurti, Elez Kadrija, Viktor Bruçeti, Bep Shiroka etj. Debutimi i fundit në skenë ka qenë në vitin 1994 me dramën "Çmurosja" të S. Fankos, e cila i mori të gjitha çmimet e mundshme në festivalin mbarëkombëtar teatror të atij viti. Kjo përvojë e ka mbajtur gjithmonë të ndezur pasionin për këtë lloj arti që është aq i afërt me artin e fjalës, me letërsinë.

3. ***Duke qenë dhe drama e parë shqipe, ishte e vështirë gjetja e teksteve?***

Në fakt, kjo dramë njohu një botim të plotë dygjuhësh me rastin e 100-vjetorit të vdekjes së Françesk Anton Santorit dhe këtë botim e kam prej vitesh në bibliotekën time. Disa vjet më parë, kur festonim 100-vjetorin e themelimit të shtetit shqiptar, pata propozuar në këshillin artistik të Bashkisë së Shkodrës që teatri "Migjeni", një nga më të rëndësishmit në Shqipëri, ta kishte "Emirën" në repertorin e atij viti, sepse shihja dhe vazhdoj të vërej në atë tekst disa lidhje të qenësishme aktualizuese.

Duke qenë se tekstura skenike luan me dy elemente: "këtu" dhe "tani", e gjej me vend të shprehem se këtu në Shkodër, ku ka lindur teatri shqiptar, si dhe tani në këto vite kur entiteti ynë kombëtar vijon

të jetë i nëpërkëmbur, “Emira” e Santorit, veçse i bën mirë erërave të ëmbla, apo këtij flladi atdhesie, që arbëreshët matanë detit, ditën aq mirë ta sillnin edhe në brigjet tona.

4. ***Fragmenti i përzgjedhur na kthen pas në kohë, në një dasmë tipike arbëreshe, në Shën Katerinë të Kalabrisë. Përse pikërisht ky fragment? Cili ishte mesazhi që synonte drama?***

Premisa dramatike është një term që tenton të përmbledhë në një të vetme disa kategori teorike të dramaturgjisë, si: temën, idetë, mesazhet, qëllimet e autorit. Premisa më duket se në rastin e “Emirës”, na çon drejt një koherence që ky tekst dramatik e ka ruajtur me fanatizëm. Premisa e krenarisë kombëtare, është ajo që lidh të gjitha elementet e sipërcituara dhe natyrisht nuk mund t’i mohohet edhe gjetja skenike e një personazhi, siç është kori, i përcaktuar si vallja. Edhe studiuesit e dramës së Santorit e kanë vërejtur se ai ka një ndikim nga dramaturgjia antike, ku kemi një prani të madhe të korit. Autori e ka parë korin si në lashtësinë e tragjedisë, një grup valltarësh dhe këngëtarësh të mbledhur për të festuar gëzimet dhe haretë e jetës nëpërmjet valleve dhe këngëve të tyre. Tek “Emira”, vallja paraqet zërin e personalitetit kolektiv duke komentuar ngjarje dhe duke interpretuar moralin e pjesës. Vallja është integruar bukur dhe mbase nuk ka një ndikim direkt tek aksioni dramatik, por funksioni i saj është vendosur si në një lirikë e këndshme. Vallja është një përpjekje për të gjallëruar shpirtin dhe për të stolisur veprimin skenik.

5. ***Po studentët, aktorët që do të interpretonin, ju desh kohë t’i zgjidhnit?***

Në fakt, kjo është përvoja e tretë teatrore me studentët tanë. Në bashkëpunim me aktoren e teatrit “Migjeni”, Merita Smaja, kemi vënë në skenë komedinë e Aristofanit “Bretkosat” në vitin 2015 dhe “Rinocerontin” e Joneskos në vitin 2017. Për këto vënie në skenë ne patëm ndjekur një procedurë audicionesh me të gjithë studentët e të gjitha programeve të studimit, për të ndezur një frymë teatrore në USH. Kjo punë na eci mbarë edhe pse ndeshëm në vështirësi të shumta, sidomos përsa i përket provave dhe kombinimit të orareve të tyre. Duhet ta dini se për të ndërtuar një shfaqje të përmasave të tilla duhen rreth tre muaj prova. Të dyja këto shfaqje që ishin të plota, besojmë se patën sukses dhe u dhanë disa herë në teatrin “Migjeni”. Më pas bëmë

një turne të shkurtër në Ulqin dhe Prizren. Për rastin e "Emirës" nuk patëm kohë për të bërë audicione dhe shfrytëzuam njohjet me studentët e programeve të studimit të Fakultetit tonë, pasi edhe veprimtaria ku inskenimi do të inkuadrohej, Konferenca Shkencore për Santorin, zhvillohej nga fakultetit ynë. Besoj se bëmë zgjedhjen e duhur, sepse në gjykimin tim ishim të suksesshëm, edhe pse shumica e studentëvë pjesëmarrës nuk kishin pasur përvoja me skenën.

6. ***Ishte diçka rastësore apo e mirëmenduar? Përse pikërisht studentë të degës Gjuhë-Letërsi dhe Gazetari-Komunikim?***

Për këtë përkujtim të Françesko Antonio Santorit, ne, disa pedagogë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore me nxitjen e një grupi studentësh të degëve tona, deshëm t'i japim udhë një nisme teatrore duke përcjellë një fragment të "Emirës" në këtë hapësirë universitare. Duke bërë një paralelizëm, më anën e këtij inskenimi të shkurtër, ne zgjodhëm studentë si trupë amatore, për t'i dhënë një nxitje trupave teatrore profesioniste, për t'ju drejtuar këtij teksti të dramës "Emira" dhe për të gjetur në të përmes zgjidhjeve të ndryshme regjisoriale krenarinë kombëtare për atë çfarë ishim, çfarë jemi dhe çfarë mund të bëhemi. Kush më mirë se studentët e dy degëve tona dinë ta bëjnë këtë.

7. ***Si ishte puna në grup, marrëdhënia mes tyre gjatë provave? Po me ju?***

Duke punuar duhet të them se kemi provuar emocione hareje, gëzimi, nervozizëm, tension, por pa grindje. Mbetej për të bërë, sidomos përsa i përket disiplinës, e cila për të sjellë produkte artistike duhet të jetë e hekurt. Duke filluar që nga respektimi i orarit, forcimit të përqëndrimit dhe vëmendjes artistike. Në fund, të gjithë e kuptuan se sa i rëndësishëm është procesi në prova, të cilat të japin sigurinë e duhur për të përballuar emocionet e shfaqjes.

8. ***Pati situata që diçka nuk shkoi mirë? Si i përjetuat ata momente?***

Siç e përmenda, fragmenti u shfaq në një hapësirë kohore në kuadër të konferencës në auditorin A3, pranë Rektoratit të USH-së dhe jo në një skenë të vërtetë. Ajo që më duket se nuk ishtë në lartësinë e duhur ishte aspekti i ndriçimit, i cili mund të ishte më funksional dhe me një ngjyrim të caktuar. Megjithatë, jam i kënaqur edhe me atë që na u ofrua.

9. ***Duke qenë se teksti i përzgjedhur nuk ishte në gjuhën standarde shqipe, ishte i vështirë të përvetësohej?***

Teksti dramatik i Santorit duhet të ndriçohet në skenën shqiptare, edhe i fragmentuar, për të dëshmuar atë këmbëngulje dhe patriotizëm qoftë edhe nën efektin e lehtë të një ironie që koha jonë e dëshmon. Aktualizimi i këtij teksti në skenën e sotme besojmë se është i mundur dhe nxit kureshtjen e lexuesit/spektator për disa arsye:

Së pari, për të njohur një vepër që është fillesë e dramës shqipe.

Së dyti, gjuha e saj që mund të kombinohet në arbërisht dhe shqip.

Së treti, aspekti tematik që përmban plagët sociale të shoqërisë arbëreshe të kohës. Ndëshkimi i së keqes të përfaqësuar nga cubat dhe fitorja e së mirës.

Së katërti, dhe në gjykimin tonë kryesori, është aspekti ritual i valles dhe semiotika e saj.

Të gjitha këto arsye të para me pak distancë regjisoriale, larg patetizmit, por të riprodhuara me një mbështjellje magjepsjeje dhe ironie të lehtë, besojmë se ”Emira” e rifton spektatorin në një reflektim të gjatë.

Me të drejtë duke përfunduar një artikull për krijimtarinë e Santorit, studiuesi F. Solano shkruan: “Së fundi, një pyetje: Përse Santori (dhe shkrimtarë të tjerë arbëreshë) shkruanin në gjuhën e nënës, nëse përpara tyre shfaqej e paepur pamundësia për të qenë të lexuar, për faktin se analfabetizmi mbretëronte në atë periudhë. Për mendimin tonë ato nuk kanë bërë gjë tjetër, përveç se kanë shprehur vullnetin këmbëngulës të qenies së tyre, të një ekzistence me plot dëshirën për jetë të një bashkësie që nuk donte dhe nuk do akoma të vdesë: loquor ergo sum (flas, pra jam)”

10. ***Ditën e shfaqjes, të pranishëm në sallë ishin shumë figura të shquara, duke përfshirë këtu edhe miq arbëreshë, të ftuar posaçërisht. Prania e tyre dhe duartrokitjet, ju bënë të ndihen mirë? I shtuan më shumë emocionet?***

Më ka bërë përshtypje pjesëmarrja e gjerë e publikut, edhe pse ishte e shtunë. Dua të shpreh kënaqësinë për fjalët e mira dhe konsideratat që dhanë për shfaqjen dy personalitete të albanologjisë, studiuesit e mirënjohur arbëreshë prof. Francesco Altimari dhe Matteo Mandala, të cilët do e veçonin fragmentin e inskenuar si një risi dhe sukses i veçantë

në konkluzionet që bënë për konferencën. Pritëm me kënaqësi edhe komplimentet nga arbëreshët e tjerë të ardhur, të cilët nuk pushonin së bëri foto me aktorët studentë. Urimet më të mira na erdhën edhe nga profesorati ynë, rektori, dekania dhe plot personalitete të tjera të kulturës së qytetit tonë.

11. ***Kjo do të thotë që orët e gjata në prova, përkushtimi si nga ana juaj, ashtu dhe nga studentët, ia vlejtën. Ndiheni krenar për zgjedhjen e bërë dhe suksesin e arritur?***

Jam i kënaqur që u shpërblye mundi i studentëve dhe organizatorëve. Shfrytëzoj rastin t'i përmend për ndihmesën që dhanë. Do të veçoj koreografin e përkushtuar Altin Golemi (mësues në shkollën "Maria Ndihmëtare"), i cili na krijoi dy valle shumë të bukura brenda spektaklit. Falenderoj prof. Paç Alimhilli për montazhin muzikor dhe operatorin e ndriçimit, Rezar Bisha. Last but not least, falenderoj studentët interpretues Sabina Shelegu, Hymerta Ura, Elsaid Lezaj, Pamela Rroku, Samena Bejtja, Malvina Tahiri, Marseda Tahiri, Donika Volej, Enisa Taramani, Nanda Taramani dhe Erind Kopliku. Mirënjohje e veçantë për dekanen e FSHSH-së, Mimoza Priku, dhe pedagogun Erzen Koperaj që ndihmuan dukshëm në realizimin e këtij inskenimi. Nuk do të ndaj nga kjo mirënjohje edhe rektorin Adem Bekteshi, i cili na ndoqi me interes gjatë ndërtimit të kësaj shfaqjeje.

12. ***Në përmbyllje të dramës, gërshetimi i traditës me modernen, ishte risia që sollët. Përse kjo "dalje nga korniza" ? Si u prit ajo nga publiku?***

Më bëri përshtypje, kur po shihja në You Tube, një spektakël të shumë viteve më parë të shkrimtarit nobelist italian Dario Fo. ***"Ci ragiono e canto"*** ("Arsyetojmë dhe këndojmë"), një shfaqje me këngë popullore. Dramaturgu kishte ndërtuar një teatër frymëzues me këngët e punës të folklorit italian, në jug e në veri. Ai montazh të tërhiqte vëmendjen dhe të jepte një kënaqësi estetike, pa përmendur mesazhin e tij të skajshëm pozitiv, që kishte të bënte me lidhjet e ndershme të njeriut me punën, si dobi universale.

Zbulimi i kuptimeve dhe ndjeshmërive tona për letërsinë e Rilindjes, shpeshherë e pluhurosur në biblioteka, nuk duhet të ndodhë vetëm në shkollë apo në auditoret tona. Letërsia ose arti i fjalës, e cila bart në përkufizimin e saj të qenët thesar i kulturës së një vendi, duhet të

trajtohet si i tillë, të vihet në vende të dukshme për t'u admiruar.

13. ***Tani destinacioni juaj i radhës mendohet të jetë Kalabria. E shihni si të realizueshëm në një kohë të afërt apo mbetet për t'u parë?***

Më sipër përmenda konsideratat që shprehën profesorët e ftuar nga Italia. Ndër të tjera ata theksuan dëshirën që kjo shfaqje të mund të udhëtojë drejt Kalabrisë. Ata u zotuan që do të shikonin me shumë kujdes një mundësi të tillë turneu drejt Italisë. Ky do të ishte një kurorëzim i bukur i një pune të bërë me zell dhe pasion nga studentët.

▪ **Reçensione** ▪

Shefqet **KELMENDI**

TANAGRA – *historia e genit dhe e gjuhës*

Të rrallë janë librat me tematikë shkencore që lexohen me andje deri në fund, si libri voluminoz *"TANAGRA – historia e genit dhe e gjuhës"*, shkrue nga Naim Laçej. Ky libër me shumë vlera, asht nji enciklopedi e vërtetë që zbardh çeshtje shkencore tejet të randësishme: nxjerr në pah genin e parë që është ruajtja, gjuhën nji-rrokëshe të homo-sapiennsit, të pellazgo-dardanëve "para hanës". Ma qartë, nanën e të gjitha gjuhëve. E që sot e flasin gegët.

E si të mos krenohemi me këtë të vërtetë të ndriçueme se geni i stërlashtë, gjuha nji-rrokëshe, edhe sot, mbas mijëvjeçarësh, asht e gjallë tek dardanët gegë, tek gegnishtja e sotme.

Asht ky studim i thellë, i shkruem bukur dhe bindshëm, bazue në afro 400 referime nga autorë të ndryshëm. E, po them që në fillim, bashkohem me dhimbjen, e shqetësimin e autorit:

"Ne shqiptarët presim që historinë e genit e të gjuhës tonë të na e shkruejnë të huejt. Ma parë i afrohemi nji albanologu kamboxhian e eskimez se sa njenit nga soji ynë me dy vepra voluminoze.

Dhimbjen ma të madhe e shpreh për nji argument tjetër. Sqaron mendimet e shumë dijetarëve të huej, të cilët pranojnë se në fillimet e hershme vërtetë asht folë gjuha nji-rrokëshe, por ma vonë u harrue si të mos kishte ekzistue ndonjiherë. Me këtë veprim makabër, antishkencor e antinjezor, me dashje ose padashje bashkohen edhe bashkëkombasit e mi, kur dihet se edhe sot të folmën me nji rrokje e përdorin gegët, sidomos zonat malore. Në këtë rast, shkruen autori, i nderuem, "atëherë më del vedi qejfit".

Nuk marr përsipër me e analizue këte vepër kaq të randësishme, po mjaftohem tue vu në pah vetëm disa të dhana që më kanë lanë mbresa të fuqishme dhe me u ndie krenar për atë që jam.

Shënime nga libri në fjalë:

* Ne shpëtuem si gen se gjatë thellësive të historisë ne vërtetë u pushtuem nga ushtri të hueja, por jo nga mësues të huej.
* Prandaj shqipja jonë e sotme nuk asht shumë larg nga burimi i saj i stërlashtë. Këte të vërtetë e kemi të prekshme. Gjuhën nji-rrokëshe ende e përdorin gegët, sidomos zonat e malësive. Në veçanti Rugova. Gegnishtja e sotme, trashigimi e ruejtun nga Pellazgo-dardanët.
* Pellazgët liburnë gegë janë "para hanës".Trojanët dhe akejtë janë të nji trungu.
* Lufta e Trojës asht zhvillue mes dy palëve dardanë, tue përfshi këtu edhe dardanët e Egjiptit deri në Gjibraltar.
* Mbreti Agron – Dardani, ishte stërnip i Herkulit. Ai rridhte nga dinastia Heraklide. Kjo 1300 vj. p. k. (Herodoti).
* Dardanët janë prehistorikë. Këta bashkë me etruskët janë popujt e parë indoeuropianë.
* Etruskët toskë themeluan Romën.
* E folmja aeolitike, pararendëse e greqishtës, ishte nji dialekt pellazg.
* Pellazgo dardanët patën shtrimje afro-aziatike.
*Grupet Kentum e Satem të gjuhëve indoeuropiane janë burim i pellazgjishtës.
*Gegnishtja e toskënishtja s'janë dy dialekte motra, por thjesht : NANË e BIJË.
*Edhe sanskritishtja asht dialekt i pellazgjishtës.

Grekët çdo gja primare përpiqen me ia atribue lashtësisë së tyne. Dihet se greqishtja asht bijë aeolistike e hershme, nji-rrokshe, dialekt pellazg. Mbi bazën e gjuhës së Iliadës dhe Odisesë – përpiqen me spjegue etimologjinë e shumë petroglifeve, por s'po ia dalin tash 50-vjet me gjetë etimologjinë e petroglifeve në Kretë. As edhe nji fjalë të vetme s'kanë arritë me e zbërthye. Rasti ma interesant asht ai i Beotisë, aq shumë e zhvillueme aso kohe. Fjalën në nji petroglif, vend i shejtë – OMPHALUS-, s'e zbërthejnë dot, s'ia gjetën rrfanën. U mjaftuen se asht greke vetëm me prapashtesën US, dhe atë vend e quejtën "kërthiza e botës". Por ç'e do se ma vonë, në disa vende u vrejt e njejta fjalë. Kështu botës i dolën shumë "kërthiza".

Etimologjinë e kësaj fjale e zbërthen bindshëm autori i librit për të

cilin po flasim:

OMPHALUS, hiq prapashtesën, kemi:

OMPHAL (lexohet) OMFAL.

Dhe zbërthimi del i qartë: O M FAL. (mungon fjala ZOT e hequn)

Histori tjetër interesante fjala TANAGRA.

TANAGRA në Beoti, greqishtja këtu hesht.

TANAGRA – TANA (të gjitha) GRA, çka asht e kuptueshme. Asht koha e matriarkatit, e në këtë vend drejtonin gratë, amazonat e famshme, çka për grekët quheshin barbarë.

TANAGRA-n, shkruejnë të huejt, e ka themelue POEMANDRU, nip i Lasius, vlla i Dardanit.

Dhe etimologjia e fjalës:

POEMANDRU – PO E MAN DRU (DRU friksohëm) po e man (mban)

Kurrë s'ka pasë gjuhë ilire. Fjala ILIR asht thjesht nji koncept gjeografik e politiko-ekonomik. Nji koncept etnogjuhësor. Vlen të përmenden edhe dy zbërthime për dy fjalë me randësi historike.

ZADRIMA – ZA-DRI-MA SA DRI MA.

Ajo fushë, e mbytun në ujë për shumë kohë, u lirue dikur nga DRINI. Dhe kuptimi: (Ajo fushë) S'â Drima.

DURMITOR, sot malsi e Malit të Zi, dikur log burrash ku lidhej BESA.

DURMITOR – DUR MI DOR (Duer mi dorë!- Besa).

Në mbyllje të këtij shkrimi

Autori i nderuem z. Naim Laçej, historian e gjuhëtar i talentuem, hulumtues i shkathët, kambëngulës dhe i guximshëm, ka zbardhë të vërteta madhore që ndihmojnë historinë, gjuhësinë e kulturën mbarëkombëtare. Asht kjo nji dhuratë e veçantë që e ban me u ndie mirë cilindo që flet shqip. Se, të lodhun nga rrethanat e pakandshme që s'po na ndahen, tue qenë sot edhe të vegjël, jo si dikur, madje edhe të vorfnum, sikur jemi ndi inferior ndaj popujve europianë, ndaj kulturës së tyne.

Po ishte geni pellazgo–dardan etrusk i homosapiensëve që ua hapi rrugën që do të ndiqnin ma vonë. Gen i fuqishëm, jetëdhanës që u shpërnda edhe përtej Europës, në Afro-Azi. Ishte gjuha e tyne e parë që ua hapi dyert e dijes. Gjuha pellazgo–dardane, nana e të gjitha gjuhëve.

Gjuha nji-rrokshe që u mbijetoi mijvjeçarëve, e edhe sot jeton. Nji

mrekulli që na e shton krenarinë. E flasin dardanët gegë, veriu i vendit, kryesisht malësitë, e në veçanti Rugova e strukun mes bjeshkëve. Kush s'e do vetveten, se meriton jetën. E me dashtë vetveten duhet me u mburrë edhe për genin që ke, kuptohet pa urrye të tjerët, se edhe ata janë krijesa të HYJNORES.

Atdheun e duen të gjithë– nji shprehje kjo e rëndomtë. Por, për me e dashtë Atdheun, genin tand, duhet me ditë si me e dashtë . Shembull kemi autorin e këtij libri, Naim Laçej.

Ishte zani i 90–vjeçarit rugovas, që në Shqipni tash ma se 70 vjet po mërtypet .

Beqir **NDRUKAJ**



ARKEOLOGJIA NE PULLAT SHQIPTARE 1913-2018

Promovimi i librit „ *Arkeologjia në pullat shqiptare 1913-2018* ”, të kolegut tonë Hysen Dizdari bëhet në një përvjetor shumë të rëndësishëm; në 106-vjetorin e emëtimit të pullës parë shqiptare. Më 5 maj 1913 është emëtuar pulla e parë postare shqiptare, nga Qeveria e Ismail Qemalit. Në rrugën e vet 106- vjeçare emëtimet e pullave shqiptare kanë pasqyruar me vërtetësi shumë ngjarje të ndryshme, por edhe shumë arritje të shkencës shqiptare, mes të cilave edhe historinë e zbulimeve në fushën e arkeologjisë shqiptare.

Libri ka rëndësi të madhe pasi përmes pullës postare në fushën e arkeologjisë, synon të pasqyrojë rrënjët dhe historinë e lashtë të kombit shqiptar. Ky libër është një guidë e bukur turistike. Përmes 150-të pullave postare të evidentuara synohet të njihen vendburimet dhe objektet më

të rëndësishme arkeologjike të zbuluara në Shqipëri. Libri pasqyron zbulimet më të rëndësishme arkeologjike në qytetin antik të Butrintit, Apollonisë ,Bylisit,Antigonesë, Orikumit, etj. Në këtë libër përfshihen edhe emisionet me pulla postare kushtuar mozaikëve të zbuluara në fshatin Lin të Pogradecit, në Apolloni, Butrint etj.

Libri ndihmon agjensitë turistike pasi mund të përdoret jo vetëm si guidë kulturore e turizmit shqiptar, por edhe si një mundësi e promovimit të vlerave tona kulturore arkeologjike, të panjohura nga të huajt, por edhe nga shqiptarët, sidomos nga të rijtë.

Dua të nënvizoj që ky libër brilant është fryt i punës së madhe studimore, të bërë me durim e përkushtim nga autori Hysen Dizdari. Përpilimi i këtij libri është fryt i një punë disa-vjeçare të autorit në mbledhjen, koleksionimin, studimin e çdo njësie, përpunimim dhe paraqitjen grafike të materialit të zgjedhur, duke pasuruar kësisoj bibliotekën filatelike shqiptare me një libër me vlera të mëdha filatelike

Libri që përmban të gjitha emisionet e fushës me pulla të emëtuara nga Posta Shqiptare nga viti 1913 deri në vitin 2018 është i ndarë në tri periudha që përkojnë me periudhat historike, si më poshtë:.

Pjesa e parë i kushtohet viteve 1913-1944,

Pjesa e parë i kushtohet viteve 1945-1990,

Pjesa e parë i kushtohet viteve 1991-2018,

Ky libër promovohet në qytetin e Shkodrës, që ka qenë djepi i filatelisë shqiptare. Në muajin Prill të vitit 1947,në Shkodër u themelua *Klubi i Parë Filatelik Shqiptar* me insiativë të intelektualëve: Idriz Fishta, Zef Prendushi, Pashko Saraçi, Selim Karakaçi etj.

Në muajin Shtator të vitit 1947 u hap ekspozita e parë filatelike në qytetin e Shkodrës me emisionet e pullave shqiptare dhe të huaja. Në këte ekspozitë filatelike ishin të ftuar përfaqësuesit e trupës diplomatike që ndodheshin në Shqipëri. Ekspozita u vizitua nga rreth 4000 qytetarë shkodranë, por edhe nga qytetet e tjera. Jehona e saj kapërceu kufijtë e Shqipërisë. Për këtë ekspozitë shkruajti një reportazh edhe revista filatelike Zagrebit, në Kroaci.

Në vitet në vijim filatelia në Shkodër mori zhvillim sidomos në vitin 1957, kur klubi drejtohej nga filatelistët e njohur Idriz Fishta, Kolë Gjinaj, Gjush Daragjati Prof. Shefik Osmani, Lugj Shabani etj.

Historia e Klubi Filatelik të Shkodrës në këto vite ishte shumë aktive. U organizuan seminare, dhe ekspozita filatelike për të ndihmuar brezin e ri me njohuritë e para filatelike. Ishte meritë e këtij klubi filatelik edukimi i një brezi të ri filatelistësh të pasionuar shkodranë, disa prej të

cilëve jemi sot këtu.

Falenderoj autorin e këtij libri Hysen Dizdari, për kontributin e tij të veçantë në fushën e filatelisë shqiptare duke sjellë në biblotekat tona librin e katërt të tij.

Librat e z.Hysen Dizdari, katër të tillë më trajtesa të ndryshme, kanë përfaqësuar me dinjitet filatelinë shqiptare në ekspozitat filatelike ndërkombetare , si në ekspozitën *" ITALIA 2018"* , hapur në Verona (Itali).

Dy nga librat e botuara u vlerësuan nga Juria e specializuar ndërkombëtare e librit filatelik me dy medalje ndërkombëtare. Vlerësimet e dhëna shënojnë një ndihmesë shumë të vlefshme për tërë historinë e filatelisë shqiptare. Libri "Gjergj Kastrioti Skenderbeu në pullat shqiptare" u vlerësua me medaljen "VERMEL LARGE", kurse libri tjetër "Flora dhe Fauna Detare në pullat shqiptare" u vlerësua me medalje "VERMEL" .

Ne studiuesit dhe filatelistët shqiptarë , por veçanërisht *Posta Shqiptare* duhet t'i jemi mirënjohës Hysen Dizdarit për kontributin e tij të veçantë, në fushën e botimet të librave me vlera të mëdha shkencore për filatelinë shqiptare..

▪ **Bibliografi** ▪

Fatmira **LEKIQI**

PASURI HARTOGRAFIKE
NË BIBLIOTEKËN "MARIN BARLETI"

Në koleksionin e fondit Albano-Ballkanologjik, që është një ndër më të pasurit në vend, gjendet një koleksion i pasur hartash. Janë ruajtur rreth 232 harta që i takojnë viteve 1877-1960.
Hartat janë një burim i rëndësishëm për studimin e gjeografisë, historisë, arkeologjisë, etnografisë, gjeologjisë etj. Tematika e tyre është e larmishme. Nga përmbajtja kemi harta fizike, topografike, ushtarake administrative të Shqipërisë, Ballkanit e Europës.
"Shqipëria përmes hartave" është një katalog hartash, një paraqitje e një pasurie hartografike të bibliotekës Publike "Marin Barleti" në shërbim të studiuesve dhe gjithë të interesuarve .
Vitet 1850-1940 janë vitet kur kufijtë e trojeve shqiptare kanë ndryshuar mjaft dhe hartat e dokumentojnë këtë gjë.
Dokument me vlerë është harta e emërtuar Shcypenia /Shciperia. E para kartë e dheut tone. E vitit 1902. Dokument tjetër me vlerë është harta topografike me emërtime të rrugëve në gjuhën frënge e vitit 1913 për Shkodrën e kopjuar me përkthim në shqip të emërtimeve të rrugëvenga Jezuitët në vitin 1923. Si dhe hartat e kufijve të Shqipërisë në 1922-1925.
Ky është një katalog alfabetik i shoqëruar me një tregues kronologjik. Për hartat janë dhënë emërtimi i hartës, vendi i botimit të hartës, botuesi (institucioni ku janë përpunuar hartat), viti i botimit, të dhënat fizike(numri i fletëve, përmasat, lloji, treguesit e hartës etj.)si dhe vendndodhja në fondin Albano-Ballkanologjik.

1. ***Albania.*** Firenze, St. Cartografico G. Giardi, s. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,
Al / 41 / 196 B, 1: 800.000
2. ***Albania.*** Opere costruite coi fondi del prestito LLPP. SVEA. Firenze, St. Cartografico G. Giardi,, 1935. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 154 B
3. ***Albania.*** Opere publiche in costruzione coi fondi del prestito LLPP. SVEA. S.l.[Firenze], [1930]. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 /189 B, 1: 1.000.000
4. ***Albania.*** Strade, ponti, ferrovie costruite o in costruzione coi fondi del prestito LLPP. SVEA.S.l. [Firenze], S.a.. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 /193 B, 1: 1.000.000
5. ***Albania.*** Bergamo, Ist. D'Arti Grafiche, 1936, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,
Al / 41 / 90 B, 1: 800.000
6. ***Banjë***, e botueme prej Ministris s' Arsimit Tiranë, Vjenë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak, [1925], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 178 B , 1: 75000
7. ***Berane.*** S. l.,[Ëien],, Mitelgeographisches Inst, 1915, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al/ 41 / 22 B, 1: 75.000
8. ***Berat,*** e botueme prej Ministris s' Arsimit Tiranë, Vjenë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak , [1925], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 180 B , 1: 75000
9. ***Burgajet,*** e botueme prej Ministrisë së Arsimit. Tiranë, Vjenë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak, S. a.,[1925]. 1 fl.hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 183 B, 1: 75.000
10. **Bilotj.** ***39º 41º***, S. l. .[Ëien],, s. a.[1917], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 65 B, 1: 200.000
11. **Coronelli. P.**

Carta dello Stato di Ragusi di P. Coronelli. S.l., 1688. 1 fl. hartë.

12. ***Carta fisico-politica dell Albania. Regno d' Albania***. Novara, Istituto Geografico de Agostini, 1939, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 117 B, 1: 300.000
13. ***Campo orientale della Guerra Europea 1914. Germano - Russo, Austro - Russo, Austro –Serbo***. Milano. Antonio Vallardi edit. 1914, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,
Al / 41 / 46 B, 1: 2.200.000
14. ***Classical Lands of the Mediterranean***. *Compiled and Draën in*

the Cartographic Section of The National Geographic Society for The National Geographic Magazine. Albert H. Bumstead, Chief Cartographer, Culture by James M. Darley and Apphia E. Hodstock. Physiography by John J. Brehm, historic Research by Ëellman Chamberlli. Ëashington, Gilbert Grosvenor, editor, march 1940. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 36 B, 1: 2.217.600

15. ***Der heilige Krieg. Südëestliches, Russland, Türkei und die Balkanländer***. *Von der Adria bis zum Kaukasus.* , Leipzig, Ausgeführt von (realizohet nga) C. Opitz, Geogr. Anst., Oskar Eulitz Verlag(botoi), Lissa I .P. [1915], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, (rrugë hekurudhore nëpër Europë) Al / 41 / 63 B, 1: 2.000.000
16. ***Elbasan. 38º 41º***, S. l. .[Ëien],, s. a., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 172 B, 1: 200.000
17. ***Elbasani.*** e botueme prej Ministris s'Arsimit Vjenë, Tiranë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak, 1925, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 171 B, 1: 75.000
18. ***Europa politica.*** Novara, Ist. Geografico de Agostini, 1941, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe , Al / 41 / 42 B, 1: 6.000.000
19. ***Europa (L') in Armi. Carta geografica dell' Europa Centrale***. Napoli, Il Mattino Illustrato, 1940. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 62 B
20. **Freytag, G.**

Karte der Balkan-Halbinsel mit ganz Griechenland. Neue rividierte Ausgabe. Ëien, Kartographisches Anstald. [1917], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 25 B, 1: 250.000

21. **Freytag, G.**

Karte der Balkan-Halbinsel mit den neuen politischen Grenzen. Neue rividierte Ausgabe. Ëien, Kartographisches Anstald. G. Freytag e Berndt, 1914, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,

Al / 41 / 30 B, 1: 250.000

22. **Freytag, G.**

Karte des furstentums Albanien. Ëien, Kartographisches G. Freytag e Berndt. [1914],

1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 191 B, 1: 600.000

23. **Freytag, G.**

Karte des furstentums Albanien. Ëien, Kartographisches G. Freytag e Berndt. [1914],

1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 192 B, 1: 600.000

24. **Freytag, G.**
Karte von Albanien. Ëien, Kartographisches G. Freytag e Berndt. [1914],
1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 197 B, 1: 600.000
25. **Freytag, G.**
Karte von Albanien. Ëien, Kartographisches anstalt G. Freytag e Berndt. S.a.,
1 fl. hartë , Al / 41 / 187 B, 1: 600.000
26. ***Grecia (La) antica.*** Torino, S.a., 1 fl. il. Al / 41 / 21 B, 1: 3.000.000
27. ***Gjakova***, E botueme prej Ministrisë së Arsimit. Tiranë, Vjenë , Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak, S. a.,[1925]. 1 fl.hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 51 B, 1: 75.000
28. ***Harta topografike e Shkodrës*** botue prej etenve Jezuit 1923, Novara, Ist. Geografico de Agostini 1923, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe , Al / 41 / 2 B, 1 cm= 63.36 m.
29. ***Iliriku në shek. IV – VI. Iliria në shek. I – III***. S. l., S. a. 1 fl. hartë, Al / 41 / 201 B
30. ***Iliria mijëvjeçari I- rë para erës sonë.*** S. l., S. a. 1 fl. hartë, Al / 41 / 203 B
31. ***Ipek.*** E botueme prej Ministrisë së Arsimit. Tiranë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak Vjenë , S. a.,[1925]. 1 fl.hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 49 B, 1: 75.000
32. ***Janina. 39º 40º.*** S. l. .[Ëien],,Militelgeographisches Inst., [1916],1 fl. hartë shumëngjyrëshe,
Al / 41 / 59 B,1: 200.000
33. ***Janina.*** S.l. .[Ëien], S.a., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 64 B, 1: 200.000
34. ***Korçë,*** e botueme prej Ministris s' Arsimit Tiranë, Vjenë, , Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak, 1925, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 181 B, 1: 75.000
35. ***Koritza – Argyrokastron - Janina***. S. l., Empisteytikon,S.a., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 177 B, 1: 200.000
36. ***Kunst und Landkarten 37º 43º*** , Handlung Artaria e Co. Ëien, Generaldobskorten, 1894,
1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 71 B, 1: 75.000
37. ***Lushnjë,*** e botueme prej Ministris s' Arsimit Tiranë , Vjenë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak, [1925], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 182 B , 1: 75.000

38. ***Mediterraneo. Porti d'Italia***. *Carta allegata al fasc. 4 della rivista "Panorama"*. Novara, Istituto Geografico de Agostini, 1939., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 72 B,
1: 75.000
39. ***Novipazar. 38º 43º***, S. l. .[Ëien],, 1912] , 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 67 B, 1: 200000
40. **Ordini, C. ; Lient, P. ; Gazzera, P.**
Boyana longitude est du meridien de Paris. Longitude Est du Méridien de Paris . *Carte della Frontière S. H. S.* Albanaise dressée par les sains de la commusion interna tronale de delimitation, 1922-1925. Florence, Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence, [1925], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,Feuille N. 1, Al / 41 / 1 B, 1: 50.000
41. **Ordini, C. ; Clough, A. B. ; Gazzera. P.**
Dibra. Longitude Est du Méridien de Paris. *Carte de la Frontière S.H. Albanaise dressée par les soins de la commission international de delimitation, 1922-1925*. Florence, Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 8., Al / 41 / 86 B, 1:50.000
42. **Ordini, C. ; Lient, P. ; Gazzera, P.**
Dyravitsa. Longitude Est du Méridien de Paris. Carte de la *Frontière* Greco-Albanaise dressée par les soins de la commission international de delinutation 1923-1924. S. l., Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feueille N. 5, Al / 41 / 75 B,
1: 50.000
43. **Ordini, C. ; Clough, A. B. ; Gazzera. P.**
Goussinyé. Longitude Est du Méridien de Paris . *Carte de la Frontière S.H. Albanaise dressée par les soins de la commission international de delimitation, 1922-1925*. Florence, Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 4., Al / 41 / 89 B, 1: 50.000
44. **Ordini, C. ; Giles, F.; Gazzera. P.**
Gramos. Longitude Est du Méridien de Paris. Carte de la *Frontière* Greco-Albanaise dressée par les soins de la commission international de delinutation 1923-1924. Florence Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. [1925]. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 13., Al / 41 / 83 B , 1: 50.000
45. **Ordini, C. ; Clough, A. B. ; Gazzera. P.**

Korab. Longitude Est du Méridien de Paris. *Carte de la Frontière S.H. Albanaise dressée par les soins de la commission international de delimitation, 1922-1925*. Florence, Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 7., Al / 41 / 87 B, 1: 50.000

46. **Ordini, C. ; Clough, A. B. ; Gazzera. P.**

Koritnik. Longitude Est du Méridien de Paris. *Carte de la Frontière S.H. Albanaise dressée par les soins de la commission international de delimitation, 1922-1925*. Florence, Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 6., Al / 41 / 88 B, 1: 50.000

47. **Ordini, C. ; Giles, F. ; Gazzera. P.**

Lac d'Ochrida. Carte de la *Frontière* Greco- Albanaise dressée par les soins de la commission international de delinutation 1922-1925. Florence Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. [1925]. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 10., Al / 41 / 79 B , 1: 50.000

48. **Ordini, C. ; Clough. A. B. ; Gazzera, P.**

Makrikambos. Longitude Est du Méridien de Paris. Carte de la *Frontière* Greco- Albanaise dressée par les soins de la commission international de delinutation 1923-1924. Florence Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. [1925]. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 15., Al / 41 / 79 B , 1: 50.000

49. **Ordini, C. ; Clough, A. B. ; Gazzera. P.**

Sarandaporos. Longitude Est du Méridien de Paris. Carte de la *Frontière* Greco- Albanaise dressée par les soins de la commission international de delinutation 1923-1924. Florence Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. [1925]. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 14., Al / 41 / 84 B , 1: 50.000

50. **Ordini, C. ; Giles, F. ; Gazzera. P.**

Souha Gora. Longitude Est du Méridien de Paris. Carte de la *Frontière* Greco- Albanaise dressée *par les soins de la commission international de delimitation, 1923-1924*. Florence., Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 11, Al / 41 / 81 B, 1: 50.000

51. **Ordini, C. ; Giles, F. ; Gazzera. P.**

Strouga. Longitude Est du Méridien de Paris. Carte de la *Frontière* S.H.S. Albanaise dressée par les soins de la commission international de delinutation 1922-1925. Florence, Imprimé à l'Inst. Géographique

de Florence.. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 9, Al / 41 / 85 B, 1: 50.000

52. **Ordioni, C. ; Giles. F. ; Gazzera, P.**

Stougara – Mourgara. Longitude Est du Méridien de Paris. Carte de la *Frontière* Greco- Albanaise dress*é*e *par les soins de la commission international de delimitation, 1923-1924*. Florence., Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 16, Al / 41 / 78 B, 1: 50.000

53. **Ordini, C. ; Giles, F. ; Gazzera. P.**

Vermoche. Longitude Est du Méridien de Paris . Carte de la *Frontière* S.H.S. Albanaise dress*é*e par les soins de la commission international de delinutation 1922-1925. Florence, Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence.. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,Feuille N. 3, Al / 41 / 77 B, 1 : 50.000

54. **Ordini, C. ; Giles, F. ; Gazzera. P.**

Vidova. Longitude Est du Méridien de Paris. Carte de la *Frontière* Greco-Albanaise dress*é*e *par les soins de la commission international de delimitation, 1923-1924*. Florence., Imprimé à l'Inst. Géographique de Florence. S. a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Feuille N. 12, Al / 41 / 82 B, 1: 50.000

55. **Peltier, G.**

Les pays Balcaniques supplement à l'illustration. S.l., 1915, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,

Al / 41 / 23 B, 1: 2.000.000

56. **Peneker, Karl**

Karte von Makedonien, Altserbien und Albanien. Mit kartographischen, historischen und statistischen Beilagen zum Verständnisse der makedonischen Frage. Ëien, Verlag von Artaria & Co, 1904, Al / 41 / 20 B, 1: 864.000

57. ***Plevlje. 37º 43º***, S. l. .[Ëien],, 1912, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 66 B, 1: 200.000

58. ***Pogradec*** e botueme prej Ministris s' Arsimit Tiranë, Vjenë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak [1925]., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 179 B, 1: 75.000

59. ***Pristina. 39º 43º***, S. l. .[Ëien],, s. a., 1 fl.hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 69 B, 1: 200.000

60. ***Prizren. 38º 42º. Provizorisch***, S. l. .[Ëien],, Militargeographisches Institut, [1922], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 70 B, 1: 200.000

61. ***Rożakoëski. V.***
Hrvatska slavonila Dalmacija i susjedne zemlje = Kroacia Sllavët e Dalmacisë dhe vendet fqinje, Zagreb, s. a., Al / 41 / 181 B, 1: 500.000
62. ***Skoplje. 39º 42º***, S. l. .[Ëien],, s. a. 1 fl.hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 68 B, 1: 200.000
63. ***Scutari. Albania. Plan of Roads and important Buildings***, S. l., 1913, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 3 B, 1: 6336 or 10 inch to 1 miles
64. ***Scutari (Škodra)***,S. l. .[Ëien],, Militargeographisches Institut, 1918, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 6 B,1: 75.000
65. ***Scutari (Škodra) 37º 42º, Provizorisch,*** Gerinn Assist F. Noltz & Aspir. V. Bittmann, S. l. .[Ëien],, Militargeographisches Institut, 1917., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 7 B, 1: 200.000
66. ***Scutari. 37º 42º***, Gerinn Assist F. Noltz & F. R. Ëalter, Terrain Hotm A. Vogel, S. l. .[Ëien],, 1904., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 10 B, 1: 200.000
67. ***Scutari. 37º 42º***, Gerinn Assist F. Noltz & F. R. Ëalter, Terrain Hotm A. Vogel, S. l. .[Ëien],, [1904]., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 9 B, 1: 200.000
68. ***Scutari. 37º 42º*** , S. l.[Ëien], [1904]., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 4 B, 1: 200.000
69. ***Stati (Gli) Balcanici. Turchia - Mediterraneo Orientale***. Roma, Ente Teponomastico Italiano, [1939], 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 17 B, 1: 3.000.000
70. ***Strassenkarte Albaniens***. S. l., [1941-1942] 1 fl. hartë, Al / 41 / 194 B, 1: 900.000
71. **Sulzer, C.**
Europa Sud-Orientale. Albania, Grecia, Turchia, Milano. Antonio Vallardi edit. [1942]. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 27 B, 1: 1.500.000
72. ***Shëngjergj,*** e botueme prej Ministris s' Arsimit Tiranë, Vjenë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak, 1925, 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 184 B, 1: 75.000
73. ***Shcypenia / Shciperia.*** E para karte é dhéut tone. Kushton 5 kurora t'Aystries. Shitet ne London. Bruxelles, Instituti Géographique, 1902, Al / 41 / 206 B
(Ngrehun mbas punevé t' Institutit dhéshkrimtar ushterak te Viénes. Per

Shocerine “Perlindia é Shcipetarevé”. Ghithemsim i Ri = Université Nouvelle)

74. ***Shqipëria fizike***. Tiranë, N.I. Sh. Mjete Mësimore, 1960. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,

Al / 41 / 196 B

75. ***Tirana.*** (Carta d’Europa) Edizione provisoria. Milano, Consociazione Turistica Italiana, 1940. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 114 B, 1: 500.000

76. ***Valona. 37º 40º***, Geripp Offic. R. Dokaupil, S. l.[Ëien], , s.a.., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,

Al / 41 / 176 B, 1 : 200.000

77. ***Valona.*** *Paasche’s Spezialkarten der Mazedonischen Front*. *Schizzo dimostrativo ipsometrico dell’ Albania*, Stuttgart, Paasche & Luz, S.a. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe,

Al / 41 / 157 B, 1: 400.000

78. ***Valona (ВАЛОНА),*** S. l., 1917, Al / 41 / 174 B, 1: 200.000

79. **Viezzoli, P. L.**

Harta e Shqipërisë (Carta della Albania).Rishtypja e ksajë harte nuk mund të bâhet pa lêje t’Etneve Jezuit në Shkodër, Bergamo, Istituto Italiano d’Arti Grafiche, 1929. 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 91 B, 1: 500.000

80. ***Vlona (Valona)***, e botueme prej Ministris s’ Arsimit Tiranë, Vjenë, Inst. Kartografik pranë Inst. Geografik Ushtarak, [1925]., 1 fl. hartë shumëngjyrëshe, Al / 41 / 175 B,

1: 75.000

Tregues kronologjik

1894

Kunst und Landkarten 37º 43º

1902

Shcypenia / Shciperia

1904

Peneker, Karl

Karte von Makedonien, Altserbien und Albanien

Scutari. 37º 42º

Scutari. 37º 42º

1912

Bilotj. 39º 41º

Elbasan. 38º 41º
Novipazar. 38º 43º
Plevlje. 37º 43º
Valona. 37º 40º
1913
Scutari. Albania. Plan of Roads and important Buildings
1914
Campo orientale della Guerra Europea 1914. Germano - Russo, Austro - Russo, Austro –Serbo
Freytag, G.
Karte der Balkan-Halbinsel mit den neuen politischen Grenzen
Freytag, G.
Karte des furstentums Albanien
Freytag, G.
Karte von Albanien
1915
Berane
Der heilige Krieg. Südëestliches, Russland, Türkei und die Balkanländer
Peltier, G.
Les pays Balcaniques supplement à l'illustration
1916
Janina. 39º 40º
Skoplje. 39º 42º
1917
Freytag, G.
Karte der Balkan-Halbinsel mit ganz Griechenland
Scutari (Škodra) 37º 42º, Provizorisch
Valona (ВАЛОНА)
1918
Scutari (Škodra)
1922
Prizren. 38º 42º. Provizorisch
1923
Harta topografike e Shkodrës
1922-1925
Ordini, C.; Lient, P.; Gazzera, P.
Boyana, longitude est du meridien de Paris

Ordini, C.; Clough, A. B.; Gazzera. P.
Dibra
Ordini, C; Clough, A. B.; Gazzera. P.
Goussinyé
Ordini, C.; Clough, A. B. ; Gazzera. P.
Korab
Ordini, C.; Giles, F. ; Gazzera. P.
Lac d'Ochrida
Ordini, C.; Giles, F. ; Gazzera. P.
Strouga
Ordini, C.; Giles, F. ; Gazzera. P.
Vermoche
1923-1924
Ordini, C. ; Lient, P. ; Gazzera, P.
Dyravitsa
Ordini, C. ; Giles, F.; Gazzera. P.
Gramos
Ordini, C.; Clough, A. B.; Gazzera. P.
Koritnik
Ordini, C.; Clough. A. B. ; Gazzera, P.
Makrikambos
Ordini, C.; Clough, A. B. ; Gazzera. P.
Sarandaporos
Ordini, C.; Giles, F.; Gazzera. P.
Souha Gora
Ordioni, C.; Giles. F. ; Gazzera, P.
Stougara – Mourgara
Ordini, C. ; Giles, F. ; Gazzera. P.
Vidova
1925
Banjë
Berat
Burgajet
Elbasani
Gjakova
Ipek
Korçë
Lushnjë

Pogradec
Shëngjergj
Vlona (Valona)
1929
Viezzoli, P. L.
Harta e Shqipërisë (Carta della Albania).
1930
Albania
1935
Albania
1936
Albania
1939
Carta fisico-politica dell Albania. Regno d' Albania
Mediterraneo. Porti d'Italia
Stati (Gli) Balcanici. Turchia - Mediterraneo Orientale
1940
Classical Lands of the Mediterranean
Europa (L') in Armi. Carta geografica dell' Europa Centrale
Tirana. (Carta d'Europa)
1941
Europa politica
Strassenkarte Albaniens
1942
Sulzer, C.
Europa Sud-Orientale. Albania, Grecia, Turchia
1960
Shqipëria fizike

Pa vit botimi
Grecia (La) antica
Iliriku në shek. IV – VI. Iliria në shek. I – III
Iliria mijëvjeçari I- rë para erës sonë
Koritza – Argyrokastron – Janina
Rożakoëski. V.
Hrvatska slavonila Dalmacija i susjedne zemlje
Valona

Katalogu sipas vendit të botimit

Bergamo
Albania
Viezzoli, P. L.
Harta e Shqipërisë (Carta della Albania)
Bruxelles
Shcypenia / Shciperia
Firence
Albania
Florence
Ordini, C.; Lient, P.; Gazzera, P.
Boyana , longitude est du meridien de Paris
Ordini, C.; Clough, A. B.; Gazzera. P.
Dibra
Ordini, C.; Clough, A. B. ; Gazzera. P.
Goussinyé
Ordini, C.; Clough, A. B. ; Gazzera. P.
Korab
Ordini, C.; Giles, F.; Gazzera. P.
Lac d'Ochrida
Ordini, C.; Giles, F.; Gazzera. P.
Strouga
Ordini, C.; Giles, F.; Gazzera. P.
Vermoche
Ordini, C.; Lient, P.; Gazzera, P.
Dyravitsa
Ordini, C.; Giles, F.; Gazzera. P.
Gramos
Ordini, C.; Clough, A. B.; Gazzera. P.
Koritnik
Ordini, C. ; Clough. A. B. ; Gazzera, P.
Makrikambos
Ordini, C.; Clough, A. B.; Gazzera. P.
Sarandaporos
Ordini, C.; Giles, F.; Gazzera. P.
Souha Gora
Ordioni, C.; Giles. F.; Gazzera, P.

Stougara – Mourgara
Ordini, C.; Giles, F.; Gazzera. P.
Vidova
Leipzig
Der heilige Krieg. Südëestliches, Russland, Türkei und die Balkanländer
Milano
Campo orientale della Guerra Europea 1914. Germano - Russo, Austro - Russo, Austro –Serbo
Sulzer, C.
Europa Sud-Orientale. Albania, Grecia, Turchia
Tirana
Napoli
Europa (L') in Armi. Carta geografica dell' Europa Centrale.
Novara
Carta fisico-politica dell Albania. Regno d' Albania
Europa politica
Harta topografike e Shkodrës
Mediterraneo. Porti d'Italia
Roma
Stati (Gli) Balcanici. Turchia - Mediterraneo Orientale
Stuttgart
Valona
Tiranë
Shqipëria fizike
Torino
Grecia (La) antica
Washington
Classical Lands of the Mediterranean.
Wien
Freytag, G.
Karte der Balkan-Halbinsel mit ganz Griechenland
Freytag, G.
Karte der Balkan-Halbinsel mit den neuen politischen Grenzen
Freytag, G.
Karte des furstentums Albanien
Freytag, G.
Karte von Albanien

Kunst und Landkarten 37º 43º
Peneker, Karl
Karte von Makedonien, Altserbien und Albanien
Prizren. 38º 42º. Provizorisch
Scutari. 37º 42º
Janina. 39º 40º
Skoplje. 39º 42º
Scutari. 37º 42º
Scutari. 37º 42º
Bilotj. 39º 41º
Elbasan. 38º 41º
Novipazar. 38º 43º
Plevlje. 37º 43º
Valona. 37º 40º
Shëngjergj
Vlona (Valona)
Banjë
Berat
Burgajet
Elbasani
Gjakova
Ipek
Korçë
Lushnjë
Pogradec
Shëngjergj
Vlona (Valona)
Zagreb
Rożakowski. V.
Hrvatska slavonila Dalmacija i susjedne zemlje

Pa vend botimi
Iliriku në shek. IV – VI. Iliria në shek. I – III
Iliria mijëvjeçari I- rë para erës sonë
Koritza – Argyrokastron – Janina
Scutari. Albania. Plan of Roads and important Buildings
Strassenkarte Albaniens
Valona (ВАЛОНА)

Erzen **KOPERAJ**

SHQIPJA DHE SHQIPTARËT NË ARTIKUJT E ETËRVE FRANÇESKANË

(referuar artikujve të botuar në revistën "Hylli i dritës")

Si kudo edhe te shqiptarët, kombi nuk ndahet nga mitet dhe historia e tij , për më tepër kur bëhet fjalë për një popull të cilit gjatë shekujve i është mohuar identiteti dhe të drejtat, e në këtë prizëm, revista *Hylli i dritës*, si një votër e kulturës shqiptare[1], padyshim që artikujt mbi prejardhjen e shqiptarëve nuk do t'i kishte të pakët. Aq më shumë, po të theksojmë se përveç etërve françeskanë, në revistë botonin emra të tillë si Eqerem Çabej, Nobert Jokli, G.Stadmuller, Th.Kapidan, që në veprën e tyre, vendin e parë e zinte origjina e shqipes dhe e shqiptarëve. Pavarësisht, se revista filloi të botohet një vit pas themelimit të shtetit shqiptar, në mjaft artikuj të saj përpiqet të zbulojë dhe të argumentojë në mënyrë shkencore vendin e formimit të etnosit shqiptar, apo siç thuhet në një prej tyre, "*me tregue identitetin që del "në krahinat e Shqipnisë së vërtetë , e cila për gjurmuesin e gjuhës dhe historisë nuk ashtë e njajtë me Shqipninë e krijueme nga diplomacija e shtrembët e vjetit 1913*"[2].

Në numrat e revistës gjen artikuj që e trajtojnë në përgjithësi një çështje të tillë, por edhe artikuj që fokusohen në çështje të veçanta si toponomastika, lidhjet shqiptaro-rumune, shfaqja e shqiptarëve në kronikat mesjetare. Edhe sot e kësaj dite, mjaft prej shkrimeve të P.Marin

[1] *Një nëntitull të tillë, "votër e kulturës shqiptare" kjo revistë e ka mbajtur gjatë tembëdhjetëviteve të saj për të dëshmuar qartazi orientimin dhe hapjen e saj ndaj çështjeve thelbësore të kulturës, shkencës dhe debatit politik të ditës, duke mos u kufizuar vetëm në tematikën fetare, edhe pse kishte lindur dhe drejtohej nga etërit françeskanë.*

[2] *N.Jokl, "Populli shqiptar dhe gjuha e tij", HD 1941, f.11*

Sirdanit, Eqerem Çabejt, Sh. Gjeçovit, Gj. Gazullit e shumë të tjerëve zgjojnë interes, aq më tepër kur duhet të kemi parasysh se disa shkenca si gjuhësia dhe arkeologjia ishin në belbëzimet tyre të para në fundin e shek. XIX dhe fillimin e shek.XX. Këtu duhen përmendur artikuj të tillë, si *Trashigime trako-iliriane*, të Gjeçovit, *Shqipnija e kohës së mjesme*, e Dodajt, *Emri "Shqiptar dhe arbnuer"*, *Shqipnia dhe shqiptarët*,të M.Sirdanit, *Për historinë kombtare*, që del në numrat e vitit 1936 të revistës, si një dorëshkrim françeskan i 1571, *Pellazgë dhe helenë* të K. Floqit, *Marrëveshjet e Raguzës me princa shqiptar në fillimin e shekullit XIII* me autorë Solonjen dhe Preluca, *Marrëdhënie gjuhësore shqiptaro-rumune*, *Shqiptarët në Italinë e mesme dhe në Napoli*, *Diana dhe Zana*, *Mbi gjenezën e literatyrës shqipe*, të Çabejt e shumë artikuj të tjerë, e po t'i shtojmë këtu studimet e botuara në revistë të Jokl-it, *Populli shqiptar dhe gjuha e tij*. Georg Stadmuller-it, *Historija e shqiptarëve*, Th. Kapidan-it *"Paraqitja e gjendjes etnologjike në ballkan"*, H.Bariç-it, *Gjuha shqipe* etj. e bëjnë këtë revistë përfaqësuesen e mendimit më kopetent shkencor për kohën dhe tribunë e mendimit albanologjik.

Është e logjikshme që kur pyetet për prejardhjen e shqiptarëve, paralel me këtë çështje të shtrohet dhe ajo e burimit të shqipes, se nga cila gjuhë e vjetër e Ballkanit antik vjen. Pavarësisht se mendimi shkencor në artikujt e mësipërm nuk i bashkon gjithë autorët në një zë, por ajo çfarë ngulmohet dhe del si rezultat i tyre, është: "*Tashma është mendimi i përgjithshëm i historjanëve, gjuhëtarëve, etnologëve se Ilirët, trakët, pellazgët, qenë banorët e parë dhe ma të lashtët e Ballkanit, e se shqiptarët rrjedhin prej iliro-trakëve të hershëm. Në historinë e Ballkanit, shqyptarët përfaqsojnë kombin e vërtetë autokton*"[3], një mendim që bashkon nga njëra anë edhe mendimin e K. Patch-it , Çabejt e në një farë mënyre edhe të Stadmullerit nga njëra anë, por edhe të Joklit e H. Bariç-it nga ana tjetër. Vetë përcaktimet *trako-ilire*, apo *iliro-trake* të përdorura nga Sirdari dhe Gjeçovi, tregojnë jo vetëm ecje në një hulli me mendimin shkencor të kohës[4], por edhe një qëndrim konseguent në

[3] *M.Sirdani, "Shqipëria dhe shqiptarët", HD 1941,nr.3-5, fq.98-99.*

[4] *Në këto vite mbi prejardhjen e shqipes mbizotëronte mendimi i Joklit dhe Bariçit që shohin te shqipja gjurmë të ilirishtes dhe trakishtes. Sipas Jokl-it: "… ne shohim që mbeturinat gjuhësore të popujve të vjetër ballkanas, si të ilirëve edhe të trakasve, janë të lidhura shumë ngushtë me gjuhën e shqiptarëve. Kjo lidhje e dyfishtë mund të sqarohet vetëm nëpërmjet parashtrimit të lidhjeve midis ilirëve dhe trakasve. Por që kjo nuk duhet kuptuar si një imigrim në Gadishullin Ballkanik në kohën e dyndjes së popujve, këtë na e dëshmojnë huazimet e shqipes nga greqishtja e vjetër, të cilat janë*

çështjen e autoktonisë së shqiptarëve, duke mos e pranuar mendimin se stërgjyshërit e shqiptarëve në periudhën e Mesjetës të jenë shpërngulur nga verilindja drejt jugperëndimit dhe pastaj si barinj endacakë, pa u vënë re, kaluan viset në jug të Danubit për t'u vendosur në trojet e tyre të sotme.

Ndryshe nga mendimi i H.Bariç[5], apo i G.Bonfante-s[6], që mendojnë dhe mbështesin teoritë e përzierjeve gjuhësore (*teoria e simbiozës*) siç theksohet në veprat e tyre, në raste kontaktesh midis popullsish, që flasin gjuhë të ndryshme, ka ndodhur jo rrallë që njëra popullsi, për një arsye historike, si pasojë e pushtimeve të gjata, por edhe si rezultat i ndikimeve kulturore e sidomos, dhe i gjuhës së fesë - një prej institucioneve më të rëndësishëm deri në periudhën e mesjetës së hershme, e cila padyshim ka luajtur një rol shumë të madh në organizimin jo vetëm të jetës shpirtërore, por edhe atë shoqërore - të ketë përvetësuar gjuhën asimiluese dhe të ketë humbur dalëngadalë gjuhën amtare dhe duke marrë por edhe krijuar një gjuhë të "re", siç ka ndodhur, ndër të tjera, në rastin e gjuhëve romane e në më pak raste edhe ato gjermanike. Padyshim që gjuha që asimilohet lë mjaft gjurmë në gjuhën e përftuar, duke qenë e qartë se në raste të tilla, kjo gjuhë në gojën e popullsisë së asimiluar do të pësojë disa ndryshime kryesisht në fjalor dhe pjesërisht edhe në mënyrën e shqiptimit të disa tingujve si edhe në disa ndërtime sintaksore, duke mbetur në nivelin e substratit[7]. Por një teori e tillë, sidomos për shqipen nuk ka gjetur mbështetje dhe është kritikuar nga E.Çabej dhe Sh.Demiraj. Gjuha asimiluese, në thelb, i ruan tiparet e veta themelore në të gjitha nënsistemet e saj, në mënyrë të veçantë në strukturën morfologjike. Si rrjedhim, në sistemin e saj tërësor ajo nuk del si një gjuhë e formuar nga shkrirja a sinteza e dy gjuhëve në kontakt midis tyre. Prandaj edhe në rastin e gjuhës shqipe nuk ka arsye të mendohet që ajo të jetë zhvilluar nga përzierja a sinteza e dy gjuhëve qoftë edhe shumë të afërta, siç mendohet të kenë

më të hershme se huazimet latine.", ndërsa teza e Bariç-it mbështetet në prejardhjen e shqipes si një simbiozë e trakishtes me ilirishten, ku më shumë mbizotëron elementi trak.

[5] *H. Bariç, "Hymje në historinë e gjuhës shqipe", Prishtinë, 1956.*

[6] *G. Bonfante, "I dialetti indoeuropei", Palermo, 1961.*

[7] *Lidhur me këtë shih E. Çabej, "Hyrje në indoevropianistikë", Tiranë, 2008; A.Buda, "Etnogjeneza e popullit shqiptar në dritën e historisë", në Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar dhe të kulturës së tij, Tiranë, 1988; Sh.Demiraj, "Gramatikë historike e gjuhës shqipe", Tiranë,1986; "Prejardhje e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe", Tiranë, 1999.*

qenë ilirishtja dhe trakishtja[8] .

Në mjaft artikuj historik dhe gjuhësor, vëmendje e veçantë i kushtohet forcës se ruajtjes së identitetit kombëtar, ruajtjes së gjuhës dhe të jetës zakonore që shihen si faktorët vendimtarë të mosasimilimit të shqiptarëve si komb. Çështjet sesi mundën stërgjyshërit e shqiptarëve në trevat e tyre të sotme t'i shpëtonin proçeseve asimiluese, sidomos atij të romanizimit dhe sllavizimit vazhdojnë të jenë edhe sot e kësaj dite për albanologjinë në veçanti dhe studimet historike e gjuhësore ballkanike në përgjithësi, ende mjaft të diskutueshme. Dhe në të vërtetë në një vështrim të parë duket si e pamundur që popullsia e pjesës perëndimore të Ballkanit, e cila, duke qenë me afër brigjeve të Gadishullit Apenin, u pushtua me herët, të mos jetë romanizuar plotësisht. Për ndriçimin e kësaj çështjeje nuk duhet nisur nga paragjykimi që proçesi i romanizimit ka përfshirë të gjithë popullsitë e trevave perëndimore dhe lindore të Gadishullit Ballkanik. Në këtë rast duhet të nisemi jo nga prania e mbishkrimeve në gjuhën latine, e cila ishte gjuha zyrtare e Perandorisë Romake, por nga disa fakte tashmë të vërtetuara. Kështu p.sh. është vërtetuar prania e një pjese të paromanizuar në trevat lindore të Ballkanit në kohën e dyndjeve sllave[9]. Nga ana tjetër, edhe vetë prania e stërgjyshërve të shqiptarëve në pjesën perëndimore të Ballkanit, siç kanë pranuar një varg dijetarësh, është një dëshmi e qartë se edhe një pjesë e popullsisë së trevave perëndimore të Gadishullit Ballkanik mundi ta ruajë identitetin e saj etnik, natyrisht jo pa iu nënshtruar një ndikimi të fuqishëm latin mbi gjuhën e vet amtare. Në këtë rast është fjala për romanizimin e plotë të stërgjyshërve të shqiptarëve, sepse një romanizim i pjesshëm i tyre, sidomos nëpër zonat qytetare, duhet të ketë qenë i pashmangshëm. Si rrjedhim, në viset e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve për një farë kohe gjatë sundimit romak krahas disa zonave, kryesisht bregdetare, me popullsi të romanizuar ose të përzier, ka pasur edhe zona, ku popullsia mundi të ruante gjuhën, doket e zakonet e veta. Në artikujt *"Gjurmë trake dhe ilire"*, që sjell At Shtjefën Gjeçovi, sjell pikërisht forcën e ruajtjes së jetës zakonore si një prej faktorëve dhe mentalitetin pagan të shqiptarëve i mbetur i tillë që nga rrënjët iliro-trake. Artikujt e Gjeçovit në këtë pikë të kujtojnë një mendim të *Pellegrinit*[10], i cili, duke bërë

[8] *Sh.Demiraj, "Gjuha shqipe dhe historia e saj", Tiranë 1988, f.68.*

[9] *S. Kulisic, "O etnogenesima crnogorocima", Titograd, 1980, f.12, ku citohen burime bizantine të shek. XI, ku bashkë me fiset sllave në provincën e Diokleas (Dukla në sllavisht), kishte edhe fise që s'ishin as sllave as romane.*

[10] *G.B.Pellegrini, "Aviamento nella lingua albanese", 1995, f.198.*

fjalë për përhapjen e romanizimi të mos ketë përfshirë të gjithë truallin shqiptar dhe sidomos krahinat larg qendrave qytetare si edhe zonat malore, ku nuk janë gjetur dëshmi romane të sigurta, gjetje arkeologjike ose epigrafike". Por fakti që paraardhësit e shqiptarëve, mundën t'i shpëtonin asimilimit të romanizimit e më pas në Mesjetë asilimit nga dyndjet sllave, në një kohë kur pjesa më e madhe e Gadishullit Ballkanik u sllavizua, dëshmon qartë se edhe në kushtet e pushtimeve të gjata nga të huajt, kishin arritur të ruanin në përgjithësi identitetin e tyre etnik.

Kjo shihet edhe tek shkrimi i revistës "*Shqipnia dhe shqiptarët*" me autor *Padër Marin Sirdanin*, një ndër këta faktorë duhet të ketë qenë karakteri konservator i etnosit shqiptar, i cili ka qenë shumë i lidhur me gjuhën amtare dhe me zakonet e traditat e tij dhe ka bërë gjatë shekujve një jetë të mbyllur pa u përzier me elementët e tjerë etnikë, që jetonin pranë tij. Një dëshmi për këtë na e japin edhe arbëreshët e Greqisë dhe të Italisë, të cilët gjatë shekujve të kaluar kanë bërë një jetë të mbyllur midis tyre duke i shpëtuar kështu procesit të helenizimit dhe të italianizimit, siç del tek artikujt e *E.Çabejt* dhe *K.Gurakuqit* mbi arbëreshët e Italisë të botuara në revistë përkatësisht, *Mes arbëreshëve të italisë*, nr.5-10, e vitit 1942. Po të kemi parasysh këtë element konservator, i cili ka qenë vendimtar për ruajtjen e identitetit etnik ndër arbëreshët e Greqisë dhe të Italisë gjatë këtyre katër-pesë shekujve të fundit në dhe të huaj, atëherë nuk është e vështirë të kuptohet arsyeja kryesore, që ka bërë të mundur ruajtjen e identitetit të etnosit shqiptar në trojet e veta, ku ai gjatë shekujve duhet të ketë përbërë shumicën e popullsisë dhe në përgjithësi ka bërë një jetë pothuaj "të pavarur", pa iu nënshtruar plotësisht pushtuesve të huaj.

Për ruajtjen e identitetit etnik të shqiptarëve gjatë shekujve - dhe këtu është fjala kryesisht për periudhat e pushtimit romak dhe të pushtimeve sllave - një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe faktorë të tjerë. Këtu duhen përmendur sidomos terreni kryesisht malor, ku ka mbijetuar ky etnos, marrëdhëniet ekonomike të një shoqërie të pazhvilluar me rrugë të pakta komunikimi dhe pozicioni gjeografik i trojeve shqiptare. Historia e këtij vendi na dëshmon se një pjesë e mirë e banorëve të fshatrave të mbipopulluar, në rrethana të caktuara, ka vërshuar kurdoherë drejt zonave të ulëta. Si rrjedhim, në trevat ku banojnë sot shqiptarët, sidomos në viset bregdetare, edhe ajo pjesë e popullsisë romane apo të romanizuar, pas dobësimit të pushtetit qendror romak, është shqiptarizuar sërish, apo rishqiptarizuar. Kjo vërejtje vlen

edhe për atë pjesë të popullsisë sllave apo të sllavizuar, që jetonte në vise të rrethuara nga një shumicë shqiptare. Citojmë një prej Padër Marin Sirdanin " *në shekullin XIII, fillon m'u ngjall palci shqiptar, ndër male,të paprekuna nga luftrat , popullsija e njij rrace shumë të bukur, pjellore dhe e shëndoshë,....e qëndrueshme në të gjitha fatkeqsitë, rracë së cilës dyshek i ishte toka dhe jastëk guri, aj element bredhës filloi me u rrotullue prej maleve në fusha.*

Ky popull i përbam prej fisesh të vjetra iliro-trake, qi të strukuna për shekuj ndër male e vende të parrahuna, kishte metë pa u përpi prej fisesh të huaja, i dha shfrim vedit, duke ripopullue edhe një herë një pjesë të vendeve banuem prej të parëve të tyne"[11], një artikull ky, ku shihet qartë kultura e gjërë dhe informacioni mbi burime historike dhe gjuhësore e autorit , duke analizuar edhe argumentet gjuhësore të *Krechmerit, G.Mayerit, Joklit , Pedersenit, e H.Bariçit*, si dhe ato historike të *Patchit,Shuflait, Tallozit, Nopcës, Baldaçit* etj.

Artikuj të tillë si ai i Sirdanit, i kundërvihen studiuesve (historianë dhe gjuhëtarë) që duke mos hequr dorë nga bindja se formimi i kombit rumun është bërë në trojet e sotme, për të shjeguar lidhjet e rumanishtes me shqipen, e zhvendosin atdheun e hershëm të shqiptarëve në një zonë më veriore dhe lindore. Duke hulumtuar argumentet më të fortë , mbi të cilët mbështet kjo hipotezë shihet qartë se bëhet fjalë më shumë për opinione të krijuara më shumë nga pamja e sotme gjuhësore, sesa nga gjykime gjuhësore historike, sipas të cilit, gabimi qëndron në injorimin e faktit që me dyndjet sllave, ato serbe nga veri-perëndimi i Ballkanit dhe ato bullgare nga lindja e gadishullit, u thye vazhdimësia e një hapësire të madhe të romanizuar ballkanike, apo dalmato-ballkanike, nga e cila në anën jugore të saj mbijetoi një gjuhë nga substrati iliro-trak, që është shqipja e sotme, me një ndikim të madh nga latinishtja, sidomos në veri dhe perëndim, dhe me greqishten gjithnjë të pranishme në kufijtë jugorë. Ndërsa në veri-lindje të Ballkanit, mbijetoi rumanishtja. Krijimi i këtij koridori sllav, ndërpreu një situatë të ngjashme politike, administrative dhe kulturore që shtrihej në pjesën më të madhe të Ballkanit, ku Perandoria Romake kishte disa shekuj që kishte konsoliduar pushtimin e saj. Përsa i takon shqipes, e mbyllur me vargmale në veri dhe jug, e kufizuar në perëndim nga deti, më tepër se një hapësirë "*trojet shqiptare paraqiten si një cep gjuhësor i izoluar ku gjuha e substratit ilir i kishte rezistuar më së miri ndikimit të latinishtes dhe greqishtes, gjuhë më superiore nga*

[11] *M. Sirdani, Shqipëria dhe shqiptarët, H.D.,1941, nr.3-5, fq.98-99.*

pikëpamja politike dhe kulturore". Arsyeja apo arsyet përse pikërisht nga emri i fisit ilir të Albanëve (nga Albanoi me qendrën e tyre Albanopolis, që del për herë të parë në Hartën e Botës, të Ptolemeut të Aleksandrisë, shek.II) në territoret e banuara nga shqiptarët erdhi e u përgjithësua si emër etnik për të gjithë ata që flisnin të njëjtën gjuhë me atë të atij fisi, mbetet një prej çështjeve shumë të diskutueshme edhe sot e kësaj dite. Një çështje e tillë del në disa artikuj të revistës[12]. Fryma patriotike që mbizotëron në artikuj të tillë, nuk e devijon argumentin shkencor, duke iu shmangur edhe përfundimeve të nxituara, duke theksuar se është një gjë e ditur që periudha, gjatë së cilës u përgjithësua ky emër etnik, është një ndër periudhat më të errëta të historisë së popullit tonë. Shpesh herë historiografia shqiptare dhe albanologjia në përgjithësi është përpjekur që të shtojë vlera të munguara ngjarjeve dhe personazheve historike shqiptare, atë çka të huajt po kaq shpesh kanë bërë të kundërtën, por në rastin e Hyllit të Dritës vlerat presin të shpalosen e të përhapen. Ashtu si në shkrimet e Filip Ndocës, "Hylli i dritës", bashkoi në një dijen dhe shpirtin e shqiptarëve

Bota , që hove -hove kujtohet për shqiptarin, s' pran tue dyshue për te.....Por ata e kanë kot. Kot të gjithë. Si mund të kundrojnë shqiptarin , në historinë e tij kur nuk ia njohin as shpirtin,as jetën. Shqiptarin që qëndron si një shkamb në vetpeshimin e vet, i ngim nga brumimi i fisniknisë mijvjeçare që i rreh në dej..[13].

[12] *Këtu mund të vlerësohen artikujt e M. Sirdanit, Emri "Shqiptar dhe arbnuer", H.D., 1931, n.7, f.198-204.*

[13] *F.Ndoca, "Shqiptari", H.D., 1941, nr.11-12, f.470-471.*